

**RAPORT
MBI
GJENDJEN E SISTEMIT GJYQËSOR DHE
VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR PËR VITIN 2023**

PËRMBAJTJA



SHKURTIME	4
MESAZHI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
I. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR.....	9
1.1. Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar	10
1.2. Mbledhjet plenare.....	11
1.3. Përmbledhje e veprimtarisë së komisioneve të Këshillit	12
1.3.1. Komisionet e përhershme	12
1.3.2. Komisionet e përkohshme	18
II. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BE-SË PËR VITIN 2022.....	21
III. ORGANIZIMI I BRENDSHËM	27
3.1 Burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor	27
3.2 Burimet njerëzore në sistemin gjyqësor	28
3.3 Zhvillimi i burimeve njerëzore.....	31
IV. VEPRIMTARIA BUXHETORE DHE FINANCIARE.....	32
4.1 Nevojat buxhetore	39
4.2 Buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor për vitin 2024.....	39
V. DIGJITALIZIMI.....	41
5.1 Qendra e Teknologjisë së Informacionit	42
5.2 Përmirësimet në infrastrukturën teknologjike ekzistuese.....	44
VI. HARTA E RE GJYQËSORE	46
6.1 Grupi i punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.....	47
6.2 Aktet e hartuara nga Grupi i Punës	48
VII. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE	57
METODOLOGJIA	57
7.1 Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë	58

7.2	Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.....	64
7.2.1	Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	64
7.2.2	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.....	69
7.3	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshme.....	74
7.4	Gjykata Administrative e Apelit	79
7.5	Gjykatat Administrative të shkallës së parë	84
7.6	Gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm	90
VIII.	BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR	100
8.1	Bashkëpunimi me institucionet shtetërore	100
8.2	Bashkëpunimi me grupet e interesit	102
8.3	Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar	102
8.4	Bashkëpunimi në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE	104
IX.	TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.....	104
X.	KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME	106

Ky raport u përgatit nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim me Urdhrin e Kryetares së KLGJ-së nr.07, datë 25.01.2024 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektraportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2023", i përbërë nga znj. Baisa Sefa, znj. Blerta Ngucaj, z. Kelment Greca, znj. Etrita Petriti, z. Xhevdet Haxhiu, znj. Rezarta Taushani, znj. Teuta Nuredini, znj. Juliana Kedhi, znj. Çiljeta Prifti, znj. Valbona Hoxha, znj. Arjona Hysaj dhe znj. Dorjana Guxo.

Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni i Përhershëm pranë KLGJ-së, për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin, i drejtuar nga Kryetarja e Këshillit znj. Naureda Llagami dhe anëtarët e tij znj. Fatmira Luli dhe znj. Gentiana Muçaj.

Në përfundim raporti u miratua në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 210, datë 25.04.2024.

SHKURTIME

RSH	Republika e Shqipërisë
KLGGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
ILDKPKI	Inspektorin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MPJ	Ministria për Punët e Jashtme dhe Evropën
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
ÇJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPSAB	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
KZHK	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
KVEVP	Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
KD	Komisioni Disiplinor
GJL	Gjykata e Lartë
GJPAKKO	Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit
SHM	Shkolla e Magjistraturës

MESAZHI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

*E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,
Të nderuar deputetë,*

Kam kënaqësi të ndaj me ju, raportin mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hyrë tashmë në fazën e konsolidimit të tij. Ai është jo vetëm i ndërgjegjshëm për sfidat e sistemit por ka edhe vizionin dhe maturinë profesionale për të vlerësuar mundësitë që e ardhmja sjell. Gjatë këtij rrugëtimi kemi ecur në shtigje të pashkelura më parë. Por falë përkushtimit, përgjegjshmërisë, profesionalizmit e besimit të partnerëve tanë, sot ecim me hapa të sigurt drejt vizionit për të ndërtuar, udhëhequr e qeverisur një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

Sikurse do të konstatojmë gjatë leximit të këtij raporti, veprimtaria e Këshillit ka qenë dinamike e orientuar jo vetëm nga adresimi i emergjencave por edhe vendosja e prioriteteve. Në kushtet e një transformimi rrënjësor të sistemit gjyqësor, për shkak të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, viti 2023 ka qenë një vit përpjekjesh për të rritur efikasitetin e shërbimeve gjyqësore, për të ruajtur së pari aksesin dhe kapitalin njerëzor dhe më pas për të adresuar backlog-un dhe kohën e arsyeshme të proceseve gjyqësore. Riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave passolli një seri ndryshimesh si në aspektin ligjor ashtu edhe administrativ. Por mbi të gjitha transformoi së brendshmi konceptin e shërbimeve gjyqësore, të cilat sikundër çdo shërbim tjetër publik do duhet të vlerësohen përkundrejt parimit të efikasitetit.

Raporti vjetor i jep mundësi lexuesit që të njihet në mënyrë të plotë dhe shteruese me veprimtarinë e Këshillit dhe sistemit gjyqësor përgjatë vitit 2023 si nga pikëpamja cilësore ashtu dhe sasiore. Një vëmendje e dedikuar në raport i kushtohet analizës statistikore të indikatorëve të performancës së sistemit gjyqësor, mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare, certifikuar nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) bazuar në të dhënat e raportuara nga vetë gjykatat.

Hartimi i këtij raporti vjetor, përveçse një detyrim ligjor që buron nga ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është një obligim moral ndaj qytetarëve shqiptarë dhe partnerëve ndërkombëtarë që kanë mbështetur përpjekjet tona në zbatim të Reformës në Drejtësi. Për këtë arsye, hartimi i këtij raporti, nuk është vetëm për afirmimin e arritjeve, por më shumë se kurrë, të përgjegjësisë për llogaridhënie, përmirësimin të cilësisë së shërbimeve, rritjes së aksesit të publikut, por edhe pavarësisë, profesionalizimit dhe integritetit të sistemit. Sa një proces vetë-reflektimi mbi sfidat dhe vështirësitë, ky raport është, po aq edhe një projektion për të ardhmen, për të cilën jam e bindur se më shumë se kurrë kërkon punë, përkushtim dhe përgjegjshmëri për të ruajtur dhe konsoliduar standardet e vendosura!

Me respekt,
Naureda LLAGAMI
Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I drejtuar nga parimet e pavarësisë, profesionalizmit, integritetit, dhe paanshmërisë, vendimmarrjet e Këshillit, si në numër ashtu edhe në cilësi, dëshmojnë angazhimin për të ndërtuar themele të forta drejt një drejtësie që i përgjigjet pritshmërive të publikut.

Disa nga zhvillimet më të rëndësishme që kanë shënuar veprimtarinë e Këshillit gjatë vitit 2023, janë:

1. Zhvillimi i 80 mbledhjeve plenare dhe miratimi i 743 vendimeve (24% më shumë se 1 vit më parë) nga të cilat 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.
2. Zbatimi me sukses i Hartës së Re Gjyqësore, përmes hartimit të një pakete të plotë prej 60 aktesh (administrative dhe individuale) që jo vetëm garantuan funksionalitetin pa ndërprerje të shërbimeve gjyqësore për publikun por maksimizuan miradministrimin e burimeve njerëzore dhe financiare.
3. Ngritja e një grupi pune “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” i cili do të propozojë masa konkrete ligjore dhe administrative, të dedikuara, në nivel kombëtar por edhe gjykate për parandalimin dhe reduktimin e stokut të çështjeve.
4. Plotësimi i Gjykatës së Lartë me 19 anëtarë përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve.
5. Vazhdimi i zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes një sërë masash duke realizuar:
 - Unifikimin e standardeve të administrimit të brendshëm gjyqësor përmes miratimit të rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata;
 - Vijimin e misionit për garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, përmes:
 - përcaktimit të 15 kuotave për ndihmës ligjorë për vitin akademik 2023-2024;
 - zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë;
 - verifikimit dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor për 4 nëpunës civilë gjyqësorë, 3 ndihmës ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
6. Përgatitja dhe rekrutimi i gjyqtarëve të rinj duke:

- emëruar 41¹ magjistratë të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023.
 - miratuar 40 kuota për kandidatët për magjistrat “profili gjyqtar” për vitin akademik 2023-2024.
 - Kryer verifikimin e kriterëve dhe kushteve formalo-ligjore si dhe pasurisë dhe figurës për 46 kandidatë².
7. Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor duke zhvilluar 6 procedimeve disiplinore³, për të cilat u konkludua:
- Për 4 procedime disiplinore pezullim deri në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar;
 - Për 2 procedurat e mbartura nga vitet e mëparshme janë përmbyllur pa një vendim përfundimtar.
8. Me qëllim plotësimit të trupave gjyqësore në gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka:
- Trajtuar 169 kërkesa duke caktuar 208 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.
 - Përfshirë në skemë delegimi 5 gjyqtarë⁴ dhe ka transferuar 33 gjyqtarë⁵.
 - Vazhdimi i vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke hartuar dhe miratuar 57 raporte vlerësimi. Në periudhën 4-vjeçare 2020-2023, janë miratuar në total 156 raporte vlerësimi për 92 gjyqtarë⁶ duke vlerësuar rreth 37% të gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në detyrë⁷.
9. Vijimi i angazhimit në funksion të rritjes së transparencës dhe efijencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.
- Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 1027 kërkesave për mbështetje teknike;
 - Përfundimi me sukses i migrimit të të gjithë bazës së të dhënave nga gjykatat që ndërprejnë veprimtarinë, për shkak të riorganizimit, në gjykatat pritëse;

¹ 1 magjistrat i emëruar ka përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022.

² 30 kandidatë për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, ndërkohë që procesi është duke vijuar për 10 kandidatë të tjerë. 5 kandidatë për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023, 1 kandidat për vitin akademik 2021-2022.

³ 4 procedura disiplinore janë të filluara rishitazi gjatë vitit 2023, ndërsa janë vënë në lëvizje edhe 2 procedura të tjera disiplinore të mbartura nga vitet e mëparshme.

⁴ 4 gjyqtarë rishitazi dhe për 1 gjyqtar u vendos zgjatja e afatit dhe ricaktimi në skemën e delegimit.

⁵ Nga të cilët, 12 gjyqtarë janë transferuar në mënyrë të përkohshme me pëlqim, për 2 gjyqtarë është vendosur përsëritja e transferimit të përkohshëm për një periudhë 1-vjeçare, dhe 8 gjyqtarë janë transferuar në mënyrë të përhershme për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykata. Ndërsa për 11 gjyqtarë është realizuar transferimi përmes lëvizjes paralele.

⁶ Nga të cilët 64 gjyqtarë janë vlerësuar për dy periudha vlerësimi.

⁷ Efektivisht në detyrë ndodhen 247 gjyqtarë.

- Përfundimi i digjitalizimit të arkivës për 8 gjykata;
 - Anonimizimi automatik i të dhënave sensitive në vendimet gjyqësore, duke ekuilibruar nga njëra anë nevojën e shtuar për transparencë dhe akses në gjyqësor dhe nga ana tjetër mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
10. Funksionalizimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, përmes plotësimit të organikës së saj dhe hartimit të dokumenteve kornizë për ndërtimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të gjithë sistemin e drejtësisë.
 11. Vazhdimi i përpjekjeve për rritjen e transparencës, aksesit dhe besimit të publikut mbi veprimtarinë gjyqësore duke standardizuar marrëdhëniet e gjykatave me publikun dhe median përmes miratimit të udhëzuesit standard si dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe posaçëm për të dyja nivelet e gjykimit.
 12. Rritja e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ, në kuadër të së cilës, janë trajnuar 209 gjyqtarë që ushtrojnë efektivisht detyrën, 103 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 15 punonjës të KLGJ-së, falë bashkëpunimit të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, projektet e asistencës së huaj, dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

GJENDJA E SISTEMIT GJYQËSOR GJATË VITIT 2023

Gjatë vitit 2023, sistemi gjyqësor është përballur me një ulje të ngarkesës së punës, ku numri total i çështjeve në shqyrtim është 5.1 % më i vogël se në vitin 2022. Një ndër faktorët kontribues në këtë drejtim është ulja e numrit të çështjeve të reja të regjistruara.

Gjatë vitit 2023, qytetarët i janë drejtuar më pak gjykatave duke sjellë një ulje prej 9.5 % të çështjeve të reja të regjistruara, krahasuar me vitin paraardhës.

Pjesa më e madhe e gjykatave kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, nën 70 %, ndërsa në nivel kombëtar vetëm 60.5% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023.

Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 247 gjyqtarë ose 8.94 gjyqtarë për 100.000 banorë. Ky raport është 60% më pak se e normës evropiane (22.2 gjyqtar për 100.000 banorë).

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në rang vendi, gjatë vitit 2023, ka qenë pothuajse 566 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje me 5 çështje më tepër krahasuar me një vit më parë (561 në 2022).

Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve, mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve në rang vendi paraqitet e ndryshme.

- Gjykata e Lartë vijon trendin rritës të normës së likuidimit të çështjeve civile dhe administrative dhe ka arritur të kalojë pragun me 100% për të treja kategoritë, duke shqyrtuar 3.7 herë më shumë çështje sesa regjistrimet e reja.
- Norma e likuidimit të çështjeve për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme. Vërehet se në krahasim me vitin e mëparshëm ka ulje të likuidimit të çështjeve. Nga të dhënat rezultojnë se, norma e likuidimit të çështjeve civile është ulur me 38 % dhe çështjeve penale është ulur me 12.1%.
- Gjykata Administrative e Apelit ka arritur ritme më të larta të normës së likuidimit. Treguesi për këtë gjykatë për vitin 2023 është 43%. Ndonëse norma e likuidimit është rritur me 55% më shumë se një vit më parë, ajo ende vazhdon të jetë nën 100%.
- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO), ka arritur një normë likuidimit 103.3%.
- Për Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm likuidimi i çështjeve civile për vitin 2023, paraqitet në vlera të ndryshme. Në vështrim të përgjithshëm treguesi mesatar për çështje civile është ulur me 5 %, ndërsa për çështjet penale është rritur me 2%.
- Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka arritur një normë likuidimit të çështjeve në masën 100.9%.
- Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ vërehet se norma e likuidimit të çështjeve është nën 100%. Tirana me 91.25% dhe Lushnja 87.87%.

Megjithatë për shkak të kohës së shkurtër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, këto konstatime duhet të merren me rezervë, për t'u vlerësuar objektivist gjatë viteve në vijim.

I. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147 të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli përbëhet nga 11 anëtarë të cilët ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë 5 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. 6 janë anëtarë gjyqtarë të

cilët zgjidhen nga komuniteti i vetë gjyqtarëve dhe përfaqësojnë të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor. Ndërsa 5 anëtarë jogjyqtarë, zgjidhen nga Kuvendi dhe përfaqësojnë profesionet e lira. Për sa i përket Kryetarit të Këshillit, ai zgjidhet nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë.

Në dhjetor të 2023, me mbarimin e mandatit të tre anëtarëve gjyqtarë⁸, përbërja e Këshillit u ripërtëri me ardhjen e tre anëtarëve të tjerë. Për rrjedhojë, përbërja e re e institucionit është si vijon:

KRYETARJA	
Znj. Naureda Llagami	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga radhët e shoqërisë civile Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
ZËVENDËSKRYETARI	
Z. Ilir Rusi	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 5-vjeçar (2022-2027)
ANETARËT GJYQTARË	
Znj. Emona Muçi	Përfaqësuese e Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2023-2028)
Znj. Gentiana Muçaj	Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2023-2028)
Znj. Irena Plaku	Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
Z. Klodian Kurushi	Përfaqësues i Gjykatës së Lartë Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
Z. Markelian Koça	Përfaqësues i Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2023-2028)
Z. Ridvan Hado	Përfaqësues i Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
ANËTARËT JOGJYQTARË	
Z. Alban Toro	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
Znj. Yllka Rupa	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 5-vjeçar (2022-2027)
Z. Fatmira Luli	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2018-2023)

1.1. Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar

Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës, parime këto që gjenden të brendësuar në paketën e Reformës në Drejtësi, e cila synoi të

⁸Vendimi nr. 736, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Brikena Ukperaj”, Vendimi nr. 737, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Marçela Shehu”, si dhe Vendimi nr. 738, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj”.

adresoje në mënyrë sistematike praktikat kompromentuese si pandëshkueshmëria, mungesa e transparencës, ndikimi politik dhe korrupsioni në sistemin e drejtësisë.

Kështu ligjet me të spikatura të kësaj pakete të cilat normojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe njëkohësisht sistemit gjyqësor janë:

- Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (referuar në raport si Ligji për Qeverisjen);
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (referuar si Ligji për Organizimin);
- Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, i ndryshuar (referuar si Ligji për Statusin);
- Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- Ligji nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar si Ligji për Veting-un);
- Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar

Krahas kuadrit të brendshëm ligjor, vlen të theksohet se veprimtaria e gjyqësorit mbështetet edhe në korpusin e normave apo standardeve ndërkombëtare, të tilla si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Karta Evropiane për statusin e gjyqtarëve, parimet themelore të OKB-së rreth pavarësisë së gjyqësorit si dhe udhëzimet e OKB-së mbi sundimin e ligjit, parimet Bangalore të Kodit të Sjelljes së gjyqtarëve, etj. Rol të jashtëzakonshëm në këtë korpus standardesh ndërkombëtare ka jurisprudenca e zhvilluar nga gjykatat evropiane, përfshirë këtu Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe opinionet/rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian, Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ), etj.

Vlen të përmendet që këto standarde dhe parime ndërkombëtare kanë shërbyer si udhërrëfyes për hartimin e paketës së Reformës në Drejtësi, duke dëshmuar kështu për përputhshmërinë e kuadrit të brendshëm ligjor me parimet, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e gjyqësorit.

1.2. Mbledhjet plenare

Në përmbushje të misionit të tij për qeverisjen, mbarëvajtjen dhe miradministrimin e sistemit gjyqësor, gjatë vitit 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka realizuar 80 mbledhje plenare dhe ka marrë 743 vendimmarrje (24% më shumë se viti 2022).

Nga 743 vendimmarrje të Këshillit, 725 prej tyre janë propozuar nga komisionet e përhershme, ndërsa 1 vendim është propozuar nga Grupi Ndërinstitucional i Hartës së Re

Gjyqësore; 2 vendime nga Komisionet e Përkohshme pranë KLGJ-së, si dhe 15 vendime janë propozuar nga Komisionet e Ristrukturimit. Për sa i përket kategorizimit të këtyre vendimmarrjeve sipas përcaktimit ligjor, rezulton se: 27 janë akte nënligjore, ndërkohë 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.

1.3. Përmbledhje e veprimtarisë së komisioneve të Këshillit

Sipas parashikimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron veprimtarinë e tij përmes 4 Komisioneve të Përhershme:

1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
2. Komisioni Disiplinor;
3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale;
4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Gjatë vitit 2023, puna voluminoze e komisioneve është materializuar në një numër të lartë aktesh nënligjore në kuadër si të rregullimit, mbarëvajtjes dhe miradministrimit të sistemit gjyqësor ashtu dhe të karrierës së gjyqtarëve, e pasqyruar si më poshtë:

Komisionet e Përhershme	Nr. i akteve propozuara
1 Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit	119
2 Komisioni Disiplinor	20
3 Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale	102
4 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	484
5 Akte të Komisioneve të Përhershme	725
6 Akte të tjera ⁹	18
Akte totale të miratuara nga KLGJ (2023) ¹⁰	743

Duke qenë se, në respektim të detyrimit ligjor¹¹, veprimtaria e komisioneve të përhershme pasqyrohet në raportet e tyre vjetore që janë publike në faqen zyrtare të Këshillit (<https://klgj.al/raporte-te-komisioneve-te-perhereshme/>), në këtë kapitull do të ofrojmë një përmbledhje të gjetjeve kryesore të tyre.

1.3.1. Komisionet e përhershme

KOMISIONI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT

Gjatë vitit 2023, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit

⁹ Këtu përfshihen aktet e miratuara nga Komisionet e Përkohshme, Komisioni i Ristrukturimi, si dhe nga Grupi i Hartës së Re Gjyqësore.

¹⁰ Duke përfshirë edhe aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare.

¹¹ Pika 16, e nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

(KPSAB) ka realizuar 45 mbledhje, në të cilat janë marrë 119 vendime, 110¹² prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë, përkatësisht: 12 në fushën e planifikimit strategjik, 81 në fushën e administrimit dhe efijencës, dhe 17 në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor.

Vendimmarrjet e KPSAB-së, dëshmojnë për angazhimin maksimal në funksion të zbatimit më sukses të projektit më madhor të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Hartën e Re Gjyqësore. Veprimtaria e KPSAB-së është pashmangshmërisht e ndërlidhur me veprimtarinë dhe funksionin edhe të komisioneve të tjera të Këshillit, qofshin këto Komisionet e Përhershme apo edhe ato të Përkohshme. Ky ndërveprim evidentohet sidomos në funksion të ndërtimit të një administrate civile gjyqësore profesionale dhe arritjes së standardeve të ekselencës gjyqësore.

Disa prej arritjeve më të spikatura të këtij Komisioni janë si më poshtë vijon:

- 119 akte/vendime të hartuara dhe miratuara;
- Një paketë e plotë aktesh administrative dhe individuale, në funksion të ri-konfigurimit gjeografik të 38 gjykata të vendit në 20 të tilla;
- Përcaktimi i standardeve të unifikuar të administrimit të brendshëm gjyqësor përmes miratimit të rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata;
- Vijimi i misionit për garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë¹³;
- Realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor (KLGJ-ja, QTI dhe Gjykatat) në masën 96%, duke reaguar me fleksibilitet ndaj nevojave të sistemit gjyqësor në kushtet e ndryshimeve ligjore dhe administrative të importuara nga riorganizimi i sistemit gjyqësor, si dhe nga ndryshimet në kategorizimin e pagave në administratën publike;
- Standardizimi i marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median përmes miratimit të udhëzuesit standard, si dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe të posaçëm për të dyja nivelet e gjykimit;

KPSAB-ja ka dëshmuar angazhim maksimal në jetësimin e prioritetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për ndërtimin e një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Kështu, gjatë vitit 2023, është bërë përpjekje maksimale në këtë drejtim dhe në bashkëpunim me QTI-në janë hartuar dhe miratuar dokumentet kornizë për ndërtimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të gjithë sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, është hartuar dhe dërguar për miratim në Ministrinë e Ekonomisë

¹²9 vendimmarrje të KPSAB-së i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun.

¹³ Përmes zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë dhe zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin dhe pranimin në shërbimi civil gjyqësorë për 4 nëpunës, 3 ndihëm ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

dhe Financës, ndonëse ende pa përgjigje, Marrëveshja me Ambasadën Suedeze, e cila garanton mbështetje financiare në funksion të ndërtimit të sistemit të ri (për më shumë referohuni në Kreun V).

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

Gjatë vitit raportues, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (KZHK) është fokusuar në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë me qëllim zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, si dhe garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe me integritet të lartë. Vendimmarrjet e hartuara kanë qenë kryesisht të lidhura me proceset e përzgjedhjes/emërimit, promovimit, transferimit apo mbarimit të statusit të gjyqtarëve, duke zbatuar në mënyrë rigorozë kriteret ligjore e objektive të vendosura, e duke garantuar të drejtat vetjake të gjyqtarëve në proces.

Gjatë vitit 2023, KZHK-ja i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor gjithsej 484 projektvendime, nga të cilat:

- 88 akte në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;
- 1 akt në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024;
- 6 akte në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes apo miratimit të pensionit të parakohshëm/moshës së pensionit;
- 28 akte në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve përgjatë vitit 2023;
- 16 akte në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit, sipas nenit 45 të Ligjit për Statusin;
- 146 akte në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm dhe të përhershëm të gjyqtarëve;
- 126 akte në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023;
- 38 akte në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024;
- 31 akte në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme;
- 4 akte në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën gjyqësore, ku përfshihet hartimi i rregullave të detajuar për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Krahas përmbushjes së detyrave që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, KZHK-ja është angazhuar të adresojë edhe një sërë detyrash që lidhen me prioritetet e vetë

Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu, KZHK-ja ka pasur në fokus ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit të gjyqtarëve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me caktimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të veçanta, veprimtari kjo e cila jo vetëm që garanton mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor por njëkohësisht përmbush detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të siguruar ofrimin e shërbimeve gjyqësore për publikun. Gjithashtu, Komisioni është investuar edhe në draftimin e rregullores për emërimin e Kryetarëve në gjykatat, për të cilën është në pritje të miratimit të ndryshimeve ligjore, përcjellë në Kuvend që prej vitit 2022.

KOMISIONI DISIPLINOR

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Komisioni Disiplinor, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë treguar përgjegjshmëri dhe kujdes në zbatimin në praktikë, të gjithë kuadrit normues për procedurat disiplinore, duke përfunduar brenda afateve ligjore dhe të arsyeshme të gjitha procedurat disiplinore të paraqitura për shqyrtim.

Komisioni Disiplinor gjatë vitit 2023, ka kaluar për shqyrtim në mbledhje plenare 4 procedura disiplinore të filluara rishtazi gjatë këtij viti, ndërsa janë vënë në lëvizje edhe 2 procedura të mbartura nga vitet e mëparshëm. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka proceduar me dhënien e vendimit jo përfundimtar, konkretisht:

- me pezullimin e procedimeve disiplinore lidhur me 2 procedura të filluara për magjistratët B.M., R.A. dhe K.Dh.,¹⁴ deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përmes të cilët është disponuar dhënia e masës disiplinore “*Shkarkimin nga detyra*”.
- me pezullimin e procedimeve disiplinore, për një periudhë 1-vjeçare, lidhur me 3 procedurat disiplinore të filluar në ngarkim të magjistratit S.U,¹⁵ në kushtet kur më herët për këtë magjistrat, Këshilli¹⁶ ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të pa mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Rrethanë kjo që përbën shkak për pezullimin e shqyrtimit të këtyre procedurave disiplinore të filluara nga ILD.

Ndërkohë, lidhur me 2 procedurat disiplinore të pezulluara më parë dhe të vëna në lëvizje gjatë 2023, në kushtet e rënies së shkakut të pezullimit, Këshilli ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të pezullimit dhe vijimin e trajtimit të çështjeve në themel¹⁷. Konkretisht, Këshilli pasi shqyrtoi aktet e procedimeve disiplinore ka vendosur:

¹⁴ Me vendimet nr.228, datë 11.05.2023 dhe nr.740, datë 26.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹⁵ Me vendimet nr.436, datë 19.07.2023, nr.437, datë 19.07.2023 dhe nr.438, datë 19.07.2023 të KLGJ-së.

¹⁶ Me vendimin nr.223, datë 08.05.2023 të KLGJ-së.

¹⁷ Me vendimin nr.660, datë 02.11.2023 është shfuqizuar vendimi nr.559, datë 01.12.2021 për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit R.K. Ndërsa me vendimin nr.702, datë 30.11.2023 janë shfuqizuar vendimet e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr.304, datë 14.02.2023 dhe nr.354, datë 19.07.2013, për pezullimin e procedimeve disiplinore të filluar ndaj magjistratit M.K.

- për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit R.K., pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur¹⁸.
- për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit M.K., për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara, për të cilat ky procedim ka nisur dhe që kanë të bëjnë me vendime gjyqësore të vitit 2009 dhe 2012.

Veprimtaria e Komisionit Disiplinor është e ndërvarur me atë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) me të cilin ka një bashkëpunim të ngushtë duke trajtuar kërkesat e ILD-së me drejtësi, korrektësi dhe brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Një ndër çështjet prioritare të veprimtarisë së Komisionit të Disiplinës lidhet me unifikimin e rregullave për procedimin disiplinor në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore. Kjo çështje e lidhur ngushtësisht me plotësimin e një prej rekomandimeve të kahershme të Rezolutës së Kuvendit, për adresimin e të cilës është ngritur edhe një grup i përbashkët pune me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komisioneve Disiplinore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe përfaqësues nga projektit EU4Justice. Veprimtaria e këtij grupi pune është materializuar me hartimin e një draft rregulloreje për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje, e cila pritet të miratohet së shpejti nga dy këshillat respektivë.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

Rëndësi të veçantë, përgjatë vitit 2023, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP) i ka kushtuar plotësimin të Skemës së Vlerësimit të gjyqtarëve, si dhe nisjes së procesit të vlerësimit për të gjithë gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele. Ky proces është vlerësuar si një prioritet madhor për faktin se plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, gjykatat e apeleve dhe gjykatat e posaçme është i ndërlikuar dhe ndërvarur pashmangshmërisht me ecurinë e procesit të vlerësimit të gjyqtarëve.

Në total, KVEVP-ja ka realizuar 33 mbledhje të cilat janë materializuar në 102¹⁹ vendimmarrje ose trajtim të praktikave duke adresuar zgjidhjen e tyre, përkatësisht si më poshtë vijon:

- 1 akt nënligjor që plotëson Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, konkretisht rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;

¹⁸ Me vendimin nr.694, datë 21.11.2023 të KLGJ-së.

¹⁹ 1 akt individual është hartuar në bashkëpunim me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës dhe është përlogaritur në veprimtarinë e këtij të fundit, përkatësisht Vendimi nr. 153 datë 29.03.2023.

- 1 akt për miratimin e programit 3-vjeçar periodik për sistemin e vlerësimit dhe raportin vjetor për veprimtari të tjera të Komisionit;
- 4 akte individuale për trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve;
- 8 akte administrative në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në funksion të realizimit të programit të trajnimit fillestar;
- 87 akte me fokus procedurat e vlerësimit etik dhe profesional (*11 akte për fillimin dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, duke filluar kështu procedurat e vlerësimit për 64 gjyqtarë²⁰; 10 akte për mosfillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për periudhën 2013-2016²¹; 2 akte administrative për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Durrës, Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; 57 akte për miratimin e projekt-raporteve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve²²; 7 akte për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurave të vlerësimit të filluara²³.)*

KVEVP-ja ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të përfshirë në program, duke i dhënë përparësi procesit të gradimit të gjyqtarëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar, vlerësimit të kandidatëve të kualifikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Posaçme, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe për lëvizje paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës. Kjo, në kushtet kur finalizimi i këtyre të fundit ndikon edhe në krijimin e pozicioneve të lira të përherëshme për kandidatët për magjistratë. Si rezultat i këtij angazhimi, gjatë vitit 2023, Komisioni ka propozuar 62 projekt-raporte²⁴ për vendimmarrje nga të cilat 57 janë të miratuara nga KLGJ-ja në mbledhje plenare.

²⁰ Për periudhat e vlerësimit 2013-2016, 2020-2022, vlerësimin e përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik dhe për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

²¹ Kjo për shkak se procedura e vlerësimit nuk mund të fillonte, në kushtet kur koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi në kuptim të neneve 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më se shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr.263, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

²² Duke vlerësuar 23 gjyqtarë për periudhën 2013-2016, 12 gjyqtarë për vitin e fundit kalendarik, 18 gjyqtarë për periudhën 2017-2019, 1 gjyqtar për periudhën 2020-2022, 1 gjyqtar për periudhën 2018-2020, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të ndihmësmagjistratit në Gjykatë të Lartë dhe 2 gjyqtarë për periudhën 2019-2020, për periudhën e komandimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

²³ Nga të cilat i) për 1 gjyqtar procedura e vlerësimit ka përfunduar për shkak të rënies së shkakut për të cilën kjo procedurë ka filluar, ii) për 3 gjyqtarë procedura e vlerësimit ka përfunduar për shkak se realizimi i procedurës së vlerësimit ishte objektivisht e pamundur dhe nuk mund të vazhonte dhe iii) për 3 gjyqtarë procedura e vlerësimit ka përfunduar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

²⁴ 57 janë raporte vlerësimi etik-profesional të miratuara nga Mbledhja Plenare. Projektraporte të propozuara nga KVEVP janë në total 62 (27 për periudhën e vlerësimit 2013-2016, nga të cilat 23 janë miratuar dhe 4 në pritje për t'u shqyrtuar nga mbledhja plenare; 12 për periudhën e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik, të miratuara nga mbledhja plenare; 18 për periudhën 2017-2019, të miratuara nga mbledhja penale; 2 për periudhën 2020-2022, nga të cilat 1 është miratuar dhe 1 është në pritje për t'u shqyrtuar nga mbledhja plenare; 1 për ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, miratuar nga mbledhja plenare dhe 2 për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të miratuara nga mbledhja plenare)

Duhet theksuar se vlerësimi nuk ka për qëllim të ndëshkojë gjyqtarin, por ta nxitë atë në drejtim të rritjes profesionale, përmirësimin të cilësisë së punës e aftësive menaxheriale, respektimit të etikës dhe rritjes së angazhimit profesional. Duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit²⁵, gjyqtarëve të vlerësuar, ju është rekomanduar që të vazhdojnë të mbajnë në konsideratë angazhimin e tyre në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tyre për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar nxitjes së gjyqtarëve për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, me qëllim jo vetëm shkëmbimin e njohurive e unifikimin e qëndrimeve në çështje të njëjta, por edhe për përmirësimin e vazhdueshëm të etikës e aftësisë së tyre profesionale. Megjithëse përgjegjësitë e gjyqtarit ndryshojnë midis juridiksioneve dhe roleve specifike, gjyqtari në çdo nivel dhe në çdo detyrë duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Në këtë aspekt është rekomanduar që gjyqtarët të bëjnë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e seancave gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje.

KVEVP-ja vlerëson se, në kohëzgjatjen e procedurave të vlerësimit të papërfunduara ende, përveç numrit të pamjaftueshëm të nëpunësve përgjegjës për vlerësimin të përfshirë në këtë proces, kanë ndikuar edhe një sërë faktorësh që lidhen kryesisht me plotësimin me vonesë të dosjeve të vlerësimit nga gjykatat, sidomos në lidhje me ofrimin e të dhënave të sakta statistikore, si dhe kohëzgjatja e trajtimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarëve gjatë periudhës së vlerësimit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për sa kohë që rezultatet e këtij procesi, sipas ligjit, konsiderohen burim vlerësimi.

Në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, gjatë vitit 2023, KVEVP-ja është angazhuar në disa dimensione që lidhen si me caktimin e gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë, për vitin akademik 2023-2024, ashtu edhe në procesin e miratimit të programit të trajnimit vazhdues, duke propozuar tema konkrete për trajnim në përputhje me nevojat që kanë rezultuar nga ecuria e vlerësimit etik dhe profesional, referuar nenit 68, shkronja “ç” të Ligjit për Statusin.

1.3.2. Komisionet e përkohshme

Tashmë për të 5-in vit radhazi pranë KLGJ-së funksionojnë Komisionet e Përkohshme, funksionimi i të cilave buron nga Ligji për Qeverisjen me qëllim adresimin e problematikave të veçanta të sistemit gjyqësor të cilat nuk mbulohen nga veprimtaria e komisioneve të përhershme. Komisionet e Përkohshme të cilat kanë vijuar funksionimin edhe gjatë vitit 2023 janë:

²⁵ Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- 1 Komisioni i Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve;
- 2 Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësisë së kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;
- 3 Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari;
- 4 Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre.

Për herë të parë gjatë vitit raportues është krijuar Komision i Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, i cili vjen në kuadër të përmirësimit rrënjësisht të trajtimit financiar dhe masave mbështetëse për gjyqtarin.

Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional (në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve)

Në vijim të mbështetjes së ofruar për organet e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit²⁶, Komisioni, krijuar sipas vendimit nr. 15, datë 22.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2023 ka kontrolluar dhe miratuar 29 raporte të rivlerësimit dhe 10 relacione për ndërprerjen e procesit të hartimit të raportit të rivlerësimit (si pasojë e ligjit). Gjithashtu ka zhvilluar 17 shorte për përzgjedhjen e 5 dosjeve/relacioneve për 17 subjekte të rivlerësimit, në funksionin e tyre si ndihmës ligjorë, pranë gjykatave përkatëse. Në vijim të punës së tij, KPVEP ka proceduar me depozitimin e raporteve dhe të dosjeve gjyqësore pranë KPK-së grupuar sipas institucioneve. Ndërkohë, për vitin 2024, kanë mbetur vetëm 6 raporte rivlerësimi²⁷ për t'u miratuar nga KPVEP, të cilat më pas dorëzohen pranë KPK-së.

Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësisë së kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Sikurse çdo vit, në janar të 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës vendosi caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar dhe ndihmës ligjorë²⁸ që do të pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024. Për këtë qëllim u ngrit Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësisë së Kriterëve të

²⁶ Në referim të nenit 171, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

²⁷ Për 6 subjekte vlerësimi, të cilët janë ish gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë.

²⁸ Për vitin akademik 2023-2024 nuk janë përcaktuar kuota për këshilltarë ligjorë.

Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë²⁹, i cili ka verifikuar gjithsej 97 kandidatë për ndihmës ligjorë. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioni përfundoi në përcaktimin e:

- listës emërore me 82 kandidatë për ndihmës ligjorë, që plotësojnë kriteret
- dhe 15 kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret.

Nga ana tjetër, ky Komision bazuar në nenin 30, pika 4 e Ligjit për Statusin ka ofruar komente dhe sugjerimeve në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës për aplikantët që kanë kandiduar për magjistrat, profili gjyqtar. Konkretisht, Komisioni pas verifikimit të 404 dosjeve të aplikantëve për magjistrat, profili gjyqtar ka dhënë sugjerimet dhe kundërshtime përkatëse për 42 kandidatë.

Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari

Në Këshill janë grumbulluar gjithsej 110 ankime kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit, nga të cilat 11 janë mbartur gjatë viteve 2021-2022, ndërsa 99 janë regjistruar gjatë vitit raportues. Në këtë kuadër, Komisioni ka zhvilluar 11 mbledhje duke trajtuar dhe vendosur për 86 ankime:

- për 83 ankesa refuzimin si të pabazuara me vendim komisioni;
- për 1 ankesë pushimi i hetimit;
- për 1 ankesë mospranim ankimi me vendim relatori;
- për 1 ankesë, është dërguar për kompetencë organit kompetentë.

Ndërkohë 24 ankesa i janë mbartur Komisionit të ri. Vlen të evidentohet fakti se, gjatë vitit 2023 nuk ka pasur asnjë vendimmarrje nga ana e Komisionit për shfuqizimin e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre³⁰

Qëllimi i funksionimit të këtij Komisioni është garantimi i mbrojtjes së veçantë personale, të familjes dhe pasurisë së magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit, ose kur gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij i rrezikohet jeta, shëndeti i tij ose i familjes, si dhe pasuria. Gjatë vitit 2023, si rezultat i mbarimit të mandatit 2-vjeçar të anëtarit përfaqësues të KLGJ-së në këtë Komision, u zgjodh anëtari i ri³¹ i cili mban edhe funksionin e Kryetarit të këtij Komisioni.

²⁹ Vendimi nr. 67, datë 09.02.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024”, i KLGJ-së.

³⁰ Sipas vendimit Nr. 564, datë 31.09.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij", të Këshillit të Ministrave.

³¹ Me Vendimin nr. 505, datë 28.09.2023 “Për caktimin e një anëtari në Komisionin për Mbrojtjen e Gjyqtarëve ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të KLGJ-së.

Gjatë vitit 2023, Komisioni, në përbërjen e të cilit ka përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore, është mbledhur një herë duke vendosur marrjen në mbrojtje të një gjyqtari.

Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim

Për herë të parë gjatë vitit 2023, në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara³² u mundësua ngritja e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë.

Gjatë vitit raportues, ky Komision ka miratuar listën e 6 magistratëve përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë³³.

II. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BE-SË PËR VITIN 2022

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përmes Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022³⁴ ka përcjellë një set rekomandimesh që duhen adresuar nga Këshilli në vitin pasardhës. Nëpërmjet komunikimeve në rrugë zyrtare³⁵ Këshilli i ka raportuar periodikisht Kuvendit në lidhje me masat e marra për adresimin e këtyre rekomandimeve dhe në mënyrë të përmbledhur niveli i zbatimit të këtyre rekomandimeve paraqitet si më poshtë vijon:

Në lidhje me Rekomandimin nr. 1 **“Të përmbyllë procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë”** theksojmë se, me përfundimin e tre procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë përgjatë vitit 2023, tashmë trupa gjyqësore prej 19 anëtarësh e kësaj gjykate është 100% e plotësuar. Ndërkohë, Këshilli vijon aktualisht procedurat e ngritjes në detyrë për një pozicion në fushën e të drejtës penale për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të njërit prej gjyqtarëve aktual të Gjykatës së Lartë.

³² Marrëveshjes dypalëshe nr. 8481/3, datë 01.8.2022 dhe nr. 1680/4, datë 11.8.2022, “Për kreditimin në kuadër të programit të subvencionimit të interesave të kredisë për magistratin”, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe OTP Bank dhe Marrëveshjes dypalëshe nr.174, datë 15.5.2023 dhe nr. 2905, datë 16.5.2023, “Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër mes Bankës OTP Albania Sh.a. dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Përfitim të Kredisë për Qëllime Banimi nga Magistratët”, midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe OTP Bank.

³³ Me vendimin nr. 1, datë 11.12.2023 “Për plotësimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”.

³⁴ Miratuar më datë 06.07.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

³⁵ Me shkresat nr. 3949/1 prot., datë 14.07.2023, nr. 3949/2 prot., datë 29.12.2023 dhe nr. 3949/3 prot., datë 30.01.2024.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 2 **“Të vijojë me ritme të shpejta procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”**, gjatë vitit 2023, Këshilli përmbylli me sukses plotësimin e 3 vakancave në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke e plotësuar këtë gjykatë me 9 nga 16 gjyqtarë që ka parashikuar organika. Ndërkohë, po vijojnë procedurat e verifikimit për 3 pozicionet e tjera të shpallura dhe aktualisht, është duke u realizuar nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët aplikues. Ndërsa, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është funksionale me 10 gjyqtarë nga 11 që ka organika, sipas konfigurimit të trupave gjykues dhe në përputhje me organikën e saj të parashikuar nga ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 3 **“Të ndjekë ecurinë dhe problematikat në implementimin e Hartës së Re Gjyqësore dhe të informojë Kuvendin e Shqipërisë rreth tyre brenda muajit dhjetor 2023”** theksojmë se tashmë i gjithë procesi i implementimit të Hartës së Re Gjyqësore ka përfunduar ashtu sikurse kemi referuar më sipër në këtë raport. Nga ana jonë është informuar Kuvendi në zbatim të afateve të caktuara dhe në mënyrë të detajuar lidhur me të gjithë ecurinë dhe problematikat e hasura për implementimin e Hartës së Re Gjyqësore. Një informacion më i detajuar në lidhje me zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore gjendet në Kreun VI të këtij raporti.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 4 **“Të vijojë me hartimin dhe miratimin e kuadrit nënligjor për planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave, si dhe atyre për vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve”**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të funksioneve të tij, ka miratuar 27 akte normative nënligjore me efekt të përgjithshëm detyrues mbi funksionalitetin e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2023, me qëllim përfundimin e procesit të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore brenda afateve ligjore, Këshilli ka pasur në fokus hartimin dhe miratimin e akteve, të cilat krahas zbatimit në praktikë të saj, kanë mundësuar miradministrimin e gjykatave, sidomos të aspekteve të ndryshme teknike që lidhen qoftë me procedurat e shortimit të çështjeve, ashtu dhe me burimet njerëzore nëpër gjykata, etj.

Gjithashtu, sa i përket miratimit të akteve lidhur me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe promovimit të tyre, megjithëse vlerësohet si një kuadër nënligjor i konsoliduar ndër vite, Këshilli ka vijuar punën për plotësimin e tij me rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor³⁶, si dhe rregullat për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë³⁷.

³⁶ Vendimi nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Në kuadër të rritjes së transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median, Këshilli ka miratuar Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median³⁸ si dhe një sërë aktesh të tjera të pasqyruara në Kreun IX.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 5 **“Të finalizojë paketën e akteve të nevojshme për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore në zbatim të reformës për nëpunësin civil gjyqësor”**, Këshilli i Lartë Gjyqësor në ushtrim të kompetencave të tij lidhur me administrimin e gjykatave dhe ndjekjes së çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata, përgjatë këtij viti, ka miratuar një sërë aktesh rregullatorë në kuadër të mirëfunksionimit të administratës gjyqësore. Gjithashtu, janë përcjellë dhe vijon puna mbi draftimin e 5 projekt-akteve të mëposhtme nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

- Rregullore "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë";
- Rregullore "Për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë", së bashku me modulet;
- Plani Strategjik 2024-2025 " Për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civile gjyqësore";
- Rregullore "Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor";
- Vendim "Për përcaktimin e tarifave për trajnerë/ekspertë lehtësues, që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civil gjyqësor".

Në lidhje me Rekomandimin nr. 6 **“Të ndërtojë një strategji konkrete për menaxhimin e çështjeve që presin të shqyrtohen (backlog), si dhe të bëjë të mundur standardizimin e normës orientuese për evadimin e çështjeve”**, theksojmë se: Me përfundimin e procesit të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, Këshilli ka vijuar me ndërmarrjen e masave të mëtejshme që lidhen me mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe në veçanti hartimin e një plani strategjik për reduktimin e çështjeve të prapambetura në gjykata. Për këtë qëllim, me Urdhrin nr.42, datë 20.07.2023 të Kryetares së Këshillit, u ngrit Grupi i Punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”. Nga ana e këtij grupi pune është miratuar plani i punës si dhe janë krijuar nëngrupet përkatëse të ndara sipas gjykatave, të cilat funksionojnë pranë: Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit. Gjatë veprimtarisë së tij, nga ana e Grupit të Punës janë miratuar edhe disa propozime për ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Civile, si dhe në ligjin nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

³⁷ Vendimi nr. 485, datë 21.09.2023 “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”.

³⁸ Vendimi nr. 716, datë 06.12.2023.

mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, të cilat i janë përcjellë Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 7 **“Të nxisë Gjykatën e Lartë për njësimin e praktikave gjyqësore, me qëllim vendosjen e standardeve të njëjta në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal, parimit të proporcionalitetit, veçanërisht për zbatimin e masave të sigurimit personal, aplikimin e gjykimeve të posaçme dhe veprave penale të dhunës në familje”**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i ka përcjellë³⁹ për njohje Gjykatës së Lartë rekomandimin e mësipërm, me qëllim mbajtjen në vëmendje nga ana e trupës gjyqësore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre gjyqësore. Përmes komunikimeve zyrtare të përsëritura, Këshilli i është drejtuar disa herë⁴⁰ Gjykatës së Lartë duke i kërkuar të informojë mbi ndjekjen e këtij rekomandimi, pa mundur të marrë një qëndrim prej saj.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 8 **“Të thellojë bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e kuotave për magjistratët e rinj dhe për trajnimin fillestar të tyre, si dhe për trajnimin e gjyqtarëve në detyrë”**, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar⁴¹ numrin e kandidatëve për magjistrat, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin kalendarik 2023-2024 në kuotën 40 kandidatë, për profilin gjyqtar, dhe 15 kandidatë për ndihmës ligjor. Gjithashtu, nga raportimet e përcjella nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me trajnimet e organizuara rezulton se për periudhën 01.01.2023-30.06.2023 kanë marrë pjesë në trajnime vazhduese, më konkretisht në 66 tema trajnimi gjithsej 161 magjistratë (gjyqtarë) si dhe janë trajnuar në 17 tema trajnimi gjithsej 25 nëpunës civilë gjyqësorë nga të cilët 11 kancelarë, 9 këshilltarë ligjorë dhe 5 ndihmës ligjorë.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 9 **“Të vijojë me prioritet vlerësimet etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e miratuar”**, gjatë vitit raportues, Këshilli ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të përfshirë në programin vjetor të vlerësimeve. Kryesisht duke u fokusuar në vlerësimet me efekt gradimi dhe vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarëve që kanë kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si edhe vlerësimeve për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele. Gjatë vitit 2023 janë miratuar nga ana e Këshillit në total 57 raporte vlerësimi. Në total nga fillimi i këtij procesi, Këshilli ka miratuar në mbledhje plenare 171⁴² raporte vlerësimi. Një informacion më i detajuar ofrohet në Kreun I të këtij raporti.

³⁹ Me shkresën nr. 3949/1 prot., datë 14.07.2023.

⁴⁰ Me shkresën nr. 6372 prot., datë 12.12.2023 dhe komunikimin elektronik të datës 18.12.2023.

⁴¹ Vendimi nr.55, datë 31.01.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁴² Nga të cilat 156 janë përfundimtare.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 10 **“Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje”**, përgjatë vitit 2023 janë zhvilluar disa takime të përbashkëta me përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe projekti Eu4Justice. Aktualisht draft rregullorja e përbashkët për unifikimin e procedimeve disiplinore për shkelje që përfshijnë një gjyqtar dhe një prokuror, pritet të miratohet nga institucionet e sipërpërmendura në një mbledhje të përbashkët. Për më shumë informacion, referojuni Kreut I.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 11 **“Të kontribuojë nëpërmjet kërkesave të motivuara dhe të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit”**, Këshilli i Lartë Gjyqësor duke vlerësuar bashkëpunimin ndërinstytucional në këtë fushë por jo vetëm mban gjithmonë në vëmendje çdo aspekt që lidhet me sistemin gjyqësor, mirëfunksionimin e gjykatave dhe administratës së tyre si dhe rastet që mund të përmbajnë shkak për realizimin e inspektimeve tematike. Lidhur me tematikat e inspektimit sipas këtij rekomandimi, bëjmë me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor ia ka përcjellë ato Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 12 **“Të raportojë në Kuvend brenda muajit dhjetor 2023 për ecurinë e krijimit të sistemit të ri modern të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore”**, KLGJ-ja brenda afateve të caktuara i ka raportuar Kuvendit në mënyrë të detajuar në lidhje me ecurinë e krijimit të sistemit modern të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Një informacion i detajuar në lidhje me këtë rekomandim gjendet në Kreun V të këtij raporti.

Në rezolutën e Kuvendit për vitin 2023, për herë të parë është përfshirë si rekomandim edhe adresimi i problematikave të konstatuara në Progresraportin e Bashkimit Evropian. Konkretisht, bëhet fjalë për Rekomandimin nr. 13 **“Të kontribuojë në adresimin e problematikave të konstatuara në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2022 lidhur me aktivitetin e Këshillit”**. Progresraporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, në përfundim të vlerësimit të veprimtarisë së sistemit gjyqësor, ka përcjellë një set konkret rekomandimesh për t’u mbajtur në vëmendje nga Këshilli. Kështu:

Në lidhje me rekomandimin e parë **“Konsolidimi i përpjekjeve për të forcuar efikasitetin dhe transparencën e të gjitha gjykatave dhe prokurorive, edhe nëpërmjet veprimeve të shpejta dhe vendimtare për ngritjen e një Sistemi Modern për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve dhe hartimin e një plani efikas për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore”**, risjellim në vëmendje se Këshilli e ka përmbushur tashmë pjesën më të madhe të detyrimeve të tij që lidhen me implementimin

e Hartës së Re Gjyqësore, plotësimin e vendeve vakante në gjykata, apo përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, sikurse kemi referuar edhe më sipër në këtë raport. Theksojmë se, për sa i përket përmirësimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, Këshilli në bashkëpunim me QTI-në ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar nga pikëpamja ligjore dhe teknike ndërtimin e sistemit ICMIS të ri. Gjithashtu, në funksion të parimit të transparencës, gjatë punës së saj KLGJ-ja ka shprehur angazhimin maksimal për të komunikuar në mënyrë të hapur dhe cilësore me publikun dhe median, si dhe për të rritur transparencën në lidhje me veprimtarinë e saj, sikurse është referuar në Kreun V.

Në lidhje me rekomandimin e dytë **“Shqipëria duhet të vazhdojë të konsolidojë dhe forcojë kapacitetet e sistemit gjyqësor dhe organeve të reja për vetëqeverisjen e pavarur të gjyqësorit, duke përfshirë përmirësime efçente dhe cilësore në Shkollën e Magjistraturës”**, theksojmë se, KLGJ ka vijuar forcimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor gjatë vitit 2023. Procesi i plotësimin të vendeve vakante në gjyqësor ka qenë dhe mbetet një ndër sfidat kryesore, kjo duke pasur parasysh procesin e rivlerësimit kalimtar, i cili ka sjellë një ulje të ndjeshme të gjyqtarëve në sistem. Në këtë aspekt, vijon ngushtësisht bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në përcaktimin e kuotave për magjistratët, profili gjyqtar apo ndihmës ligjor që do të ndjekin programin e formimit fillestar, si dhe në kuadër të realizimit të trajnimeve vazhduese për gjyqtarët. Gjithashtu, Këshilli ka vijuar me procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat me të larta dhe ato të specializuara, bazuar në parimin e meritokracisë. Për këtë qëllim, Këshilli fillimisht kryen vlerësimin e gjyqtarëve nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të gjyqtarëve, një proces i cili kryhet sipas kriterëve të qarta dhe të paracaktuara në rregulloret e miratuara nga KLGJ-ja, të cilat janë bazuar në standardet e CEPEJ të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë. Në varësi të këtij procesi, Këshilli ka rekomanduar angazhimin dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve në trajnime, në funksion të rritjes profesionale dhe përmirësimit të cilësisë së punës e aftësive të tyre menaxheriale.

Përmirësimi i i eficensës së sistemit të drejtësisë është një nga rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe detyrimet që kemi ndaj shtetasve shqiptare. Ky rekomandim, për me tepër, detyrim kushtetues thelbësor, në realizimin e tij i shërben jo vetëm shoqërisë shqiptare por edhe ekonomisë. Në një vend ku sistemi gjyqësor është i dobët dhe ineficient, ku duhen vite për të marrë një vendim, nuk mund të jetë një vend ku ka siguri juridike, dhe ku nuk ka një siguri të tillë ekonomia dhe shoqëria funksionon keq. Zhvillimi ekonomik i vendit tonë është i lidhur ngushtë me cilësinë e sistemit gjyqësor. Integriteti dhe pavarësia e tij nuk duhet të jete atribut vetëm i Këshillit të Lartë të Gjyqësor por fryt i bashkëpunimit të të gjithë aktorëve dhe në mënyrë të veçantë të Kuvendit, të cilët duhet të mundësojnë që ky pushtet të jetë i fortë financiarisht dhe të shikojë vetëm në drejtimin të drejtësisë. Rritja e fondit buxhetor për pushtetin gjyqësor, ushtrim presion ndaj pushteteve, ekzekutiv dhe lokal për të mundësuar disponimin e trojeve dhe fillimin e ndërtimeve të gjykatave, kontribut në përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore të së ardhmes, disponimi i faturës financiare për hartën gjyqësore, ndërprerja e praktikave jo ligjore të ngrirjeve të fondeve buxhetore, miratimi në të ardhmen i buxhetit vetëm nga Kuvendi, i konsiderojmë

mbështetje të cmuar dhe investim në ruajtjen e pushtetit të ligjit, projekt i rëndësishëm dhe entuziast për mbarë kombin.

III. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

3.1 Burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Për vitin 2023, struktura organizative e Këshillit ka pësuar një rritje me 10 pozicione shtesë duke e rritur numrin e stafit administrativ nga 128 në 138 nëpunës/punonjës. Pavarësisht rritjes së strukturës organizative, organika faktike e KLGJ-së, për vitin 2023 është 103 nëpunës/punonjës në total ndërsa rezultojnë 35 pozicione vakante.

Sa i përket raportit gjinor të stafit, rezultojnë 60 punonjës të gjinisë femërore si dhe 43 punonjës të gjinisë mashkullore, e cila e përkthyer në përqindje rezulton 58.3% e stafit janë punonjëse femra përkundrejt 41.7% e totalit, të cilët janë punonjës meshkuj.

Për nivelin e lartë drejtues aktualisht janë 5 nëpunës në funksion (sekretar i përgjithshëm/drejt departamenti) dhe 11 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (3 drejtorë drejtorie dhe 8 këshilltarë të komisioneve). Raporti gjinor rezulton 10 ose 63% e nëpunësve të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues janë të gjinisë femërore si dhe 6 ose 37% janë meshkuj. Përqindja e nëpunësve të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të gjinisë femërore, krahasuar me vitin paraardhës, është ulur me rreth 12%.

Me qëllim mbarëvajtjen e punës, mirë-funksionimin e institucionit, si dhe plotësimin e pozicioneve vakante ekzistuese, gjatë vitit 2023 kanë përfunduar 15 procedura rekrutimi, për 15 pozicione vakante, ndër të cilat 14 prej tyre kanë përfunduar me sukses, më konkretisht:

- 3 pozicione të nivelit të lartë drejtues,
- 4 pozicione të nivelit të mesëm drejtues,
- 2 pozicione të nivelit të ulët drejtues,
- 5 pozicione të nivelit ekzekutiv.

Vlerësimi i rezultateve në punë në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Ashtu si edhe në vitet paraardhëse edhe në vitin 2023, në KLGJ janë kryer të gjitha vlerësimet e rezultateve të punës për stafin administrativ pjesë e shërbimit civil të institucionit. Ky proces është ndërmarrë me qëllim verifikimin e realizimit të objektivave të përgjithshme të përcaktuara si në nivel institucional ashtu edhe individual, vlerësimi të aftësive apo evidentimit të mangësive në ushtrimin e detyrave funksionale, zhvillimit të aftësive profesionale të punonjësve dhe vlerësimi të nevojave për trajnim. Kjo veprimtari vlerësuese është realizuar në zbatim të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i ndryshuar, dhe është një proces i cili realizohet 2 herë në vit.

3.2 Burimet njerëzore në sistemin gjyqësor

Viti 2023 shënoi zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, e cila solli ri-konfigurimin e shpërndarjes gjeografike të gjykatave në gjithë territorin e vendit si dhe nevojën për ristrukturimin e administratës gjyqësore për t'iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet këtij procesi. Kështu, numri i punonjësve, sipas strukturës organizative të gjykatave të të gjitha niveleve për vitin 2023, është 1615 punonjës, nga të cilët 408 gjyqtarë dhe 1207 administratë gjyqësore.

Me qëllim amortizimit të efekteve, kryesisht, të procesit të rivlerësimit kalimtar, administrata gjyqësore, krahasuar me 1 vit më parë, është rritur me 20 pozicione pune, referuar ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” në zbatim të së cilit këto pozicione iu akorduan gjykatave të të gjitha niveleve. Në tabelën në vijim gjendet një informacion i detajuar i shpërndarjes faktike të tyre:

Gjykata	Totali		Gjyqtarë			Administratë		
	Str. organiz	Org. Fakt	Str. organiz	Org. fakt	Vakanca	Str. organiz	Org. Fakt	Vakanca
Gj. Lartë	145	124	19	19	0	126	105	21
Gj. Apeleve	367	249	102	52	50	265	197	68
Gj. Shkalla I	961	873	251	227	24	710	646	64
Gj. Adm. Shkallës I	142	117	36	31	5	106	86	20
Totali	1615	1363	408	329	79	1207	1034	173

a. Magjistratë

Në dhjetor të vitit 2023, numri total i gjyqtarëve faktik në sistemin gjyqësor është 329 gjyqtarë, 11 gjyqtarë më shumë se në vitin 2022 (nga 408 të përcaktuar me dekret). Në tabelën në vijim gjendet një informacion i detajuar i shpërndarjes faktike të gjyqtarëve:

Gjykata	Gjyqtarë në vitin 2023		
	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë
Gjykata e Lartë	19	19	18
Gjykatat e Apeleve	102	52	46
Gjykatat e Shkallës së Parë	251	227	163
Gjykatat Adm. Shkallës së Parë	36	31	20
Totali	408	329	247

Ndërkohë, numri i gjyqtarëve që efektivisht kanë ushtruar funksionin është 247 në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë 2023 ka funksionuar

me pothuajse 60% të kapacitetit të tij, pothuajse me 4.7 % më shumë së në vitin 2022, e cila ka rezultuar me 228 gjyqtar që kanë ushtruar efektivisht detyrën. Kontribuues kryesore në rritjen e numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë e kanë kryesisht emërimet e magjistratëve të rinj. Kjo pasi gjatë vitit 2023, janë emëruar 41⁴³ magjistratë të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023.

Pra, referuar të dhënave statistikore, numri i magjistratëve të emëruar në sistem nga viti 2019 në vitin 2023 është 112 magjistratë, nga të cilët 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 108 magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Për sa i përket humbjeve nga sistemi si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, vlen të theksohet se që nga fillimi i procesit rezultojnë 89 vendimmarrje të KPA-së nga të cilat 24 vendimmarrje i përkasin vitit 2023.

Nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar me vendim të KPK-së janë shkarkuar nga detyra në **total 137 gjyqtarë**, me **një efekt financiar 614,817,337 lekë** deri në 31 dhjetor 2023. Për vitin 2023, rezultojnë 11 gjyqtarë me vendimmarrje të KPK-së për shkarkim nga detyra, të cilët presin zhvillimin e procesit në KPA, duke mbajtur ndërkohë statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit, si dhe duke përfituar njëkohësisht sipas ligjit 75% të pagës. Efekti financiar i përlllogaritur në buxhet është në shumën prej 17,353,600 lekë.

Aktualisht, në total përgjatë gjithë vitit, rezultojnë 73 gjyqtarë me vendimmarrje nga KPK-ja për shkarkim nga detyra, të cilët presin zhvillimin e procesit në KPA, duke mbajtur ndërkohë statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit, si dhe duke përfituar njëkohësisht sipas ligjit 75% të pagës. Një situatë e tillë përlllogaritet me një efekt financiar prej **194,507,025 lekë** lekë.

Aktualisht, në total rezultojnë 73 gjyqtarë me vendimmarrje nga KPK-ja për shkarkim nga detyra, të cilët presin zhvillimin e procesit në KPA, duke mbajtur ndërkohë statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit, si dhe duke përfituar njëkohësisht sipas ligjit 75% të pagës. Një situatë e tillë përlllogaritet me një efekt financiar prej **194,507,025 lekë**.

b. Administrata gjyqësore

Për sa i përket numrit faktik të punonjësve të administratës gjyqësore, për të gjitha gjykatat, në dhjetor të vitit 2023 rezulton të jenë në total 1034 punonjës nga 1207 sipas strukturës organizative.

⁴³ 1 magjistrat i emëruar ka përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022.

Referuar ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023, iu akorduan në total 30 pozicione pune shtesë. 10 pozicione pune nëpunës civil iu akorduan Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 20 pozicione pune nëpunës civil gjyqësor iu akorduan sistemit gjyqësor, të cilat në përputhje me nevojat konkrete u shpërndanë në 7 gjykata⁴⁴. Në këtë drejtim vlen të përmendet se numri i nëpunësve civilë gjyqësorë nga viti 2019 deri në fund të vitit 2023 është shtuar me 93 punonjës⁴⁵.

Shtimi i numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e të gjitha niveleve, pritet të ndikojë në të ardhmen në përmirësimin e raportit të gjyqtarëve me stafin administrativ. Por referuar strukturës faktike rezulton se ky raport për vitin 2023 ka qenë 1 gjyqtar me 3.1 staf mbështetës. Krahasuar me vitin 2022, ku raporti i gjyqtarëve me stafin mbështetës ka qenë 1 gjyqtar me 3.3 staf mbështetës, për vitin 2023 rezulton se ky raport është më i ulët. Kjo për faktin se pozicionet shtesë të punës ende nuk janë plotësuar me burimet përkatëse njerëzore.

Vlen të theksohet se për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në gjykata, përfshirë mungesën e gjyqtarëve por edhe stafit administrativ si dhe mbingarkesën e punës për burimet ekzistuese, KLGJ-ja ndërmori zbatimin e hartës së re gjyqësore me qëllim riorganizimin e të gjitha gjykatave në vend duke i rigrupuar ato dhe ekuilibruar ngarkesën e çështjeve për gjyqtarë.

Analiza e situatës

Edhe këtë vit, me gjithë rekrutimet e reja në sistem (gjyqtarë dhe administratë) numri i gjyqtarëve por edhe i administratës gjyqësore në raport me popullsinë, mbeten ende në nivele të ulëta krahasuar me standardet e sistemeve gjyqësore evropiane. Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se numri i vakancave në sistem, për magjistratët (gjyqtarë) është 161 vakanca (nga të cilat 79 të përhershme⁴⁶ dhe 82 vakanca të përkohshme⁴⁷), ndërsa për administratën gjyqësore rezultojnë 173 vakanca.

Nëse marrim në shqyrtim një ndër treguesit e menaxhimit të burimeve njerëzore që përdoret edhe nga CEPEJ, numrin e gjyqtarëve në raport me popullsinë, sikurse vihet re sipas tabelës së mëposhtme, Shqipëria është ende larg mesatares evropiane.

	Str. Organiz	Fakti	Efektivisht	Mesatarja Evropiane
Gjyqtarë / 100 mijë banorë	14.80	11.92	8.94	22.2 ⁴⁸

⁴⁴ Vendimi nr. 673, datë 08.11.2023 “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023” të KLGJ-së.

⁴⁵ Numri i nëpunësve civilë gjyqësorë në vitin 2019 rezulton 655 pozicione sipas organikës në fakt dhe në fund të vitit 2023 referuar organikës në fakt ky numër rezulton 748 pozicione.

⁴⁶ Vakancë e përhershme është diferenca e strukturës organizative me organikën në fakt.

⁴⁷ Vakancë e përkohshme është diferenca e organikës në fakt me efektivitetin në detyrë.

⁴⁸ Mesatarja sipas CEPEJ 2022 me të dhënat e vitit 2020, rezulton 22.2 (fq.48).

Numri i stafit jogjyqtar për 100.000 mijë banorë për Shqipërinë për vitin 2023 sipas organikës në fakt është **37.44**, kundrejt mesatares evropiane për vitin 2020 prej **55.5⁴⁹**. Pra, sërish rezulton se, pavarësisht shtimit të burimeve njerëzore në administratën gjyqësore, kjo administratë gjyqësore, në raport me numrin e popullsisë, vijon të mbetet larg mesatares evropiane.

Të dy këto faktorë, si numri i gjyqtarëve në raport me popullsinë, ashtu edhe numri i stafit të administratës gjyqësore në raport me popullsinë ndikojnë edhe në tregues të tjerë të efikasitetit të sistemit të cilat do të elaborohen në kapitullin në vijim.

Ndërkaq, për sa i përket raportit midis gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, pra numri mesatar i punonjësve në mbështetje të punës së një gjyqtari, me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, sërish mbetet nën mesataren evropiane nëse i referohemi strukturës organizative. Kjo e dhënë rritet artificialisht mbi mesataren evropiane nëse i referohemi të dhënave faktike (që ndikohet ndjeshëm nga numri i ulët i gjyqtarëve në detyrë) sipas pasqyrimin në tabelën e mëposhtme:

	Str. Organiz	Fakti	Efektivisht	Mesatarja Evropiane
Gjyqtarë / staf administrativ gjyqësor	2.95	3.14	4.18	3.9 ⁵⁰

Ndodhur në kushtet e një viti tranzitor, për shkak të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, nuk mund të bëhet një krahasim mbi raportin e vitit paraardhës me vitin 2023, fakt i cili do të mbahet në konsideratë në vitet në vijim.

3.3 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Investimi në kapitalin njerëzor mbetet një ndër sfidat më aktuale në ditët e sotme. Ndaj, në këtë kontekst si dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vijon t'i kushtojë një hapësirë të veçantë zhvillimit profesional dhe etik të burimeve njerëzore si në KLGJ ashtu edhe në gjykata.

Me qëllim rritjen profesionale të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ, por dhe forcimit e ruajtjes së një mjedisi pune motivues, janë zhvilluar trajnime specifike në përputhje edhe me kërkesat e punonjësve. Më konkretisht, gjatë vitit raportues janë trajnuar:

- 209 gjyqtarë ose 84.6 % e gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën, të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet e programit vazhdues të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës.
- 15 nëpunës ose 14.6 % e stafit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët janë trajnuar nga ASPA në përputhje me nevojat për trajnim.

⁴⁹ <https://public.tableau.com/app/profile/cepej/viz/OverviewEN/Overview>.

⁵⁰ Referuar raportit të CEPEJ viti 2022 me të dhënat e vitit 2020 rezulton 3.9, (Fq.54).

Ndërsa për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e të gjitha niveleve duhet përmendur se janë zhvilluar trajnime nga një gamë e larmishme aktorësh përkatësisht:

- 59 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga partnerët ndërkombëtarë;
- 47 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga Shkolla e Magjistraturës;
- 26 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga ASPA;
- 45 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga KLGJ-ja.

IV. VEPRIMTARIA BUXHETORE DHE FINANCIARE

Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin buxhetor 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), i ndarë në tre programe;

- Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë**”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI).
- Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Buxheti i miratuar, për vitin 2023, për sistemin gjyqësor i ndarë sipas programeve paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar sipas programeve, për vitin 2023.*

000 lekë

Kodi	Emërtimi	Shpenz. Paga	Shpenz. Sig. shoqërore	Shpenz. operative	Shpenz. tranf fam	Shpenz. investime	Tot.fonde buxhetore
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	209,000	27,500	71,700	1,500	15,000	324,700
01140	QTI	10,850	1,650	376	24	0	12,900
03310	Buxheti Gjyqësor	2,399,700	290,000	611,300	8,000	716,000	4,025,000
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	2,619,550	319,150	683,376	9,524	731,000	4,362,600

Në buxhetin e miratuar, peshën më të madhe sipas programeve për sistemin gjyqësor e zënë fondet buxhetore për gjykatat e të tre niveleve në masën 92.3 %, më pas fondet buxhetore për KLGJ-në në masën 7.4% dhe peshën më të vogël fondet buxhetore për QTI-në në masën 0.3%.

Fondet buxhetore të sistemit gjyqësor, të rishikuara, së bashku me realizimin e tyre 12-mujor, sipas grup shpenzimeve, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:


Pasqyra

e buxhetit të miratuar, të rishikuar dhe realizuar për Sistemin Gjyqësor për vitin 2023


000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshim e gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	2,619,550	727,804	3,347,354	3,285,262	98%
02	Shpenzime sig. Shoqërore	319,150	26,000	345,150	322,708	93%
03	Shpenzime operative	683,376	69,200	752,576	697,699	93%
04	Shpenzime tranf fam	9,524	6,753	16,277	6,890	42%
05	Investime	731,000	-344,400	386,600	351,596	91%
	Totali	4,362,600	485,357	4,847,957	4,664,155	96%

Në lidhje me strukturën sipas grup shpenzimeve të fondeve buxhetore për sistemin gjyqësor, vërehet se shpenzimet e personelit zënë peshën kryesore të buxhetit të miratuar, në masën **67%**, ndërsa shpenzimet kapitale (investime) janë ende më të ulëta se nevojat reale që ka sistemi gjyqësor, në masën **59%** të kërkesave të paraqitura. Grafikiisht pesha specifike që zë buxheti i miratuar për secilin nga grup shpenzimesh, paraqitet si më poshtë:



Gjatë vitit buxhetor 2023, buxheti i sistemit gjyqësor është rishikuar disa herë, duke u shtuar dhe pakësuar në shumën absolute prej 485,357 mijë lekë, (nga të cilat në *shpenzime paga* është shtuar në shumën 727,804 mijë lekë, *shpenzime sigurime shoqërore* është shtuar në shumën 26,000 mijë lekë, *shpenzime operative* është shtuar në shumën 75,953 mijë lekë dhe *shpenzimet kapitale (investime)* janë pakësuar në shumën 344,400 mijë lekë).



Gjithashtu, gjatë vitit buxhetor 2023, janë miratuar⁵¹ rishpërndarjet e fondeve buxhetore në shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale (investime), në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, për plotësim e nevojave të gjykatave mbështetur në kërkesat e tyre respektive.

Fondet buxhetore të miratuara, për sistemin gjyqësor, janë rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit, duke filluar nga viti 2019, viti i konstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sikurse ilustron në grafikun më poshtë. Pavarësisht kësaj, pesha që zë ky buxhet si përqindje ndaj PBB-së ka mbetur pothuaj e pandryshuar me një tendencë të lehtë në rritje, nëse e krahasojmë vitin 2023 me vitet e mëparshme (0.33% në vitin 2019 dhe 0.38% në vitin 2023).

Ndërsa në vlerë absolute buxheti i miratuar për vitin 2023 është afërsisht 15.04 eur/banor, ndërkohë që mesatarja e vendeve të Evropës është 18.8 eur/banor⁵², për vende me PBB më të vogël se 10,000 euro/banor. Kjo do të thotë se pavarësisht rritjes që ka pasur në buxhetin gjyqësor, jemi ende larg mesatares së shpenzimeve për gjyqësorin në vendet e BE-së.

I. Programi buxhetor 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fondet buxhetore të miratuara për programin “Planifikim, Menaxhimi dhe Administrim”, sipas emërimit të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 01110 për vitin 2023*


000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshi me gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	209,000	24,559	233,559	227,194	97%
02	Shpenzime sig. Shoqërore	27,500	1,000	28,500	26,072	91%
03	Shpenzime operative	71,700	0	71,700	51,618	72%
04	Shpenzime tranf fam	1,500	3,453	4,953	2,808	57%
05	Investime	15,000	0	15,000	12,788	85%
	Totali	324,700	29,012	353,712	320,480	91%

Sikurse ilustron, fondet buxhetore të miratuara në programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, për vitin 2023 janë në shumën 324,700 mijë lekë. Gjatë këtij viti ato janë shtuar në shumën 29,012 mijë, kryesisht në shpenzime personeli dhe janë realizuar në masën **91%**, ose në vlerë absolute në shumën **320,480 mijë lekë**, sikurse paraqiten dhe grafikisht si vijon.

⁵¹ Në zbatim të vendimeve nr. 232, datë 11.05.2023, nr. 447, datë 24.07.2023, nr. 362, datë 13.07.2023, nr. 640, datë 26.10.2023 dhe nr. 495, datë 21.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁵² CEPEJ 2022 report (2020 data) Tables graphs and analysis (Part 1).



Në mënyrë më të detajuar buxheti dhe realizimi për këtë program, paraqitet si më poshtë:

1. Shpenzime personeli

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është **236,500 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht në **209,000 mijë lekë** paga dhe **27,500 mijë lekë** në sigurime shoqërore. Ky fond është përlllogaritur dhe miratuar për **128 punonjës**. Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime personeli (shpenzime paga dhe sigurime shoqërore) është në masën **97%**, për shkak të mosplotësimit 100% të strukturës organizative të KLGJ-së.

2. Shpenzime operative

Lidhur me shpenzimet për mallra e shërbime të tjera (operative) është miratuar një fond në shumën 73,200 mijë lekë. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të KLGJ-së, referuar kërkesave të përcaktuara në fazën e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve si dhe realizimit të vitit 2022. Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzimeve operative është në masën **72%**.

Realizimi i shpenzimeve korrente tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet. KLGJ-ja, krahas administrimit dhe menaxhimit të fondeve të programit të KLGJ-së, ka administruar dhe menaxhuar edhe një pjesë të fondit të programit buxhetor të gjykatave (programi 03310), në shpenzime operative, në vlerën prej **195,035 mijë lekë**, e cila është prokuruar dhe realizuar në vlerën **187,492 mijë lekë**. Objekti i prokurimit është realizuar 100% sipas zërave dhe fondi është realizuar në masën **96%**, për shkak të kursimit të fondeve gjatë procedurave të prokurimit.

3. Shpenzime për transfertat për buxhetet familjare dhe individët

Lidhur me shpenzimet në këtë artikull është miratuar një fond që do të përdoret kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare apo për raste të dhënies së ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie dhe raste të tjera (sëmundje dhe pension pleqërie).

4. Shpenzime Kapitale (Investime)

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) është në shumën **15,000 mijë lekë**. Në këtë fond janë përfshirë kryesisht nevojat për pajisje teknologjike dhe rikonstruksion. Realizimi i shpenzimeve kapitale (investime) është në **masën 85 %**. Masa e realizimit në terma sasiore apo vlerë absolute të produkteve është e lidhur me kursimin e fondeve gjatë procesit të prokurimeve.

II. Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Fondet buxhetore të miratuara për programin “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, sipas grup shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 01140, viti 2023*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshi me gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	10,850	-1,200	9,650	3,666	38%
02	Shpenzime sig. Shoqërore	1,650	0	1,650	508	31%
03	Shpenzime operative	376	1200	1,576	1,055	67%
04	Shpenzime tranf fam	24	100	124	0	
05	Investime	0	0	0	0	
	Totali	12,900	100	13,000	5,229	40%

Sikurse identifikohet, fondet buxhetore për vitin 2023, për QTI-në janë alokuar vetëm në shpenzime korrente dhe janë realizuar në masën **40%**, për shkak të mosplotësismit të strukturës organike të saj.

III. Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet.


*Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 03310, viti 2023*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshime gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	2,399,700	704,446	3,104,146	3,054,403	98%
02	Shpenzime sig. Shoqërore	290,000	25,000	315,000	296,127	94%
03	Shpenzime operative	611,300	68,000	679,300	645,026	95%
04	Shpenzime tranf fam	8,000	3,200	11,200	4,082	36%
05	Investime	716,000	-344,400	371,600	339,108	91%
	Totali	4,025,000	456,246	4,481,246	4,338,746	97%

Fondet buxhetore të miratuara në programin “Buxheti Gjyqësor”, për vitin 2023 janë në shumën

4,025,000 mijë lekë. Gjatë këtij viti ato janë shtuar në vlerë absolute në shumën 456,246 mijë lekë, kryesisht në shpenzime personeli dhe janë realizuar



në masën 97%, ose në vlerë absolute në shumën 4,338,746 mijë lekë. Fondet buxhetore të miratuara, rishikuara dhe realizimi i tyre, sipas grup shpenzimeve, për programin 03310, grafikisht paraqiten si vijon:

Në mënyrë më të detajuar buxheti dhe realizimi për këtë program, paraqitet si vijon:

1. Shpenzime personeli

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është në shumën **2,689,700 mijë lekë**, i ndarë në 2,399,700 mijë lekë paga dhe 290,000 mijë lekë sigurime shoqërore. Buxheti në shpenzime personeli në këtë program është përllogaritur, mbështetur në numrin e plotë të punonjësve sipas strukturave organike për të gjitha gjykatat dhe nivelit të pagave në përputhje me legjislacionin në fuqi për magistratët dhe për administratën gjyqësore.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime personeli është në masën 97%. Numri faktik i punonjësve në gjykatat e të gjitha niveleve, në fund të vitit 2023, është 1,363 punonjës, kundrejt 1,615 punonjës sipas strukturës organizative. Konstatohet se gjatë vitit 2023, ka 252 punonjës më pak në sistem nga të cilët: 79 janë magistratë, (mungesa e të cilëve vjen për shkak të shkarkimit, dorëheqjes ose mosplotësimin e vendeve të lira) dhe 173 punonjës të tjerë në administratën gjyqësore. Këto mungesa nuk ka qenë e mundur të plotësohen brenda vitit 2023.

2. Shpenzime operative

Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2023, është në shumën **619,300 mijë lekë**. Shpenzimet operative përbëjnë ato shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitetin e përditshëm të gjykatave. Gjithashtu në këtë kategori llogariten edhe shpenzime të tjera specifike të cilat kryhen nga gjykata jo çdo vit por sipas rrethanave të krijuara, si shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, etj.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime operative është në masën 94%, e cila është tregues i përdorimit me efikasitet të fondeve nga gjykatat.

3. Shpenzime kapitale (Investime)

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) për këtë program është në shumën **716,000 mijë lekë**, të ndarë sipas projekteve të mëposhtme:

Pasqyra

e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar, në shpenzimeve kapitale (investime) sipas projekteve për programin 03310, viti 2023


000 lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Fondet buxhetore 2023	Rishikim Buxheti 2023	Realizimi	Realizimi %
18AD801	Blerje pajisje zyre	189,100	15,700	14,119	90%
21AC501	Blerje software	361,800	86,841	76,982	89%
21AC401	Blerje pajisje elektronike	20,000	193,100	186,991	97%
M290075	Blerje mjete motorrike	30,000	26,300	26,290	100%
M290068	Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë	56,500	49,059	34,426	70%
M290066	Studime dhe projekttime	58,600	600	300	50%
	Totali	716,000	371,600	339,108	91%

Sikurse shihet, peshën kryesore në detajimin e shpenzimeve kapitale (investime) e zënë shpenzimet për “Programe software” dhe “Blerje pajisje zyre” me rreth 75% të fondeve. Pas ndryshimeve të bëra gjatë vitit 2023, peshën kryesore në realizimin e këtyre fondeve në shpenzime kapitale (investime) e zë projekti “Blerje pajisje elektronike”.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime kapitale (investime) për programin 03310 është në masën **91%**. Në këtë realizim një ndikim të madh ka dhe mos çelja e fondeve buxhetore nga Ministria e Financave, në kodin e projektit blerje software për gjykatat, gjatë vitit buxhetor, fonde të cilat u pakësuan më pas me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, në shumën prej 344,400 mijë lekë.

Fondet buxhetore të miratuara, rishikuara dhe realizimi i tyre, në shpenzime kapitale (investime) sipas projekteve, për programin 03310, grafikisht paraqiten si më poshtë:



Për sa më sipër, sikurse evidentohet edhe nga analiza raportuese e detajuar, **realizimi i**

fondeve buxhetore për vitin 2023, në sistemin gjyqësor, rezulton në masën 96 %, i cili sipas grup shpenzimeve paraqitet si vijon:

- Në shpenzime paga, në masën 98 %,
- Në shpenzime sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në masën 93 %,
- Në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (operative), në masën 92 %,
- Në shpenzime kapitale (investime), në masën 91 %.

Pavarësisht se viti 2023 është viti në të cilin ndodhi riorganizimi i sistemit gjyqësor, treguesit më lartë dëshmojnë se Këshilli ka ruajtur një performancë të lartë duke reaguar me shpejtësi ndaj nevojave në sistemin gjyqësor dhe duke mundur një vendimmarrje të drejtë në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efektivitet dhe efikasitet.

Megjithatë duhet përmendur fakti se gjatë vitit buxhetor 2023, Këshilli është ndeshur me një pengesë të madhe në lidhje me realizimin e fondeve buxhetore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në shpenzime kapitale përfshirë investime teknologjike dhe infrastrukturë (godina për gjykatat). Ky fond edhe pse i miratuar dhe reflektuar në llogarinë e thesarit të Këshillit Lartë Gjyqësor, është mbajtur i bllokuar (i ngrirë) nga Ministria e Financave në kundërshtim me legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në përdorimin e fondeve buxhetore, duke na vënë në vështirësi të dukshme në përballimin e nevojave në investime dhe duke humbur kohë e punë të burimeve njerëzore me qëllim zgjidhjen e tyre.

Miratimi i hartës gjyqësore i pashoqëruar me faturën financiare ka krijuar vështirësi në zbatimin e saj e shoqëruar kjo edhe me degradim të të gjithë infrastrukturës gjyqësore, e cila nuk ofron kushte normale pune për gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësor e aq më shumë nuk mundëson aksesin në gjykate. Për të përballuar këtë vështirësi shpeshherë Këshilli ka përdorur fonde të miratuara për përdorim nga njësitë e administrimit të buxhetit gjyqësor duke privuar këto të fundit nga kryerja e investimeve. Për rrjedhojë, një situatë e tillë kërkon ndërhyrje me qëllim që pavarësia e pushtetit gjyqësor të garantohet jo vetëm *de juro* (parimisht) por edhe *de facto* (faktikisht).

4.1 Nevojat buxhetore

4.2 Buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor për vitin 2024

Për vitin buxhetor 2024, buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor, me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, është në vlerën **4,967,459 mijë lekë**. Nevojat e evidentuara nga KLGJ-ja dhe paraqitur prej saj si kërkesa buxhetore për vitin pasardhës, pasqyruar në dokumentin e projektbuxhetit afatmesëm PBA-së 2024 – 2026, kanë qenë rreth 47% më të larta se buxheti i miratuar dhe akorduar, ose në vlerë absolute 2,363,991 mijë lekë, si për shpenzimet korrente edhe për shpenzimet kapitale.

Ndërkohë që për sa i përket kërkesave për burime njerëzore shtesë nga Këshilli është kërkuar akordimi i 89 punonjësve shtesë, por nuk është miratuar asnjë punonjës shtesë. Në vlerësim të situatës buxhetore për vitin pasardhës evidentojmë se:

Për shpenzimet korrente – Për vitin 2024, fondet e miratuara në shpenzime korrente janë më të ulëta krahasuar me kërkesat buxhetore të paraqitura. KLGJ-ja do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme situatën në sistem me qëllim plotësimin e nevojave të të gjitha gjykatave me qëllim mirëfunksionimin e tyre. Monitorimi do të kryhet duke marrë parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në rritjen apo uljen e këtyre shpenzimeve, dhe më veçanërisht atyre të lidhura me mungesën e burimeve njerëzore në gjykata, si në gjyqtarë ashtu edhe në staf administrativ. Mungesa këto të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në masën e realizimit të shpenzimeve korrente. Megjithatë, për të plotësuar të gjitha detyrimet ligjore është e domosdoshme akordimi i fondeve shtesë nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas kërkesave të paraqitura nga KLGJ-ja, sidomos në shpenzime personeli.

Për shpenzimet kapitale (investime) – Fondet e miratuara për shpenzime kapitale, për vitin 2024, janë më të ulëta se viti i mëparshëm. Fokusi i KLGJ-së, në investimet e parashikuara për vitin 2024, do të jetë në vazhdimësinë e projekteve ekzistuese, ruajtjen e standardeve të arritura, si dhe në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin strategjik të KLGJ-së me qëllim përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore, teknologjisë së informacionit dhe situatës së transportit në gjykatat e vendit.

Gjatë vitit 2024, prioritet i është dhënë edhe investimeve për zhvillimin e projekteve ekzistuese në fushën e teknologjisë së informacionit me qëllim digjitalizimin e shërbimeve në gjykatat e të gjitha niveleve. Disa nga projektet e reja të parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2024 janë:

- *Digjitalizimi i dosjeve të arkivit gjyqësor:*
- *Sistemi Disaster Recovery*, i cili funksionon si një grup mjetesh (Hardëare dhe Softëare) dhe masash të nevojshme informatike, të cilat në rast fatkeqësish sigurojnë institucionin që proceset e tij të vazhdojnë funksionimin e tyre pa u ndërprerë, duke u ndjekur nga një fazë tjetër rekuperimi që rikthen proceset në një gjendje normale.
- *Infrastruktura mbështetëse për ICMIS i ri, ndonëse projekti në vetvete është i bllokuar.* Gjatë vitit 2022 është implementuar faza e parë e infrastrukturës mbështetëse për hostimin⁵³ e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS). Kjo infrastrukturë do duhet të sigurojë disponueshmëri të lartë në të gjithë komponentët e saj në mënyrë të tillë që të sigurojë dhe ofrojë vazhdimësi të proceseve pa ndërprerje. Në funksion të performancës dhe me qëllim vazhdimësinë e proceseve të punës, nevojitet dhe parashikimi për implementimin e licencave të cilat ndihmojnë infrastrukturën dhe garantojnë vazhdimësinë e procesit.
- *Regjistri OJF*, i cili ka filluar që në vitin 2022. Fondet buxhetore për këtë projekt janë në funksion të implementimit të licencave, të cilat ndihmojnë infrastrukturën dhe garantojnë vazhdimësinë e procesit të punës.

⁵³ Miratuar me vendimin nr. 7, date 26.07.2022, të Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

- *Sistem Exchange Server për hostimin e email-it zyrtar në infrastrukturën IT të sistemit gjyqësor.* Investimi parashikon blerjen, në vitin 2024, të një sistemi exchange email server “Exchange Server Enterprise 2019 On premises” për hostimin e postës elektronike zyrtare të stafit të gjykatave me qëllim që për arsye sigurie posta elektronike të jetë e konfiguruar dhe hostuar në Infrastrukturën IT në KLGJ dhe jo më tek AKSHI.

Në kushtet kur zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore që ndryshoi vendndodhjen dhe kompetencat tokësore të gjykatave në vend përfundoi në korrik 2023, kërkesat buxhetore për shpenzime kapitale (investime) të KLGJ-së pasqyrojnë vetëm nevojat për investime qartësisht të domosdoshme dhe që në vijimësi garantojnë mirëfunksionimin e gjykatave dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore për publikun.

Tashmë, KLGJ është fokusuar në rritjen e nivelit të investimeve në sistem, kryesisht për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore të gjykatave dhe infrastrukturën e sistemeve të teknologjisë së informacionit. Sikurse është theksuar në mënyrë të vazhdueshme, mbetet emergjente përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore nëpërmjet ndërtimit të godinave të reja për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Fier, Lezhë, Berat dhe Durrës. Qëllimi është sigurimi i standardeve bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese, si edhe ofrimi dinjitoz i shërbimit për publikun. Kërkesat për realizimin e këtyre projekteve kanë qenë pjesë edhe e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.

Politikat në drejtim të reformimit dhe përmirësimin të efikasitetit të shërbimit gjyqësor, duhet të përkthehen në buxhete të rritura, veçanërisht në investime. Një rritje e qëndrueshme e fondeve buxhetore në shpenzime kapitale (investime), në vitet në vijim, do të ndikojë në përmbushjen e objektivave për përmirësimin infrastrukturor të gjykatave dhe funksionimin efikas të sistemit gjyqësor.

V. DIGJITALIZIMI

Digjitalizimi përfshin përdorimin e mjeteve dhe platformave digjitale për të automatizuar proceset gjyqësore, administratën e gjykatave dhe shërbimet e tjera të institucioneve të drejtësisë. Përdorimi i teknologjisë digjitale lejon qasjen në mënyrë elektronike tek dokumentet dhe informacioni, duke zvogëluar kohën dhe kostot e nevojshme për të përpunuar dhe shpërndarë këto të dhëna.

Ky transformim digjital, fuqizon institucionet e sistemit të drejtësisë për të ridizenjuar dhe optimizuar proceset e punës, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë në trajtimin e çështjeve ligjore, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, lehtësi për qasjen në historik (arkivë) dhe garantimin e konfidencialitetit.

Për të arritur sukses në digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, është e rëndësishme të investohet në ndërtimin e një infrastrukture teknologjike të nevojshme, si dhe në trajnimin dhe aftësimin e personelit për të përdorur mjetet dhe platformat digjitale në mënyrë efektive. Gjithashtu, duhet të konsiderohen dhe të adresohen sfidat e sigurisë dhe privatësisë që mund të dalin nga përdorimi i teknologjisë digjitale.

5.1 Qendra e Teknologjisë së Informacionit

Tashmë prej pothuajse 3 viteve, ushtron veprimtarinë Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (këtu e në vijim “QTI”) ⁵⁴ e cila ka si mision përcaktimin e standardeve dhe politikave, për sistemet e teknologjisë së informacionit për të gjitha institucionet e drejtësisë, si dhe për një funksionim efektiv të përpunimit të informacionit dhe të dhënave (pajisje dhe programe), duke siguruar përmbushjen e nevojave institucionale.

Në këtë kuadër, QTI, gjatë vitit 2023, ka vijuar punën e saj, duke ndërmarrë miratimin e një sërë vendimmarrjesh të rëndësishme, me qëllim përmirësimin, zhvillimin, fuqizimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Projekti më madhor i Qendrës në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, si qeverisja e gjyqësorit, ka qenë dhe mbetet ndërtimi i një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili do të kapërcejë pengesat e sistemeve ekzistuese dhe do jetë një hap i madh drejt transformimit digjital në shërbimet e sektorit të drejtësisë. Ky sistem do të shërbejë në afatgjatë dhe në mënyrë strategjike të gjithë sistemit të drejtësisë duke ofruar automatizim më të lartë dhe do të mbështesë rrjedhën e punës brenda gjykatave duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efikasitetit, aksesit në drejtësi, respektimin e afateve kohore, transparencës, raportimit statistikor dhe llogaridhënies.

Kjo përpjekje e Këshillit filluar që në vitin 2019, konsiston jo vetëm në negocimin e mbështetjes buxhetore nga buxheti i shtetit, arritur me miratimin e buxhetit për vitin 2023, por edhe në mbledhjen e fondeve nga donatorë të huaj, si Ambasada Suedeze dhe fondet IPA. Kjo për shkak se ndërtimi i një sistemi të ri është një projekt i kushtueshëm nga pikëpamja financiare e cila kërkon bashkimin e disa burimeve të financimit.

Në funksion të këtij projekti, rikujtojmë se gjatë vitit 2022, Bordi Drejtues i QTI-së ka miratuar një sërë nismash, konkretisht miratimin e kërkesave të biznesit, kërkesat teknike për krijimin e infrastrukturës mbështetëse për hostimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve, si dhe dokumentin teknik për standardet e dizenjimit dhe standardet për specifikimet teknike të këtij sistemi, dokumente këto që janë hartuar në adresim të kërkesave specifike të parashtruara nga Bashkimi Evropian dhe Ministria e Drejtësisë

⁵⁴ E cila ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”

gjatë takimeve të punës. Duke vijuar me të njëjtin angazhim, janë miratuar edhe standardet për ndërtimin dhe administrimin e dhomës së serverëve për sistemin e drejtësisë. Kjo paketë aktesh rregullatore, përmbush të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për zhvillimin e një sistemi të ri informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, është hartuar dhe dërguar për miratim në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës, Marrëveshja me Ambasadën Suedeze, e cila garanton mbështetje financiare në funksion të ndërtimit të sistemit të ri. Por vlen të theksohet se, me miratimin e projektbuxhetit për vitin 2024, fondet buxhetore të parashikuara dhe të akorduara me buxhetin e vitit 2023 për ndërtimin e një sistemi të ri nuk janë aprovuar. Ndërsa edhe marrëveshja me Ambasadën Suedeze vazhdon të mbetet në pritje të një konfirmimi nga struktura e lartpërmendur. Për rrjedhojë, Këshilli është në proces koordinimi me të gjithë aktorët potencialë që të do mundësojnë realizimin e këtij projekti në të ardhmen e afërt.

Pasurimi i kuadrit rregullator, ka vijuar me një tjetër vendimmarrje të rëndësishme të Bordit Drejtues të Qendrës, si miratimi i Kornizës së Ndërveprimit, njohur si arritje edhe në Raport Progresin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2023⁵⁵. Ky dokument mbështet strategjinë e sistemit të drejtësisë për ofrimin e shërbimeve të integruara publike me fokus qytetarin duke lehtësuar ndërveprimin ndërmjet komponentëve të sistemit të drejtësisë dhe sistemeve të institucioneve qeveritare dhe të tjera publike dhe private në shërbim të publikut. Korniza e ndërveprimit parashikon një grup parimesh, standardesh, rekomandimesh dhe specifikimesh, që synojnë lehtësimin e ndërveprimit midis institucioneve brenda sistemit të drejtësisë, si dhe ndërveprimin midis institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të tjera publike.

Bazuar në këtë dokument, si dhe në rekomandimet e ekspertëve të BE-së, me qëllim udhëheqjen e projektit të digjitalizimit, me rëndësi është hartimi i një udhërrëfyese ndërinstytucional, i cili po përgatitet nga një grup pune, i ngritur me vendim të Bordit Drejtues të QTI-së. Grupi i punës do përcaktojë kostot, afatet kohore dhe hapat konkrete për finalizimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërveprimin midis komponentëve të sistemit të drejtësisë dhe sistemeve të institucioneve qeveritare dhe të tjera publike dhe private në shërbim të publikut.

Veprimtaria e këtij grupi pune, ka vijuar gjatë gjithë vitit raportues, duke bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertë të jashtëm të BE-së, UNOPS dhe institucionet e drejtësisë. Aktualisht, grupi i punës ka arritur në hartimin e një drafti paraprak të udhërrëfyesis, i cili pritet të konsultohet dhe dakordësohet së brendshmi me aktorët pjesëmarrës dhe më pas të miratohet nga Bordi Drejtues i Qendrës, brenda vitit 2024.

Ndërkohë që vlen të përmendet fakti që QTI-ja është e angazhuar në hartimin e akteve të tjera rregullatore, në përmbushje të veprimtarisë së saj, për të përditësuar dhe plotësuar

⁵⁵https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SËD_2023_690%20Albania%20report.pdf, fq.4.

vakumin e kuadrit nënligjor, me qëllim garantimin e zbatimit të standardeve dhe politikave të Bashkimit Evropian për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në sistemin e drejtësisë.

Viti 2023, ka vijuar me miratimin e nismave të reja në teknologjinë e informacionit, të tillë si miratimi i sistemit të ri të menaxhimit të veprimtarisë akademike të Shkollës së Magjistraturës (SHM). Nëpërmjet automatizimit të lartë dhe mbështetjes së rrjedhës së punës brenda institucionit, synohet rritja e efikasitetit të punës si dhe aksesit të subjekteve përdorues të këtij sistemi⁵⁶ transparencës, raportimit statistikor si dhe llogaridhënies. Gjithashtu, sistemi do të ndihmojë edhe për komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë, të tillë si Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

QTI do të vijojë në nxitjen e institucioneve të tjera të drejtësisë për marrjen e iniciativave, në përmirësim të sistemeve të tyre aktuale, në zhvillimin e sistemeve të reja, më qëllim përfaqimin e inovacionit dhe krijimin e një mjedisi digjital sa me eficient.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore

Qendra, si institucion rregullator dhe koordinues i teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, ushtron funksionet nëpërmjet dy organeve kryesore, Bordi Drejtues (organ kolegjal vendimmarrës) dhe Drejtori Ekzekutiv (organ administrativ). Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështet QTI-në në funksionet horizontale administrative, financiare e logjistike. Për çështje specifike në lidhje me problematika të fushës TIK dhe sigurisë kibernetike, Bordi ndihmohet nga Ekipi Këshillimor i Ekspertëve, i cili përbëhet nga nëpunësit më të lartë për çështjet e teknologjisë së informacionit në institucionet e drejtësisë.

Në përmbushje të funksioneve mbështetëse që Këshilli i Lartë Gjyqësor ofron për QTI-në, përgjatë vitit 2023 janë shpallur 5 vende vakante, ku në përfundim të procedurave përkatëse, janë rekrutuar 3 specialistë. Aktualisht mbeten për t'u rekrutuar edhe 2 specialistë të tjerë, për të finalizuar në këtë mënyrë plotësimin e strukturës së Qendrës, me qëllim funksionalitetin e saj në 100% të kapacitetit.

5.2 Përmirësimet në infrastrukturën teknologjike ekzistuese

Mungesa e një sistemi modern të menaxhimit të çështjeve gjyqësore nuk e ka penguar Këshillin, që për aq sa është e mundur, të ndër marrë përmirësime në infrastrukturën ekzistuese teknologjike në funksion të rritjes së transparencës, eficientësisë dhe aksesit në sistemin gjyqësor. Kështu, gjatë vitit 2023, Këshilli ka vazhduar monitorimin dhe zbatimin në praktikë të ndryshimeve strategjike në sistemet ekzistuese të menaxhimit të

⁵⁶Me subjekte përdorues të sistemit i referohemi aplikantëve për t'u regjistruar në SHM, kandidatëve që ndjekin Programin e Formimit Fillestar, stafit pedagogjik dhe administrativ, si dhe të gjithë përdoruesve të tjerë të këtij sistemi si gjyqtarëve, prokurorëve, ndihmësve ligjorë, kancelarëve, këshilltarëve, avokatëve të shtetit etj., në programet e SHM-së.

çështjeve në gjykata duke ofruar mbështetje teknike për 1027 kërkesa të adresuara prej tyre. Vlen të përmendet që gjatë vitit raportues, Këshilli ka ndërmarrë zhvillime specifike mbi: shpërndarjen e çështjeve me short elektronik⁵⁷, përmirësimin e sistemit ICMIS pranë Gjykatës së Lartë, përpunimin e të dhënave statistikore për sistemin ICMIS, aksesimin e vendimeve të gjykatave të shkallëve të ulëta nga gjykatat e apelit, anonimizimin automatik të të dhënave sensitive, rritjen e transparencës, plotësimin e trupit gjykues elektronikisht në sistemin ARKIT⁵⁸, si dhe garantimin e funksionimit të pandërprerë të platformës “M-Files”.

Gjithashtu, çështje të tjera të rëndësishme të trajtuara me vëmendje të posaçme nga Këshilli, janë dhe implementimi i infrastrukturës hardware për sistemin e regjistrimit audio/video në sallat e gjyqit të gjykatave, rritja e kapacitetit të arkivimit të materialeve audio/video dhe implementimi i teknologjisë për regjistrimin video të seancave gjyqësore, vënia në funksionim e rrjetit VPN Site to Site, digjitalizimi i arkivës gjyqësore (proces i përfunduar plotësisht në 8 gjykata), si dhe zbatimi i Regjistrimit Elektronik të OJF-ve⁵⁹.

Zhvillime informatikë në fushën e teknologjisë në kuadër të Hartës së Re Gjyqësore.

Për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka siguruar disponueshmëri të lartë, të ofrojë mbështetjen e nevojshme për vazhdimësi dhe performancë të proceseve të punës. Çdo proces pune që lidhet me sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore (regjistrimi i çështjeve, pasqyrimi i procesverbaleve, planifikimi i çështjeve, hedhja e dispozitiveve dhe e vendimit përfundimtar) është inxhinieruar sipas përcaktimeve ligjore dhe standardeve në fushë.

Bashkimi i sistemeve ka garantuar kapacitetet teknike dhe fleksibilitetin për të mbështetur nevojat për ndryshim e përmirësim në procedurat e ardhshme dhe ka siguruar transparencën dhe sigurinë në trajtimin si dhe monitorimin e ciklit jetësor të çështjeve gjyqësore dhe efektivitetin e punës në gjykata.

Konkretisht për të gjitha gjykatat u kryen zhvillimet që lidhen me aksesimin e çështjeve të gjykatave sekondare, nga gjykata primare, zhvillime në modulën e shortimit të çështjeve, rikonfigurimin/konfigurimin e roleve dhe të drejtave të përdoruesve në portalin “gjykata.gov.al” sipas skemës së re të hartës gjyqësore, shtimin e kapaciteteve të nevojshme teknike të infrastrukturës IT, ndryshime në strukturën e bazës së të dhënave dhe në kodin burim të aplikacionit ICMIS dhe ARKIT, zhvillime të cilat mundësojnë dhe garantojnë zbatueshmërinë e vendimit nr. 554, datë 29.12.2023 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndryshime në të gjithë raportet që

⁵⁷ Sipas vendimit nr. 554, datë 29.12.2023 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁵⁸ Sistemi ARKIT përdoret nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

⁵⁹ Bazuar në udhëzimet e ligjit 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

gjenerohen nga sistemi i menaxhimit të çështjeve si dhe janë reflektuar emërtimet e reja të gjykatave.

VI. HARTA E RE GJYQËSORE

Me vendimin nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” të Këshillit të Ministrave, u miratua propozimi dhe u vendos riorganizimi i gjykatave. Riorganizim ky i cili solli ndryshime thelbësore në kompetencat e tyre tokësore duke zvogëluar numrin e përgjithshëm të gjykatave nga 38 në 20.

Më specifikisht vendimi i Këshillit të Ministrave përcaktoi riorganizimin e:

- gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga 22 gjykata të rretheve gjyqësore në 13 gjykata të tilla, të cilat filluan punën më datë 1 maj 2023,
- gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga 6 gjykata apeli, në 1 Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës, e cila filloi punën më datë 1 shkurt 2023,
- 6 gjykatave administrative të shkallës në 2 gjykata të tilla, me kompetenca tokësore dhe seli në Tiranë dhe Lushnjë, e cila filloi punën më datë 1 korrik 2023.

Në zbatim të vendimit të lartpërmendur, Këshilli përfundoi me sukses ristrukturimin e plotë të gjykatave tashmë të ri-organizuar sipas Hartës së Re Gjyqësore, duke rishpërndarë të gjitha burimet njerëzore të disponueshme, si magjistratët (gjyqtarë) ashtu dhe punonjësit e administratës gjyqësore. Vlen të përmendet që procesi i rishpërndarjes së burimeve njerëzore u realizua në kohë rekord dhe me efekte financiare minimale. Gjithashtu, u realizua edhe transferimi, pra lëvizja fizike e arkivës gjyqësore nga godinat e gjykatave të suprimuara tek gjykatat “pritëse”.

Pavarësisht se tashmë Harta e Re Gjyqësore është një realitet, sfidë mbetet infrastruktura ndërtimore dhe ajo e teknologjisë së informacionit si dhe burimet e nevojshme financiare për përballimin dhe adresimin e këtyre nevojave.

Aktualisht, mos disponimi i trojeve për ndërtim dhe infrastrukturua e vjetëruar që disponojnë Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit, si dhe Gjykata e Shkallës së Parë Tiranës jo vetëm që nuk krijojnë kushte për gjykime solmne, por nuk mundësojnë kushte as për pune normale për burimet njerëzore. Situata është emergjente për sa i takon infrastrukturës ndërtimore edhe në Gjykatat e Shkallës së Parë, Durrës, Fier, Lezhë, Kukës, Berat dhe Shkodër. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka bërë përpjekje të mëdha për të siguruar sheshe ndërtimi ashtu dhe fondet e nevojshme buxhetore për financimin e tyre, duke i përfshirë këto nevoja për çdo vit në programin buxhetor afatmesëm të sistemit gjyqësor.

Gjithashtu gjatë vitit 2023, prioritet i është dhënë dhe investimeve për zhvillimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit me qëllim digjitalizimin e shërbimeve në gjykatat e të gjitha niveleve, siç janë: digjitalizimi i dosjeve të arkivit gjyqësor, i sigurisë për gjykatat, dhe projekti për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (më shumë informacion mund të lexoni në kapitullin IV).

Nevojat e mësipërme të natyrës infrastrukturore, financiare dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit rezultojnë që nuk janë adresuar nga autoritetet përkatëse.

Për rrjedhojë këto faktorë, duhen mbajtur në konsideratë në analizën e veprimitarisë gjyqësore për këtë periudhë të shkurtër kohore pas zbatimit të hartës. Koha është një nga këto faktorë të rëndësishëm dhe është esenciale për të pasur një perceptim të drejtë të procesit të ndryshimeve të cilat mund të marrin kohë për t'u realizuar plotësisht, ndaj dhe rezultatet e pritshme nuk ndodhin menjëherë.

Gjithashtu, vetë ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ka parashikuar një periudhë 5-vjeçare për vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave. Kjo është një kohë e mjaftueshme për të monitoruar dhe vlerësuar përmbushjen e objektivave të Hartës së Re Gjyqësore dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme për të garantuar përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë.

6.1 Grupi i punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.

Menjëherë pas zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, KLGJ ka vijuar të marrë masa të tjera në lidhje me rritjen e efijencës në sistemin gjyqësor. Për këtë qëllim është ngritur Grupi i Punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” të ndryshuar⁶⁰, me fokus kryesisht në gjykatat e apelit si dhe në gjykatat e konsideruara në nevojë. Ky Grup Pune ka në përbërje të tij anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtues të gjykatave kryesore, si dhe përfaqësues nga Këshilli i Evropës, nga projektet INL/EWMI, EU4Justice etj.

Detyrat kryesore të Grupit të Punës janë:

- i. Vlerësimi dhe analizimi i situatës lidhur me numrin e çështjeve të prapambetura në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat e Shkallës së Parë Administrative dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;
- ii. Identifikimi i shkaqeve të krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura dhe propozimi i masave konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e tij;
- iii. Hartimi i një plan veprimi me masa konkrete që grupi do të vlerësojë të nevojshme por pa u kufizuar në:

⁶⁰ Me Urdhrin nr.42, datë 20.07.2023, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

1. Vlerësimin e situatës mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve dhe hartimin e propozimit për afatet standarde kohore (standartet minimale të afatit) për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore;
2. Vlerësimin e nevojës për caktimin e standardeve sasiore dhe hartimin e propozimit mbi normën e likuidimit të çështjeve për gjyqtar, sipas kategorive të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave;
3. Vlerësimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe hartimin e propozimit përkatës;
4. Vlerësimin e numrit të nevojshëm për ndihmës ligjorë në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atë Administrativ, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit dhe hartimin e propozimit përkatës;

6.2 Aktet e hartuara nga Grupi i Punës

Gjatë veprimtarisë së këtij Grupi Pune janë hartuar/miratuar aktet e mëposhtme:

- **Raport vlerësues i grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata “Për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”**

Mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi⁶¹, i cili i ka atribuuar Këshillit kompetenca, ndër të tjera, edhe në përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve me qëllim sigurimin e një ngarkesë të ekuilibruar të punës midis gjithë gjyqtarëve të republikës, grupi i punës ka bërë një vlerësim të nevojës së përgjithshme për gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit. Ky vlerësim është bazuar duke marrë në konsideratë prezumimin se kompleksiteti i çështjeve administrative është i krahasueshëm me një miks çështjesh civile themeli me palë kundërshtare dhe çështjesh penale themeli. Në mënyrë të ngjashme, është prezumuar se kërkesat e tjera administrative kanë të njëjtën shkallë kompleksiteti si çështjet civile pa palë kundërshtare.

Pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i Ligjit Nr. 98/2016 i ndryshuar, është konkluduar se, nëse do të synohet ekuilibrimi i ngarkesës, Gjykata Administrative e Apelit do të ketë nevojë për të paktën 19 pozicione gjyqtarësh (krahasuar me 13 pozicione që ka aktualisht).

- **Projektudhëzim “Për miratimin e kritereve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata”; (Inventarizimi)**

Në zbatim të detyrimeve ligjore⁶², Këshilli detyrohet të krijojë mekanizma për zgjidhjen

⁶¹ Përkatësisht në nenin 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja ‘ë’, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 84, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁶² Parashikuara në nenin 89 dhe 94 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

e problemeve funksionale dhe shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës midis gjyqtarëve dhe gjykatave, të miratojë veprime standarde që ndërmerren në rastin e tejkalimit të afateve të shqyrtimit të çështjeve si dhe të hartojë udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së gjykatave.

Ky projektudhëzim vjen në kuadër të nevojës për parashikimin e veprimeve të qarta, standarde e të efektshme, të cilat duhet të zbatohen për grupimin e çështjeve sipas llojit e natyrës me qëllimin përfundimtar rritjen e efikasitetit, cilësisë e shpejtësisë së gjykimit të tyre dhe uljen e backlog-ut, si një akt i rëndësishëm i cili plotëson njëkohësisht disa nevoja të sistemit gjyqësor.

Inventarizimi i çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata, do të zbatohet në Gjykatën e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, procesi cili do të kryhet nga nëpunësi civil gjyqësor i caktuar, duke ndjekur radhën kronologjike të regjistrimit të tyre në gjykatë.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është parashikuar që inventarizimi i çështjeve civile të kryhet sipas llojit të çështjes: i) civile themeli; (të cilat ndahen në civile të përgjithshme, familjare dhe tregtare) ii) civile të veçanta; iii) kërkesa civile. Sa i përket inventarizimit të çështjeve penale në këtë gjykatë, për nga natyra dhe lloji i çështjes ata do të klasifikohen në: i) penale themeli; ii) penale në fazën e hetimit paraprak; iii) penale të veçanta; iv) penale në fazën e ekzekutimit; v) kërkesa penale.

Ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit ky inventarizim përfshin çështjet të cilat nga natyra klasifikohen në i) kërkesëpadi me palë kundërshtare; ii) kërkesa pa palë; iii) të tjera.

Veprimet konkrete që duhet të ketë parasysh nëpunësi civil gjyqësor gjatë procesit të analizimit dhe klasifikimit të çështjeve fillojnë me verifikimin e akteve të administruara në dosjen gjyqësore dhe vijojnë me verifikimin e elementëve kryesorë të çështjes, siç janë: i) numri i regjistrimit themeltar të çështjes së regjistruar në gjykatën e apelit; ii) data e regjistrimit të saj në gjykatën e apelit; iii) gjyqtarin relator që është shortuar për shqyrtimin e saj; iv) gjykata nga vjen çështja; v) palët ndërgjyqëse sipas pozicionit procedural në gjykim; vi) llojin e çështjes sipas listës së kategorive kryesore civile, penale, administrative; vii) përshkrimin e çështjes sipas listës së nënkategorive, kryesore, civile, penale, administrative; viii) nëse çështja përfshihet në listën e çështjeve prioritare sipas vendimit nr. 78, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; ix) objekti i mosmarrëveshjes; x) baza ligjore; xi) vendimi i dhënë nga shkalla e parë e gjykimit i cili do të identifikohet me numër, datë dhe llojin e tij; xii) vlera e padisë; xiii) nëse çështja është kthyer për rigjykim.

Pasi janë identifikuar elementët kryesorë të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, nëpunësi civil gjyqësor kryen edhe një identifikim paraprak nëse mjeti procedural që ka investuar gjykatën e apelit është paraqitur brenda apo jashtë afatit; ka ose jo të meta; është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit lejohet apo nuk lejohet të bëhet ankim; është bërë nga një

person që legjitimohet apo jo që të bëjë ankim; është hequr dorë ose jo nga ankimi /ankimi i veçantë, për të ndihmuar gjykatën për të.

Analizimi dhe klasifikimi i çështjeve në kategori dhe nënkategori do të bëhet sipas bazës së të dhënave të përgatitur për këtë qëllim sipas shtojcës 1 që i bashkëlidhet projektvendimit.

Organi që miraton listën e llojit të çështjes civile, penale e administrative sipas kategorive kryesore si dhe listën e përshkrimit të çështjes sipas nënkategorive kryesore, me qëllim grupimin e tyre është Këshilli i Gjykatës.

Mbarëvajtja e procesit do të sigurohet përmes një procesi raportimi në Këshill në mënyrë periodike, si një mekanizëm monitorimi dhe analizimi të shkallës së zbatimit dhe respektimit të rregullave të këtij Udhëzimi.

- **Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit"**

Shtesat dhe ndryshimet në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kanë si qëllim përcaktimin e çështjeve të cilat do të trajtohen me prioritet. Këto rregulla synojnë të sigurojnë një qasje të unifikuar të gjykatave në trajtimin e çështjeve të prapambetura dhe të bëjnë të mundur trajtimin e tyre sipas një metodologjie gjithëpërfshirëse që përfshin inventarizimin, klasifikimin dhe gjykimin sipas grupçështjeve me përparësi si dhe radhës kronologjike të ardhjes së çështjes në gjykatë.

Gjithashtu kjo reflekton edhe nevojën e pasurimit me ato grupçështje për të cilat praktika gjyqësore aktuale ka diktuar nevojën prioritare të gjykimin të tyre dhe të cilat nuk ishin përfshirë në vitin 2019. Konkretisht propozohet të përfshihen në listën e çështjeve për shqyrtim në mënyrë të përshpejtuar:

1. çdo çështje me pasoja juridike për përfitimin e pensionit;
2. çështjet me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga marrëdhënia e punës apo ato që rrjedhin nga shpërblimi i dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës;
3. çështjet në të cilat pala ka paraqitur ankim jashtë afatit kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim apo nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
4. çështjet që përfitojnë nga amnistia sipas ligjit përkatës;
5. vendimet e ndërmjetme me objekt sigurim padie apo pjesëtim pasurie faza e parë;
6. gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit;
7. çështjet për cilat padia nuk e kalon vlerën e 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekëve;
8. çështjet me objekt strehimin social;
9. çështjet që kanë për objekt të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;

Ndryshimet në rregullat ekzistuese kanë si qëllim të përmirësojnë shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimeve dhe, për rrjedhojë, uljen e çështjeve të prapambetura. Në këtë proces merr një rol të një rëndësie të veçantë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve në përcaktimin e grupçështjeve të cilat do të caktohen të gjykohen në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre duke sjellë një qëndrim të unifikuar të trupës. Gjithashtu, rëndësi të veçantë merr edhe ndjekja dhe monitorimi periodik nga Këshilli i Gjykatës dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor në aplikimin e unifikuar të kësaj metodologjie, duke garantuar zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të ndërmarra në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore sipas parimeve të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor.

- **Projektvendim “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore të gjykimit të çështjeve”**

Kuadri ligjor⁶³ përcakton se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregullat standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave, të cilat përfshijnë parashikime për afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore.

Përcaktimi i rregullave për afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore të gjykimit të çështjeve synon të krijojë standarde të njëjta për të gjithë gjyqtarët, ngarkesë të ekuilibruar të punës në gjykata dhe rritjen e besimit të publikut në gjyqësor.

Në hartimin e këtij projektvendimi janë marrë për referencë të dhëna statistikore të mbledhura gjatë procesit të krijimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe janë mbajtur parasysh edhe standardet e vendosura në vendimin e vitit 2010 të ish-KLD-së.

Në këtë projektvendim, afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore janë orientuese dhe përcaktohen me qëllim rritjen e efektivitetit të gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ të shkallës së parë dhe të apelit si dhe të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të shkallës së parë dhe të apelit.

Vlen për t'u theksuar se afatet standarde minimale kohore zbatohen vetëm për ato çështje për të cilat ligji nuk parashikon afate gjykimi. Standardi minimal kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor minimal, nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes. Ndërsa standardi minimal sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale përcaktuar në këtë projektvendim.

Sa i përket standardeve minimale kohore, është bërë një ndarje e tyre duke pasur parasysh të dhënat statistikore në lidhje me: për sa kohë janë gjykuar pjesa më e madhe e

⁶³ Neni 94 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar.

çështjeve duke i grupuar çështjet në varësi të llojit të tyre, objektit apo edhe kompleksitetit të çështjeve. Gjithashtu është mbajtur parasysh dhe neni 399 i K.Pr.Civile në lidhje me afatet e arsyeshme.

Ndërsa lidhur me standardet minimale sasiore është përcaktuar sa çështje gjykojnë gjyqtarët referuar çështjeve të cilat janë komplekse (me palë kundërshtare) dhe çështjet e lehta që përgjithësisht kanë qenë çështje pa palë kundërshtare.

Në projektvendim është parashikuar që kryetarët e gjykatave do të monitorojnë zbatimin e afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore, çdo tre muaj dhe do përcjellin raportin përkatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me qëllim rritjen e efektivitetit, miradministrimin gjyqësor dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë, është parashikuar që mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, mund të përcaktojë standarde të tjera kohore dhe sasiore duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve.

- **Draft “Strategjia kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” 2024-2027**

Kjo strategji është në përputhje me objektivat strategjike të Planit Strategjik të KLGJ-së 2022 – 2024 dhe Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021 – 2025. Ajo përcakton përmasat e problemeve në gjykata, të cilat shkaktojnë volumin e madh të çështjeve të prapambetura, si dhe ofron një perspektivë për sa i përket skenarëve për pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme. Strategjia parashikon një set masash ligjore dhe administrative, për uljen e backlog-ut dhe parandalimin e tij në të ardhmen.

Në periudhën 2024 – 2027, për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë dhe gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe administrativ përcaktohen këto synime strategjike:

- a. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të gjitha çështjet në pritje mund të zgjidhen në 2025/2026 nëse rritet produktiviteti i gjyqtarëve ndërsa volumi i çështjeve të ardhura nuk rritet në mënyrë të ndjeshme.
- b. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, volumi i çështjeve të prapambetura do të ulet me 20 – 30% (pakësim me 10.000 deri në 15.000 çështje).
- c. Në Gjykatën Administrative të Apelit, volumi i çështjeve të prapambetura do të ulet me 25% (pakësim i prapambetjes me 5000 çështje).

Me qëllim realizimin e synimeve dhe objektivave strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, janë përcaktuar objektivat strategjike të mëposhtëm:

1. Ulja strukturore e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 2024 – 2027 nëpërmjet marrjes së masave konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Këto masa konsistojnë në krijimin e një inventari të çështjeve të prapambetura, krijimin e ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, menaxhimi i diferencuar i çështjeve, si dhe miratimi i planeve individuale të veprimit nga ana e gjykatave.
 2. Fuqizimi i kapaciteteve në gjykata me marrjen e masave për plotësimin e vakancave nëpërmjet rekrutimit/emërimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, rritjes së numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, rritjes së numrit dhe thjeshtimit të procesit të punësimit të ndihmësve ligjorë apo stafit tjetër mbështetës jogjyqtar, si dhe trajnimit të ndihmësve ligjorë apo stafit tjetër mbështetës jogjyqtar.
 3. Përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës nëpërmjet delegimit të detyrave të caktuara në lidhje me çështje të thjeshta nga një gjyqtar tek stafi mbështetës ndihmës ligjorë dhe/ose sekretarë gjyqësorë me përvojë, nxitja e shkëmbimit të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësorë si vendimeve gjyqësore ndërmjet gjykatave apo aktorëve të tjerë në proces, zhvillimi i seancave gjyqësore në distancë, përdorimi i modeleve standarde për vendimet gjyqësore, urdhrat e gjykatës apo dokumente të tjera si dhe zgjedhje me efektive e trupave gjykues të gjykatave të apelit.
 4. Prezantimi i një pakete ndryshimesh ligjore të përqendruara në uljen e çështjeve të prapambetura dhe zbatimin e masave konkrete për parandalimin e çështjeve të prapambetura në gjykata për të shmangur rritjen e tyre në të ardhmen. Këto ndryshime kanë si qëllim promovimin e modelit të një gjyqtari të vetëm në gjykimin e çështjeve të caktuara, kufizimi i mundësisë së ankimit për një lloj çështje të caktuar, rritja e numrit të ndihmësve ligjorë, shtimi i kompetencave të Këshillit të Gjykatës, etj.
 5. Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasore dhe matja e performancës së gjyqtarëve.
 6. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë nëpërmjet zhvillimit të takimeve periodike dhe lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit.
 7. Rritja e transparencës dhe e besimit të publikut.
- **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar**

Ky projektligj synon të zgjerojë kategorinë e çështjeve të cilat mund të shqyrtohen nga gjykata e apelit me trupë gjyqësore të përbërë nga një gjyqtar për të mundësuar zhvillimin e proceseve gjyqësore më efikase dhe në një kohë më të shkurtër.

Me projektligjin e propozuar, krahas kategorive të çështjeve që përcaktohen nga dispozita në fuqi⁶⁴ do të shqyrtohen me trupë gjyqësore të përbërë nga një gjyqtar edhe ankimet e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare dhe atyre të ndërmjetme, ankimet kundër vendimeve për kërkesën e heqjes dorë nga gjykimi, heqjes dorë nga e drejta e padisë dhe heqjes dorë nga ankimi apo ankimi i veçantë, ankimet dhe ankimet e veçanta kundër vendimeve të dhëna në fazën e ekzekutimit si dhe ankimet e veçanta kundër vendimeve për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore.

Sipas të dhënave statistikore, kategoritë e çështjeve që propozohen të gjykohen në gjykatën e apelit me trupë gjyqësore me një gjyqtar, do të përbënin rreth 15 % të çështjeve që, nëpërmjet ankimeve apo ankimeve të veçanta, i paraqiten për shqyrtim kësaj gjykate.

- **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar**

Ndryshimet e propozuara synojnë lehtësimin e procedurave për gjykim, dhe ngarkesën e punës së trupave gjyqësore të Gjykatës Administrative të Apelit.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet që gjykimi i çështjeve me trupë gjyqësore të përbërë nga një gjyqtar të përfshijë të gjitha çështjet për të cilat gjykata e apelit vihet në lëvizje mbi mjetin procedural të ankimit të veçantë, çështjet që kanë për objekt ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë për kërkesën e heqjes dorë nga gjykimi dhe të heqjes dorë nga e drejta e padisë si dhe çështjet që kanë për objekt ankimet e veçanta kundër vendimeve për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore.

Gjithashtu parashikohet zgjerimi i kategorive të çështjeve për të cilat nuk lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, dhe i kategorisë së çështjeve për të cilat nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

- **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.**

Shtesat dhe ndryshimet në ligjet e sipërcituara vijnë si rezultat i evidentimit të nevojave për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e gjykatave. Kjo veçanërisht në drejtim të krijimit të mundësive për të rritur burimet njerëzore, si edhe për të krijuar kushtet që vetë gjykatat dhe Këshilli vlerësojnë, sipas rrethanave të veçanta dhe ecurisë së shqyrtimit gjyqësor të çështjeve, për ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse që i shërbejnë rritjes së efektivitetit, produktivitetit, shpejtësisë dhe cilësisë së gjyqimit të çështjeve.

⁶⁴ Neni 35 i ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Me shtesat dhe ndryshimet që propozohen, këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë do të përzgjidhen nëpërmjet kriterëve dhe procedurave konkurruese nga vetë kjo Gjykatë dhe do të emërohen nga Këshilli i Gjykatës njëloj si nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë. Gjithashtu, këto ndryshime i atribuojnë Këshillit të Gjykatës kompetencave shtesë në përcaktimin e grupçështje të caktuara, të cilat do të shqyrtohen përtej radhës së regjistrimit të çështjeve në gjykatë.

Një tjetër aspekt i ndryshimeve ligjore të propozuara targeton numrin e ndihmësve ligjorë në gjykata, konkretisht ndryshimet e propozuara parashikojnë mundësinë që numri i përgjithshëm i ndihmësve ligjorë në gjykata të jetë deri në dyfishin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve. Kjo në dallim nga kuadri në fuqi⁶⁵, i cili përcakton se numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Gjithashtu parashikohen ndryshime edhe në kriteret e pranimit në pozicionin e ndihmësit ligjor si dhe saktësohen dhe plotësohen kriteret mbi pagën referuese, masën e pagës dhe përshkallëzimin e pagës që përfiton ndihmësi ligjor kur ushtron detyrën në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, përshkallëzim që i përgjigjet shkallës së vështirësisë, përgjegjësisë dhe përvojës së kërkuar për ushtrimin e detyrës në secilën nga këto shkallë gjykimi.

Përmirësimi i trajtimit financiar të ndihmësit ligjor synon të rrisë interesin e profesionistëve të kualifikuar për të konsideruar këtë pozicion pune në shërbimin civil gjyqësor.

- **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar**

Edhe këto propozime kanë si synim shtimin e kategorive të çështjeve penale të cilat gjykohen nga një gjyqtar. Konkretisht është parashikuar të shqyrtohen me trupë gjyqësore të përbërë nga një gjyqtar edhe kategoritë e çështjeve të gjykuara në shkallë të parë për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se dy vjet si dhe rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë⁶⁶.

Gjithashtu është parashikuar një shtesë në rastet e mospranimit të ankimit, i cili bëhet në dhomë këshillimi nga Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin.

Në projektligj propozohet që lidhur me mënyrën e njoftimeve të mëtejshme të palëve të shtohet dhe togfjalëshi “*të dhënat e adresës elektronike*” për efekte të procedimit. Mënyra e njoftimit edhe nëpërmjet adresës elektronike do të lehtësojë dhe shpejtojë njoftimin e

⁶⁵ Neni 42, pika 1/1 e ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

⁶⁶ Neni 420 i Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

akteve, krahas njoftimit në format e tjera sikurse parashikon dispozita⁶⁷, ose në rastet kur njoftimi nuk mund t'i dorëzohet personalisht të pandehurit, në banesën e tij ose në vendin e punës.

- **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi I Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (lidhur me lëshimin e Urdhrave të ekzekutimit)**

Me këto shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile synohet që të zgjerohet gama e titujve ekzekutiv duke parashikuar për herë të parë si tituj ekzekutiv:

- a. aktet noteriale që kanë formë të ekzekutueshme;
- b. akt marrëveshjet me të cilat bashkëshortët japin pëlqimin reciprok për zgjidhjen e martesës së tyre, nëpërmjet kundërfirmimit të saj nga avokatët e tyre dhe të vërtetuara zyrtarisht nga Noteri, në përputhje me masat e parashikuara nga Kodi Familjes;
- c. titujt ekzekutiv të lëshuar nga nëpunësit publik ose personat juridik të të drejtës publike të cilësuar si të tilla me ligji, ose vendimet të cilave ligji u jep efektet e një vendimi;
- d. aktet noteriale që kanë formë të ekzekutueshme. Me këtë risi i jepet forcë ekzekutive të gjitha akteve noteriale që kanë formë të ekzekutueshme duke mos pasur nevojë për shqyrtime gjyqësore të mëtejshme, për të urdhëruar gjyqësisht zbatimin e tyre;

Shtesat dhe ndryshimet parashikojnë 3 autoritete publike për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit të cilët janë: **i)** gjyqtari, për urdhrat që lëshohen nga gjykata, **ii)** noteri, për aktet noteriale edhe **iii)** nëpunësi publik ose organi apo personi juridik i të drejtës publike që ka lëshuar titullin.

Decentralizimi i urdhrave të ekzekutimit do të sjellë uljen e numrit të shqyrtimit gjyqësor të tyre, duke ndikuar drejtpërdrejtë në uljen e ngarkesës së punës së gjyqtarëve. Për rrjedhojë, do të krijohen hapësirat e nevojshme për gjyqtarët që të përkushtohen më shumë në zgjidhjen e çështjeve në themel duke pasur më shumë kohë për arsyetimin më cilësor të vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu parashikohet që për titujt e tjerë ekzekutiv, urdhri i ekzekutimit do të lëshohet nga autoritete kompetente nëpërmjet formulës ekzekutive që bëhet duke e vendosur në një kopje origjinale ose të vërtetuar të origjinalit të titullit të ekzekutimit. Një ndryshim i tillë do të ulë kohën e nevojshme për shqyrtimin edhe lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, pasi nuk do të jetë më e nevojshme arsyetimi i vendimeve gjyqësore për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Në të njëjtën kohë ky ndryshim do t'i japë akteve të organeve publike/shtetërore autoritetin e titujve ekzekutiv duke përcaktuar ekzekutimin e

⁶⁷ Neni 140, pika 7 e Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

menjëhershëm të tyre pa pasur nevojë për lëshimin paraprak të urdhrimit të ekzekutimit nga gjykata.

Së fundmi në këtë projektligj parashikohet një ndryshim lidhur me terminologjinë e përdorur nga ligjvënësi në formulimin e nenin 514, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile. Me këtë ndryshim parashikohet që dublikata e urdhrimit të ekzekutimit, në kushtet kur urdhri i ekzekutimit humbet ose zhduket, të lëshohet duke respektuar të njëjtin rit procedural që ndjek edhe lëshimi i vetë urdhrimit të ekzekutimit, pra duke e shqyrtuar atë në “dhomë këshillimi”.

VII. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE

METODOLOGJIA

Analiza statistikore e sistemit gjyqësor e realizuar në mënyrë vjetore nga KLGJ-ja në bazë të metodologjisë së CEPEJ-it, përpunon dhe analizon 5 indikatorë apo tregues të funksionimit të gjykatës, të tillë si ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR), rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER), norma e zgjidhjes së çështjeve (treguesi CR), raporti i qarkullimit të çështjeve (treguesi RQC) dhe koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (treguesi DT), mund të identifikohen më mirë sfidat dhe mundësitë për përmirësim në sistemin gjyqësor.

Analiza e këtyre treguesve për secilën gjykatë dhe përpunimi i tyre për grupet e gjykatave ofron informacion të vlefshëm për performancën e tyre.

Në përgjithësi, analiza statistikore e sistemit gjyqësor në bazë të metodologjisë së CEPEJ-it, sjell një qasje më të përpiktë dhe të bazuar në fakt për të vlerësuar dhe përmirësuar performancën e sistemit gjyqësor në Shqipëri.

KATEGORIA	TREGUESI	ÇFARË TREGON
BURIMET NJERËZORE	Burimet njerëzore <i>efektive</i>	Llogaritur mbi bazën e kontributit real dhe konkret të çdo gjyqtari.
MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE	<i>Backlog</i> -u i mbartur nga një vit më parë	Përcaktohet nga numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit. Sa më i madh të jetë <i>backlog</i> -u aq më pak eficient ka qenë sistemi gjyqësor / gjykata në menaxhimin e fluksit të çështjeve në vite dhe aq më shumë kohë do t'i duhet për të gjykuar çështjet.
	Çështjet e reja të regjistruara	Numri i çështjeve që regjistrohen në gjykatë gjatë periudhës së raportimit. Tregon trendin e çështjeve që pritet të regjistrohen në gjykatë përcaktuar nga ndryshime ligjore, demografike, ekonomike, sociale, etj.

	Ngarkesa e punës në gjykatë	Shuma e <i>backlog</i> -ut dhe çështjet e reja të regjistruara
	Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (treguesi WR)	Ngarkesa e punës në gjykatë në raport me numrin efektiv të gjyqtarëve. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të përcaktuar ngarkesën e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.
	<i>Backlog</i> -u i mbartur në fund të periudhës së raportimit	Numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit. Krahasuar me atë të llogaritur në fillim të periudhës së raportimit tregon ecurinë gjatë vitit të gjykatës / juridiksionit.
EFICIËNCA	Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)	Raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura dhe numrit të gjyqtarëve efektivë gjatë periudhës së raportimit. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të vlerësuar rendimentin e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.
	Koha e nevojshme për evadimin e çështjes (treguesi DT) shprehur në ditë	Raporti i numrit të çështjeve të pazgjidhura me numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar shumëzuar me 365. Raporti mat se sa shpejt sistemi gjyqësor punon mbi çështjet e marra, që do të thotë sa kohë duhet për një lloj të caktuar çështjeje për t'u zgjidhur. Ky tregues jep një perceptim se si sistemi gjyqësor menaxhon sasinë apo fluksin e çështjeve të ardhura.
	Norma e likuidimit të çështjeve (treguesi CR)	Përcaktohet nga raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara brenda një periudhe dhe çështjeve të reja, dhënë në përqindje.

7.1 Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

Një ndër synimet kryesore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që prej konstituimit të tij ka qenë funksionalizimi i plotë i Gjykatës së Lartë, synim ky i cili është realizuar plotësisht në vitin 2023. Gjatë këtij viti, Këshilli ka përfunduar procedurat e ngritjes në detyrë pranë kësaj gjykate për 3 (tre)⁶⁸ pozicione të lira nga radhët e gjyqtarëve, konkretisht për një pozicion në fushën e të drejtës administrative dhe dy pozicione në fushën e të drejtës civile.

Me emërimin e tre gjyqtarëve të rinj pranë Gjykatës së Lartë, është plotësuar tashmë trupa gjyqësore prej 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarësh. Aktualisht, Këshilli vijon procedurat e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion në fushën e të drejtës penale për shkak të përfundimit të mandatit të një anëtari.

Burimet njerëzore në Gjykatën e Lartë

Masat e marra gjatë vitit 2022, për plotësimin e vendeve të lira të trupës gjyqësore, ashtu si përcaktuar me dekret të Presidentit të Republikës për Gjykatën e Lartë, kanë prodhuar

⁶⁸ Me vendimet nr. 270, 25.05.2023, nr. 458, datë 25.07.2023, nr. 474, datë 13.09.2023 të KLGJ-së.

rezultatet e pritshme në 2023. Konkretisht, gjatë vitit raportues kanë ushtruar efektivisht detyrën 16.3⁶⁹ gjyqtar, në ndryshim nga një vit më parë kur gjykata funksiononte me vetëm 13.25 gjyqtarë.

Plotësimi në masën 86% i vakancave të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, ka sjellë një reduktim të raportit të administratës mbështetëse për gjyqtar, në krahasim me një vit më parë. Tashmë një gjyqtar përfiton mbështetjen administrative nga 6.3 nëpunës nga 7.1 nëpunës që përfitonte një vit më parë.

Në dritë të sa më sipër, ndonëse gjykata funksionon me të njëjtën organikë ashtu si miratuar, dhe në kushtet kur numri i nëpunësve efektivisht në detyrë është rritur, raporti staf mbështetës për gjyqtar, vendosur përballë vitit 2022, vjen me një ulje me 0.8 nëpunës më pak për secilin gjyqtar efektivisht në detyrë.

Në detaje, shifrat e burimeve njerëzore të Gjykatës së Lartë për vitin **2023**, paraqiten në tabelë më poshtë:

Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vsdekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektivs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
19	16.3	86%	126	102.4	81%	6.6	6.3

Vlerësohet se, mbështetja administrative, sjell ulje në kohën e administrimit të dosjes nga gjykata, duke ulur kështu kohën efektive që secili gjyqtar i kushton shqyrtimit të dosjes.

Delegimi tek stafi administrativ, i disa veprime me natyrë administrative të menaxhimit të dosjes, mundëson që trupa gjyqësore të përqendrohet në analiza ligjore apo të jurisprudencës, duke rritur si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe cilësore vendimmarrjen.


Kjo ndihmë në procedura administrative, gjendur përpara faktit të plotësimit të trupës gjyqësore të gjykatës, duhet të vijojë të ndiqet me një rritje në numrin e stafit (nëpunësit civil gjyqësor), gjë e cila do të reflektohet në përmirësimin e performancës së gjykatës.

Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë

Backlog –u: Gjykata e Lartë e ka filluar vitin **2023** me një total prej **31,827** çështjesh në pritje të gjykimit⁷⁰. Ky volum mbetet i trashëguar nga vitet e mëparshme dhe përbën interesin kryesor të vetë gjykatës, si edhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Krahasuar me një vit më parë, çështjet në pritje të gjykimit, shënojnë një ulje prej **4,239** çështjesh ose


⁶⁹ Shifra, në të gjithë pjesën e analizës statistikore, janë paraqitur me presje dhjetore për shkak të përlogaritjeve aritmetikë për secilin indikator.

11.8%. Grafiki i stokut të çështjeve në pritje të gjyqimit për 3 vitet e fundit shfaqet si vijon:




Ulja e stokut me **4,239** çështje ose **11.8 %**, vjen si rezultat i shtimit të numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë. Kjo e dhënë tregon në mënyrë matematikore zgjidhjen e ngërçit sa i takon funksionalizimit të Gjykatës së Lartë.

Përbërja e backlog-ut: Sa i përket natyrës së çështjeve në pritje të gjyqimit në fillim të periudhës, të dhënat tregojnë se 54% e stokut të Gjykatës së Lartë përbëhet nga çështje të natyrës civile dhe 32% nga çështje të natyrës administrative. Rezulton se numrin më të vogël të çështjeve e zënë çështjet penale me 14% në backlog. Përqindja e ulët në stokun e çështjeve penale vjen për shkak të ndjeshmërisë që kjo natyrë çështjesh mbart, për vetë palët në proces por edhe publikun, kjo në kuadër të respektimit të të drejtave themelore të njeriut; duke veçuar këtu nenin 5 dhe 6 të KEDNJ71. Për këtë, afati i gjyqimit në çështjet me natyrë penale paraqitet më i ngutshëm, pasi kjo kategori personash në gjykim, sipas rastit, gjendet në kufizim të lirisë.



Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit **2023** janë regjistruar në Gjykatën e Lartë




2145 çështje të reja për t'u shqyrtuar. Në krahasim me një vit më parë, shënohet një rritje prej 49 regjistrime të reja, kryesisht të natyrës administrative. Një


faktor që mund të ketë ndikuar në këtë drejtim, është rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit me mesatarisht 3 gjyqtarë më shumë, krahasuar me një vit më parë.

⁷¹ E drejta për liri dhe siguri, neni 5; si dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor, neni 6; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Sa i përket natyrës së çështjeve të reja të paraqitura në gjykatë gjatë vitit 2023, çështjet penale (847 çështje) përbëjnë 39.5%, çështjet civile (742 çështje) 34.6 % dhe çështjet administrative (556 çështje) vetëm 25.9% të totalit të çështjeve të reja të regjistruara në Gjykatën e Lartë gjatë vitit të raportimit.



Ngarkesa e Gjykatës së Lartë: Ngarkesa e një gjykate përbëhet nga tërësia e çështjeve në administrim të saj gjatë afatit kohor të përcaktuar. Ajo është shuma e *backlog*-ut të çështjeve nga vitet e mëparshme dhe çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë. Grafiki i paraqitur si më poshtë:



Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): Ngarkesa totale e gjykatës ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në treguesin WR, i cili shpreh tërësinë e çështjeve të mbartura (*backlog*) dhe të regjistruara rishtazi, të cilat janë për shqyrtim nga një gjyqtar. Në vitin 2023, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kanë pasur mesatarisht 2084.2 çështje për të shqyrtuar secili.

Nga tabela e mëposhtme vërehet se emërimet e reja në këtë gjykatë kanë sjellë ulje prej 28% të ngarkesës mesatare për gjyqtar. Kjo diferencë përkthehet në rreth 798 çështje më pak për secilin gjyqtar.

Numri efektiv i gjyqtarëve 2022	Numri efektiv i gjyqtarëve 2023	# në %	WR 2022	WR 2023	# në %
13.25	16.3	+23%	2880.2	2084.2	-28%

Treguesit e efikasitetit:

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER): Shpreh numrin mesatar të çështjeve të përfunduara nga një gjyqtar, gjatë vitit të raportuar. Gjatë vitit 2023 vërehet se rendimenti i gjyqtarëve në këtë gjykatë ka shënuar rritje. Gjatë vitit 2023, në gjashtë mujorin e parë 15 gjyqtarë dhe në gjashtë mujorin e dytë 18 gjyqtarë (mesatarisht 16.3)

efektiv të Gjykatës së Lartë kanë gjykuar mesatarisht 485.5 çështje secili, pra 7.5 çështje më shumë krahasuar me vitin paraardhës.

Të dhënat krahasimore për periudhën 2022-2023 si më poshtë pasqyruar në tabelë:

Gjykata	Çështje të gjykuara 2022	Çështje të gjykuara 2023	# në %	Gjyqtarë 2022	Gjyqtarë 2023	# në %	ER 2022	ER 2023	# në % i ER
GJ. Lartë	6335	7914	25%	13.25	16.3	23 %	478	485.5	1.6 %


Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë vërehet se 16 gjyqtarë kanë gjykuar bashkërisht 25% më shumë çështje se 13 gjyqtarët në funksion gjatë vitit 2022. Vlen të sillet në vëmendje se, si rrjedhojë e natyrës kolegjiale të gjykimit në Gjykatën e Lartë, rendimenti për gjyqtar paraqet vështirësi në analizë, pasi rezultati për secilin gjyqtar, ndërvaret me performancën e trupës gjyqësore brenda kolegjit.

Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): Përcakton aftësinë e gjykatës për të ruajtur ritmin mes çështjeve të përfunduara dhe çështjeve të reja të regjistruara. Ky indikator përcaktohet për secilën kategori çështjesh civile, penale dhe administrative. Nëpërmjet treguesit CR dallohet lehtësisht aftësia e gjykatës për të ruajtur, rritur apo ulur nivelet e saj të *backlog*-ut.

Për vitin 2023, normat e likuidimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë kanë vijuar me trendin rritës të shënuar një vit më parë. Norma e likuidimit të çështjeve ka kaluar pragun e 100% për të tre kategoritë e çështjeve, duke shënuar ulje në çështjet e mbartura. Rritje vazhdon të shënohet në normën e likuidimit të çështjeve penale me 37.4% dhe civile me 28.1%, krahasuar me normën e vitit 2022. Vërehet se treguesi CR administrativ në vitin 2022 shënonte vlerën 613%, ndërsa gjatë vitit 2023 rezulton në vlerën 535.61% duke treguar kështu kapacitetin e gjykatës të ruajë ritmet e prurjeve të reja dhe njëkohësisht të evadojë çështje të trashëguara nga vitet e mëparshme, pavarësisht se këtë vit ka një rënie të lehtë me 12.6%.

Gjykata ka mundur të ruajë ritme të larta likuidimi duke shqyrtuar 3.7 herë më shumë çështje sesa regjistrimet e reja.

Treguesi	Viti 2022	Viti 2023	# në % e CR.
CR civile	283%	362.53%	+28.1%
CR administrative	613%	535.61%	-12.6%
CR penale	193%	265.17%	+37.4%



Në vitin 2023, janë evaduar 7914 çështje. Krahasuar me vitin 2022, Gjykata e Lartë ka përfunduar 1579 çështje më tepër duke rritur nivelin e çështjeve të gjykuara me 25%. Ndërsa në 3 vite, kjo gjykatë ka 5-fishuar çështjet e gjykuara duke kaluar nga 1478 çështje të evaduara në 2020 në 7914 çështje të evaduara në vitin 2023. Këto vlera tregojnë efektin e drejtpërdrejtë të rritjes së numrit të

gjyqtarëve në funksionimin e gjykatës.

Lidhur me natyrën e çështjeve të evaduara gjatë vitit raportues, e shprehur grafikisht situata paraqitet si vijon:




Nga të dhënat statistikore Gjykata e Lartë ka balancuar punën midis tre kategorive të çështjeve, duke treguar trajtim thuajse të barabartë të tyre. Gjatë vitit 2023, 37.6% e çështjeve të shqyrtuara janë të natyrës administrative, 34% janë çështje civile dhe 28.4% janë çështje penale.

Backlog-u në fund të periudhës: tregon çështjet të cilat nuk u gjykuan gjatë vitit 2023 dhe presin për t'u gjykuar në vitin pasardhës. Pas uljes së stokut me 1% gjatë vitit 2021, vërehet se vijimi i masave për rritjen e efijencës dhe emërimet e reja në rangun e gjyqtarëve kanë dhënë rezultatet e stokut të çështjeve të patrajtuara. Në 31 dhjetor 2023, *backlog*-u i Gjykatës së Lartë ka shënuar vlerën 26.058 çështje, 18% më i ulët se në fillim të vitit duke ulur ndjeshëm, rritjen e pësuar gjatë vitit 2019 dhe 2020.

Ndonëse treguesit e efijencës vijnë të përmirësohen nga viti në vit, *backlog*-u i trashëguar mbetet problematik dhe kërkon marrjen e masave strukturore për zgjidhjen e situatës.

Në përfundim theksojmë se, projeksioni i bazuar mbi treguesit e efijencës për vitin 2023 rezulton pozitiv. Nisur nga ritmi i efijencës së vitit 2023, projeksioni i mundshëm është se Gjykata e Lartë nuk do të



ketë backlog pas 4.5 vitesh. Në pritje të gjykimit në fund të vitit raportues mbeten ende 26,058 çështje.

Gjykata e Lartë, gjatë periudhës 2021-2023, ka dalë në vendimmarrje për njësim të praktikës gjyqësore.

Kolegjet e Gjykatës së Lartë, gjatë periudhës 2021 – 2023, kanë vendimmarrje për 22 vendime njësuere, nga këto 12 vendime njësuere për ndryshimin e praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal, 6 vendime njësuere nga Kolegji Administrativ dhe 4 vendime njësuere nga Kolegji Civil.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë vendimmarrje për 4 vendime njësuere, ku 2 janë vendime në lëndë penale (për 1 është vendosur ndryshimi i praktikës gjyqësore), 1 vendim rishikimi në KBGJL në lëndë civile të vitit 2006 dhe 1 vendim kompetence i përcjellë nga KBGJL në KPA, në lëndë administrativo-kushtetuese.

Gjetjet kryesore!

- Gjykata e Lartë e ka filluar vitin 2023 me një total prej 31,827 çështjesh në pritje të gjykimit.
- Ajo ka funksionuar me 86% të gjyqtarëve dhe 81% të administratës gjyqësore të parashikuar në organikë.
- Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Lartë janë regjistruar 2,145 çështje të reja.
- Çdo gjyqtar ka mesatarisht 2084 çështje në ngarkim dhe gjatë 2023 ka arritur të gjykojë 486 çështje secili.
- Gjatë vitit raportues Gjykata e Lartë ka arritur të:
 - evadojë 7914 çështje civile, administrative dhe penale;
 - të vijojë me trendin rritës të normës së likuidimit të çështjeve civile dhe administrative dhe të kalojë pragun me 100% për të tria kategoritë.
- Të mbyll vitin 2023 me një stok të reduktuar me 18 %. Në 1 janar 2024, në Gjykatën e Lartë presin të shqyrtohen 26,058 çështje (*backlog-u* i vitit 2023).

7.2 Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Edhe gjatë vitit 2023, Këshilli i kushtoi një rëndësi të veçantë caktimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke vijuar me ritme të shpejta për plotësimin e vakancave të mbetura.

7.2.1 Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është funksionale me 10 gjyqtarë nga 11 që ka organika, sipas konfigurimit të trupave gjykses dhe në

përputhje me organikën e saj të parashikuar nga ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Burimet njerëzore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Vëmendja e veçantë ndaj kësaj gjykate nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si edhe përdorimi i mekanizmave alternative ndaj ngritjes në detyrë, sikurse është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ushtrojnë detyrë funksionin në mënyrë të përhershme, kanë sjellë rritje në numrin e gjyqtarëve që gjykojnë çështje në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në krahasim me vitin 2022. Sa i përket situatës tërësore të burimeve njerëzore, ajo paraqitet si vijon:

Nr. i gjyqtarëve sipas organikës	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiviteti vs Organika në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiviteti vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
11	10	91%	31	22.6	73%	2.8	2.3


Gjatë vitit **2023**, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka punuar me **91%** të organikës së gjyqtarëve, thënë ndryshe me **10** gjyqtar, **2.09** gjyqtarë më shumë, krahasuar me vitin **2022** kur gjykonin vetëm **7.91** gjyqtar.

Trupa gjyqësore është asistuar nga **73%** e stafit administrativ të planifikuar, që rezulton në një raport **2.3** nëpunës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë. Kjo vlerë shënon ulje, edhe pse organika e miratuar e kësaj gjykate apo numri i nëpunësve efektivisht në detyrë, nuk ka ndryshuar. Përjashtim me një vit më parë, raporti staf mbështetës për gjyqtar është ulur me **0.6** nëpunës, çka vjen si rezultat i rritjes së numrit të gjyqtarëve efektiv.

Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar


Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka filluar punën në **1 janar 2023** me një ngarkesë (*backlog*) prej **34** çështjesh në pritje për t’u gjykuar,

me **10** (dhjetë) çështje më shumë se viti paraardhës.




Backlog-u: grafikisht është paraqitur situata e *backlog*-ut në këtë gjykatë në 4 vite. Vërehet se çështjet e mbartura për vitin 2023 janë në vlera më të rritura në krahasim më një vit më parë, me një diferencë prej 10 çështjesh më shumë se viti 2022.

Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit 2023 në këtë gjykatë janë regjistruar një total prej 288 çështjesh të reja. Në krahasim me vitin 2022 vlera e regjistrimeve të reja është 15% më e ulët. Në detaje çështjet e paraqitura në gjykatë rezultojnë sipas grafikut në vijim.



Sikurse vërehet në grafik, peshën kryesore të çështjeve të paraqitura në gjykatë e zënë çështjet penale administrative, një trend që vërehet në të katër vitet e studiuar. Për sa i takon numrit të krimeve të regjistruara për vitin 2023 rezulton një ulje me 26 çështje më pak. Çështjet e ligjit antimafia⁷² mbeten në vlera minimale duke u luhatur mes 2 apo 3 çështje në vit në të 4 vitet e njëpasnjëshme.

Në total, **ngarkesa e punës në gjykatë (e cila përbëhet nga backlog-u i vitit pararendës dhe çështjet e regjistruara gjatë vitit të referencës)** paraqitet si vijon:




Nga të dhënat statistikore

të paraqitura në grafik rezulton se ngarkesa totale e gjykatës në vitin 2023 është ulur me 4.7 %. Pavarësisht luhatjeve duhet thënë se Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar rezulton gjykata e apelit me ngarkesën më të ulët në rang republike.


Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): Ky tregues për gjyqtarët që ushtrojnë detyrën në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2023 është 32.2 çështje mesatarisht për gjyqtar. Krahasuar me një vit më parë, bazuar në të dhënat statistikore të vitit 2022, secili gjyqtar kishte në ngarkim mesatarisht 42.7 çështje për të gjykuar. Si pasojë e rritjes së numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në këtë gjykatë, ngarkesa mesatare për gjyqtar është ulur.

⁷² Në kategorinë "Çështje të ligjit antimafia" përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (Ligji antimafia)



Gjatë vitit 2023, gjykata ka evaduar gjithsej 297 çështje, përkundërt 304 çështjeve të gjykuara një vit më parë. Kryesisht çështjet e gjykuara janë të natyrës penale administrative, të cilat zënë 80% të çështjeve të gjykuara në tërësi. Ndërsa janë gjykuar vetëm 0.3% çështje të ligjit antimafia. Të detajuara sipas llojit, çështjet e përfunduara paraqiten në grafik.

Sa i përket vendimmarrjes së gjykatës, vërehet se 240 (ose 81%) e vendimeve të shkallës së parë, janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Ndërsa në 11% të rasteve të shqyrtuara është prishur vendimi i shkallës së parë duke u



disponuar me kthimin e akteve për rigjykim apo ndryshim të vendimit si dhe 8% me disponime të ndryshme. Krahasuar me vitin 2022, vërehet një rritje e nivelit të vendimeve të lëna në fuqi, të cilat në vitin paraardhës përbënin 71% të çështjeve të gjykuara.

Treguesit e efikasitetit


Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER): Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka pësuar një ulje të rendimentit mesatar për gjyqtar me 22%. Gjatë vitit 2023, një gjyqtar ka gjykuar mesatarisht vetëm 29.7 çështje, në krahasim me 38.4 çështje që gjykonte mesatarisht në vitin 2022. Rendiment ky që ka pësuar ulje për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në këtë gjykatë. Kështu, 10 gjyqtarët efektiv të kësaj gjykate kanë përfunduar bashkërisht një total prej 297 çështjesh, pra 2% më pak se një vit më parë.

Gjykata	Çështje të gjykuara 2022	Çështje të gjykuara 2023	# në %	Gjyqtarë 2022	Gjyqtarë 2023	ER 2022	ER 2023	# i ER në %
e Posaçme e Apelit për KKO	304	297	-2%	7.91	10	38.4	29.7	-23%


Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): Norma e likuidimit të çështjeve për vitin 2023 është 103.3%. Krahasuar me vitin paraardhës, ajo rezulton me një diferencë

prej 5.3% më e madhe çka do të thotë se gjykata ka mundur të përfundojë gjatë vitit të raportimit tërësinë e çështjeve të reja të regjistruara, duke ulur kështu nivelin e stokut për vitin pasardhës, i përllogaritur për çdo kategori çështjesh.

Norma minimale e likuidimit shënohet në kategorinë e krimeve me 133% (45% më shumë sesa në vitin 2022).




Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT): Ky tregues është një prej indikatorëve cilësorë të sistemit gjyqësor, i vetmi që lidhet drejtpërdrejt me parimin e drejtësisë pa vonesa, duke shprehur në ditë kohëzgjatjen mesatare të nevojshme për përfundimin e një çështjeje gjyqësore.



Bazuar në të dhënat statistikore, rezulton se gjatë vitit 2023, përdoruesve të gjykatës iu është dashur të presin mesatarisht 30.7 ditë për përfundimin e një çështjeje. Ky indikator rezulton të jetë ulur në krahasim me vitin 2022, ku koha e nevojshme për evadimin e çështjeve ishte 40.8 ditë. Pavarësisht ndryshimit të mesatares, gjykimi në këtë gjykatë mbetet më i shpejti në të gjithë sistemin gjyqësor.

Backlog-u në fund të vitit:

Backlog-u i krijuar në fund të vitit 2023, rezulton më i ulët se në fillim të periudhës. Në pritje të gjykimit për vitin 2023 janë 34 çështje në total. Ulja e backlog-ut në fund të periudhës shpjegohet me rritjen e zgjidhjes së çështjeve, duke i kategorizuar 25 çështje në pritje, si çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga gjykata.



Vjetërsia e çështjesh: Gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 297 çështjesh nga të cilat, 289 çështje që përbëjnë 97% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur më pak se 6 muaj. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 7 çështje ose 2% të çështjeve nga 6-12 muaj dhe 1 çështje 1-2 vjet. Rezulton nuk është shqyrtuar asnjë çështje për më shumë se 2 vjet.



Gjetjet kryesore!

- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO) e ka filluar vitin 2023 me një *backlog* prej 34 çështjesh në pritje të gjykimit.
- Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 297 çështje të reja, (17 çështje më pak, krahasuar me vitin 2022).
- Duke funksionuar me 91% të gjyqtarëve dhe me ngarkesë më të lartë të çështjeve në krahasim me vitin 2022, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO) ka arritur të përmirësojë performancën e saj, krahasuar me vitin paraardhës.
- GJPAKKO gjatë vitit 2023 ka:
 - Mundësuar një nivel stoku të ulët të çështjeve të mbartura (11 % e ngarkesës totale);
 - ulur me 22% rendimentin mesatar për gjyqtar si pasojë e rritjes së numrit të gjyqtarëve;
 - realizuar një normë pozitive të likuidimit të çështjeve në masën 103.3%;
 - mbajtur një kohëzgjatje mesatare për likuidimin e çështjeve në masën 30.7 ditë.
- GJPAKKO do të fillojë vitin 2024 me 25 çështje të mbartura nga viti paraardhës.

7.2.2 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Gjatë vitit 2023, Këshilli përmbylli me sukses plotësimin e 3⁷³ vakancave në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe aktualisht vijon procedurat e verifikimit për 3 (tre) pozicione të tjera të shpallura. Ndërkohë, është duke u realizuar nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët në Gjykatën e Posaçme, bazuar në nenet 6 dhe 57, pika 11, të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ky

⁷³ Me vendimet nr. 373, datë 13.07.2023; nr. 389, datë 17.07.2023; dhe nr. 636, datë 19.10.2023 të KLGJ-së.

Komision ushtron funksionet dhe veprimtarinë e tij verifikuese pranë Institucioneve që luftojnë Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pranë Këshillit, mban një komunikim të vazhdueshëm me qëllim mbarëvajtjen e këtij procesi.

Burimet njerëzore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



Situata e burimeve njerëzore gjatë vitit 2023 paraqitet në tabelë, ku vihet re se Gjykata ka funksionuar me 56% të organikës së gjyqtarëve (9% më tepër se viti paraardhës) dhe me 93% të organikës së stafit mbështetës. Raporti staf mbështetës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë është 5.1. Ky raport është ulur krahasuar me një vit më parë për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në këtë gjykatë, krahasuar me raportin e planifikuar në organikë, ku një gjyqtar asistohet mesatarisht nga 3 nëpunës. Situata tërësore e burimeve njerëzore paraqitet si vijon në tabelë:

Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
16	9	56%	49	45.8	93%	3.1	5.1

Backlog-u: Gjykata e ka nisur punën në janar 2023 me 152 çështje në pritje të gjykimit, përkundrejt 181 çështjeve stok në fillim të vitit 2022. Kjo ulje vjen si pasojë e rritjes së numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë duke bërë të mundur shqyrtimin e një numri të konsiderueshëm çështjesh krahasuar me vitin paraardhës. *Backlog-u*



vlerësohet në vlera të pranueshme dhe të justifikueshme si çështje të cilat janë efektivisht në gjykim.

Natyrë e Backlog-ut: Në lidhje me natyrën e çështjeve në pritje të gjykimit rezulton se 51% e tyre i përkasin kategorisë së çështjeve penale administrative duke ulur stokun e kësaj kategorie në krahasim me një vit më parë, ku




stoku përbëhet nga 68 % çështje penale administrative. Vërehet se çështjet e ligjit antimafia rezultojnë në masën 9% në krahasim me një vit paraardhës, kjo shifër është rritur me 5%. Volumi i kategorisë së krimeve është rritur nga 28% në vitin 2022 në 40% në vitin 2023. Kjo për arsye që lidhen me natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve, kohëzgjatjet e gjykimit në rastet e gjykimit të zakonshëm etj.

Krahasuar me vitin 2022, vërehet se gjatë vitit referues në gjykatë është shënuar rritje e numrit të çështjeve të regjistruara me 34.8%. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar në total 716 çështje më shumë se viti 2022.



Sa i përket llojit të çështjeve të paraqitura në gjykatë, situata paraqitet grafikisht në të majtë. Rezulton se 94 % e çështjeve të regjistruara i përkasin kategorisë së çështjeve penale administrative⁷⁴, ndërsa vetëm 4% janë krime dhe 2% çështje për zbatim të ligjit antimafia.

Ngarkesa e gjykatës: për periudhën e raportimit është 2927 çështje, që përbën totalin e çështjeve të mbartura nga viti 2022 dhe çështjeve të reja të paraqitura në këtë gjykatë gjatë vitit 2023. Në mënyrë të detajuar sipas kategorisë së çështjeve, ngarkesa paraqitet grafikisht, ku tregohet edhe një herë se ngarkesa kryesore përbëhet nga çështjet penale administrative.



Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme ngarkesa për gjyqtar në vitin 2023 është rritur me 8.9%. Kjo rritje e ngarkesës është ndikuar kryesisht nga numri i kërkesave penale administrative të reja, edhe pse numri efektiv i gjyqtarëve është rritur nga 7.5 në 9.

⁷⁴ Çështjet gjyqësore penale administrative janë ato që lidhen me shkeljen e ligjit nga organet administrative dhe/ose funksionarët publik, të tilla si; shkelje barazi në tendera, shpërdorim detyre, shkeljet fiskale, ose shkeljet e rregullave të sigurisë publike, etj.

Numri gjyqtarëve efektiv 2022	Numri i gjyqtarëve efektiv 2023	WR 2022	WR 2023	# në %
7.5	9	298.7	325.2	8.9%

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit: Edhe pse e plotësuar vetëm në 56% të organikës së gjyqtarëve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka arritur të ruaj një nivel *backlog*-u të përballueshëm për vitin 2023. Në fund të periudhës raportuese gjykata ka evaduar një total prej 2801 çështjesh ose 96% të ngarkesës totale të gjykatës duke mbartur për shqyrtim në 2024, një stok prej 126 çështjesh. Rezulton se 75% e stokut përbëhet nga çështjet e reja të regjistruara gjatë 2023, nga të cilat 20 % janë çështje të regjistruara në 6 mujorin e dytë të vitit 2023. 18 çështje ose 14 % e çështjeve të prapambetura, janë në pritje të gjykimit prej më shumë se një viti dhe vetëm 14 çështje prej më shumë se 2 vitesh. Vlen të theksohet fakti se në gjykatë janë përfunduar të gjitha çështjet me vjetërsi më shumë se 3 vjet në raport me vitet e kaluara.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit								
Lloji i çështjes		Numri i çështjeve në pritje të gjykimit						
		Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	> 5 vjet
A.	Krime	46	20	11	9	6		
B.	Kundërvajtje penale	0						
C.	Çështje penale administrative	69	44	13	4	8		
D.	Çështje të ligjit antimafia	11	5	1	5			
E.	ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ (A+B+C+D)	126	69	25	18	14	0	0



Në vështrim të vjetërsisë së çështjeve në pritje të gjykimit, mund të deduktojmë se shqyrtimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar realizohet brenda afateve kohore të arsyeshme.

Treguesit e efijencës

Rendimenti mesatar për gjyqtar (Treguesi ER): Për vitin 2023, treguesi ER për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është 311.2 çështje për gjyqtar. Rezulton rritje e rendimentit mesatar të punës për gjyqtar me 11.7%.

Gjyqtarë 2022	Gjyqtarë 2023	ER 2022	ER 2023	# në % i ER
7.5	9	278.4	311.2	11.7 %

Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në vitin 2023 ka pasur një normë të lartë likuidimi të çështjeve duke mbajtur vlerën 100.9% sikurse në vitin 2022. I shprehur sipas kategorive me sensibilitet të lartë treguesi CR paraqitet grafikisht në vijim:




Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT): Treguesi DT ka ndjekur trendin përmirësues sikurse një vit më parë. Në vitin 2022, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar zgjidhja e një çështjeje zgjaste mesatarisht 26.6 ditë, ndërsa gjatë vitit 2023 rezulton se mesatarisht për zgjidhjen e një çështjeje palët duhet të

presin 16.4 ditë. Për çështjet ndaj të cilave opinioni publik ka treguar interes të veçantë, treguesi DT, paraqitet me afate kohore më të gjata, dhe ka shënuar një rritje të treguesit për të gjitha kategoritë sensitive, sikurse paraqitet në formë grafike në vijim:

Për kategorinë krim/ korrupsion kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2023 është 136 ditë në raport me 316 ditë të vitit paraardhës, duke u ulur ndjeshëm me 180 ditë.

Për llojin e çështjeve për kategorinë Krim i Organizuar kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2023 është 431 ditë në raport me 511 ditë të vitit paraardhës, duke u ulur me 80 ditë. Për llojin e çështjeve për kategorinë



Ligjit antimafia kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2023 është 106 dite në raport me 243 ditë të vitit paraardhës, duke u ulur me 137 ditë.

Gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 2801 çështjesh nga të cilat, 2685 çështje që përbëjnë 96% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur më pak se 6 muaj. Ndërkohë janë

shqyrtuar gjithashtu 11 çështje 6-12 muaj, 1 çështje nga 1-2 vjet dhe 0 çështje më shumë se 2 vjet.

Gjetjet kryesore!

- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka nisur punën në janar 2023 me 152 çështje në pritje të gjykimit (*backlog*), 29 çështje më pak krahasuar me *backlog*-un në fillim të vitit 2022.
- Në gjykatë janë regjistruar 2775 çështje të reja, 716 ose 25% çështje më shumë krahasuar me vitin paraardhës.
- Rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në vitin 2023, në krahasim me vitin paraardhës ka sjellë rritjen e tërësisë së treguesve të efijencës në gjykatë:
 - ngarkesa mesatare për gjyqtar (WR) është 325 çështje;
 - rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është 311 çështje;
 - norma e likuidimit të çështjeve (CR) është 100.9 %;
 - koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) e përgjithshme është 16 ditë.
- Në fund të vitit raportues, në këtë gjykatë mbeten në pritje për t'u shqyrtuar 126 çështje.

7.3 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshme

Gjykatat e apeleve të juridiksioneve të përgjithshme janë prekur nga procesi i riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave, dhe si rrjedhojë aktualisht kemi vetëm një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm. Kështu, në kuadër të riorganizimit të gjykatave të apelit, në datë 30.01.2023 ndërprejnë veprimtarinë Gjykatat e Apelit, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe më datë 01.02.2023, filloi funksionimin Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me seli në Tiranë.

Këshilli, gjatë vitit 2023, realizoi 3⁷⁵ ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duke e plotësuar atë, deri në fund dhjetori 2023, me 34 gjyqtar, nga të cilët 25 ushtrojnë efektivisht detyrën. Vlen të theksohet se KLGJ-ja po vijon ndërkohë procedurat për plotësimin e 13 (trembëdhjetë) pozicioneve vakante në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Burimet njerëzore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm


Për vitin 2023, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë vijuar të jenë në vlera problematike. Në total organika është e plotësuar me 31% gjyqtarë dhe 69% të

⁷⁵ Me vendimet nr. 583, datë 18.10.2023, nr. 585, datë 18.10.2023 dhe nr. 634, datë 19.10.2023 të KLGJ-së.

administratës së nevojshme. Në mënyrë të detajuar për secilën gjykatë, burimet njerëzore paraqiten në formë tabelare si vijon:


	Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
Gjykata Apelit JP	78	24.1	31%	167	115.1	69%	2.1	4.8

Backlog në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit




Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e ka filluar vitin 2023 me një stok të konsiderueshëm prej 31,370 çështjesh në pritje të gjykimit.

Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit 2023, në gjykatat e apelit janë regjistruar gjithsej 14,507 çështje të reja, nga të cilat 8030 ose 55.4% janë çështje civile dhe 6477 ose 44.6% çështje penale. Në krahasim me një vit më parë, shënohet një rritje 331 ose 2.3% të çështjeve të reja të regjistruara.



Ngarkesa e punës: Është totali i çështjeve, të cilat janë për shqyrtim në një gjykatë. Këtu përfshihen bashkërisht numri i çështjeve në pritje të gjykimit nga viti i mëparshëm (*backlog-u*), si dhe totali i çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë gjatë vitit referues. Krahasuar me një vit më parë, evidentohet një rritje e ngarkesës së punës me 3561 çështje. Rritja e ngarkesës shkaktohet tërësisht nga rritja e




backlog-ut me 8.4 % ose 3561 çështje më shumë sesa në vitin 2022.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): Volumi total i punës për secilin gjyqtar të apelit, sipas gjykatës përkatëse, për dy vitet e fundit, paraqitet në formë tabelare.

	Numri efektiv i gjyqtarëve 2022	Numri efektiv i gjyqtarëve 2023	# në %	WR 2022	WR 2023	# në %
Gjykata e Apelit JP	34.7	24.1	-31 %	1220	1903.6	56 %

Nga tabela dallohet lidhja direkte mes numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet gjatë vitit të dhënë dhe ngarkesës mesatare në gjykatë. Krahasuar me vitin paraardhës, vërehet se ulja e organikës efektive në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mesatarisht 24.1 gjyqtar, ose me një vlerë më të ulët prej 31 %, ka sjellë një rritje të ngarkesës mesatare për gjyqtarët e kësaj gjykate me 56%.




Treguesit e eficientës:

Rendimenti mesatar për gjyqtar (Treguesi ER): Krahasuar me një vit më parë, duke marrë si statistikë vlerat e të gjitha gjykatave të apelit, vërehet se në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm është rritur rendimenti i gjyqtarëve me një vlerë prej 25.9 çështjesh, 8.2 % më shumë. Për pamundësi studimore dhe krahasimore, si rrjedhojë e raportimit për herë të parë pas bashkimit të gjykatave të apelit, po vendosim më poshtë tabelat raportuese.

	ER 2022	ER 2023	në % i ER
Gjykata e Apelit Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	315	340.9	8.2%


Norma e zgjidhjes së çështjeve -Treguesi CR: Norma e likuidimit të çështjeve për



Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme. Vërehet se në krahasim me vitin e mëparshëm ka ulje të vlerës së CR-së. Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se norma e likuidimit të çështjeve CR civile nga viti 2022 në vitin 2023 është ulur me 38 % si dhe CR penale nga viti 2022 në vitin 2023 është

ulur me 12.1%. Këto vlera të normës së likuidimit tregojnë se norma e likuidimit të çështjeve është nën 100%. Nga të dhënat tabelare vihet re se, gjykata nuk ka arritur të përballojë fluksin e çështjeve të reja të regjistruara, duke thelluar gjendjen e stokut të trashëguar. Megjithatë për shkak të kohës së shkurtër të funksionimit të kësaj gjykate, ky konstatim duhet mbahet në vëmendje, për t'u vlerësuar objektivisht gjatë viteve në vijim.

Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT): Është e pamundur të bëhet një krahasim midis vitit 2022 dhe 2023 për këtë tregues. Për vitin 2023 treguesi DT në gjykatë rezulton sipas grafikëve të mëposhtëm:




Sikurse vërehet në çështjet civile, koha mesatare e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve është 2790.7 ditë. Në tërësi vërehet se gjykimi i çështjeve penale, vijon të karakterizohet nga kohë më të shpejta gjykimi në krahasim me çështjet civile, koha mesatare e të cilës shkon në 885.2 ditë. Treguesi DT, mesatar për këtë gjykatë është 1673.4 ditë. Kjo vlerë është më e ulët se ajo e ish Gjykatës së Apelit Tiranë për vitin 2022, që ishte në vlerën e 2216.5 ditëve.

Po të bëjmë një krahasim midis vetëm këtyre vlerave, rezulton se bashkimi i gjykatave ka sjellë një ulje të konsiderueshme të ditëve të gjykimit të çështjeve në ish-Gjykatën e Apelit Tiranë, prej 543 ditësh. Kjo konsiderohet si një shenjë pozitive e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore. Kjo tregon për një përmirësim të qartë në efikasitetin e sistemit gjyqësor. Megjithatë, është e rëndësishme të vazhdojmë monitorimin dhe vlerësimin e situatës për të kuptuar efektet e plota të këtij ndryshimi. Në kohën e shkurtër që kemi në dispozicion, mund të jetë e vështirë të arrijmë në konkluzione të sakta, por kjo ulje e shprehur është një shenjë inkurajuese për zbatimin e hartës së re gjyqësore në praktikë.

Backlog-u: Në 31 dhjetor 2023, 37,662 çështje presin të shqyrtohen nga Gjykata e Apelit e Juridiksionin të Përgjithshëm. Gjatë vitit 2023, backlog-u është rritur me 20.1% ose 6,292 çështje më shumë se në fillim të vitit, kur raportoheshin 31,370 çështje stok. Këto çështje

janë kryesisht civile, përbëjnë 69% të stokut, ndërsa 31% janë çështje




penale. Ka rritje të numrit të çështjeve civile dhe penale në stok krahasuar me një vit më


parë. Kjo tregon për një situatë të vështirë në sistemin gjyqësor, me një ngarkesë të lartë të punës.

Të kategorizuara sipas natyrës dhe kohës së pritjes, çështjet rezultojnë sipas grafikut të mëposhtëm. Vërehet se çështjet e regjistruara rreth 2-3 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve në pritje të gjykimit prej 9769 (26%) çështje nga të cilat janë 7148 civile dhe 2621 penale.

Vendin e dytë, me 8560 (23%), e zënë çështjet e kategorisë 3-5 vjet. Ndërsa 6448 çështje presin prej 1-2 vitesh për t'u shqyrtuar nga gjykata e apelit. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 1360 çështje penale dhe 3349 çështje civile, të cilat përbëjnë 12.5% të *backlog*-ut të vitit 2023.



Megjithëse, situata e çështjeve në pritje të gjykimit paraqitet problematike, vlen të analizohet edhe kohëzgjatja e çështjeve, të cilat janë likuiduar nga kjo gjykatë. Kështu gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 3,398 çështjesh civile nga të cilat, 781 çështje që përbëjnë 23% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 1,576 çështje ose 46% të çështjeve nga 1-2 vjet, 1,041 çështje ose 31% të çështjeve nga 6-12 muaj si dhe 0 çështje në më pak se 6 muaj.



çështje në më pak se 6 muaj.

Ndërsa për çështjet penale paraqitet si më poshtë vijon: Kështu gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 4,817 çështjesh penale nga të cilat, 808 çështje që përbëjnë 17% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 1044

çështje ose 22% të çështjeve nga 1-2 vjet, 262 çështje ose 5% të çështjeve nga 6-12 muaj si dhe 2703 çështje ose 56% në më pak se 6 muaj.

Gjetjet kryesore!

- *Backlog*-u total në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka arritur vlerën 37,662 çështje, 20.1 % më tepër krahasuar me vitin 2022.
- Gjatë vitit raportues, janë regjistruar 14,507 çështje të reja (331 çështje më shumë se në vitin 2022).
- Ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR) krahasuar me një vit më parë është rritur me 56%.
- Treguesit e efikasitetit gjatë vitit 2023:
 - Rendimenti i gjyqtarëve të apelit është rritur me 8.2 %.
- Në vitin 2023 mbeten për t'u shqyrtuar 37,662 çështje në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

7.4 Gjykata Administrative e Apelit

Sistemi gjyqësor parashikon një gjykatë apeli të juridiksionit administrativ dhe si rrjedhojë kjo gjykatë nuk u prek nga zbatimi i hartës së re gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2023, realizoi 2 (dy)⁷⁶ ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjithashtu theksojmë se, Këshilli po vijon procedurat për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve vakante në këtë gjykatë.

Për të adresuar situatën e krijuar në kushtet e mungesës së burimeve njerëzore, Këshilli ka ndërmarrë masa duke përdorur mekanizimin e “caktimit të gjyqtarëve në skemë delegimi” dhe “caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ushtrojnë detyrën”.

Burimet njerëzore në Gjykatën Administrative të Apelit



Krahasuar një vit më parë, gjatë vitit 2023 Gjykata Administrative e Apelit ka pasur një rritje të numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë, me një rritje afërsisht me 3 gjyqtarë. Ajo ka funksionuar me 64% të numrit të gjyqtarëve të parashikuar dhe me 74% të organikës së administratës gjyqësore. Në mënyrë të detajuar për Gjykatën Administrative të Apelit burimet njerëzore paraqiten në formë tabelare si vijon:

Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektivi v vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektivi v vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
13	8.3	64%	67	49.5	74%	5.1	6

⁷⁶ Me vendimet nr. 90, datë 23.02.2023 dhe nr. 288, datë 29.05.2023 të KLGJ-së.


Backlog-u:

Gjykata Administrative e Apelit e ka filluar vitin raportues me një stok të konsiderueshëm prej 21,166 çështjesh, të akumuluar gjatë viteve. Në një vështrim historik stoku i Gjykatës ka dëshmuar një trend rritës duke filluar nga viti 2021 e në vazhdim.




Sipas llojit të çështjeve *Backlog-u* në fillim të periudhës raportuese paraqitet në grafikun në krah. Sikurse vërehet grafikisht, rezulton se stoku i gjykatës përbëhet në masën 77% ose 16315 çështje administrative të përgjithshme, 15% çështje administrative pa palë kundërshtare (3170 çështje gjithsej) dhe vetëm 8 % ose 1681 çështje që i përkasin marrëdhënieve të punës.

Në lidhje me origjinën, ose prejardhjen e çështjeve në pritje të gjykimit në fillim të periudhës, konstatohet se 10953 çështje ose 52% e stokut përbëhet nga çështje të ardhura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. 1773 çështje, që përkon me 8.7% nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër. Pjesa tjetër 8.1% ose 1713 çështje paraqiten direkt në gjykatë si juridiksion fillestar dhe vetëm 21.2% të ndara në gjykatat e tjera.




Çështje të reja të regjistruara: Nga të dhënat e raportuara rezulton se regjistrimet e çështjeve të reja në gjykatë janë ulur sërish duke vazhduar më ritme më të lehta edhe për vitin 2023. Trendi i çështjeve të reja të regjistruara tregohet në formë grafike për periudhën 2019-2023 si vijon.




Nga të dhënat grafike vërehet se në vitin 2019 në gjykatë janë regjistruar 4620 çështje të reja, ndërsa gjatë 2020 vlera është ulur me 1000 çështje e më pas është rritur sërish në vlera mbi 4000 çështje. Në vitin 2022, regjistrimet e çështjeve të reja në Gjykatën Administrative të Apelit kanë shënuar një ulje prej 12% ose 504 çështje më pak. Në vitin 2023 regjistrimet e reja në Gjykatën Administrative të Apelit kanë shënuar një ulje të lehtë prej 4.7 % ose 171 çështje më pak se viti 2022.

Referuar kategorisë së çështjeve të paraqitura në gjykatë gjatë vitit 2023 vërehet se ndiqet i njëjti trend sikurse në vitin 2022.



Gjatë vitit raportues janë regjistruar 2068 çështje administrative të përgjithshme, të cilat përbëjnë 60% të regjistrimeve totale. Kategoria e dytë e regjistruar janë çështjet administrative pa palë kundërshtare, një total prej 1107 çështjesh ose 32% të regjistrimeve të reja, dhe vetëm 8% ose 295 çështje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës.

Çështjet e reja të paraqitura në Gjykatën Administrative të Apelit janë kryesisht ankime ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me 68%, Vlorë me 9%, Shkodër dhe Durrës me 7% dhe në fund nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, Gjirokastrë dhe Korçë, të cilat arrin në pragun e 9%. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2023 janë regjistruar 7 % çështje të reja nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.



Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): Gjatë vitit 2023, në Gjykatën Administrative të Apelit, një gjyqtar ka pasur në ngarkim mesatarisht 2968.2 dosje gjyqësore për të shqyrtuar, pra 984.5 çështje më pak sesa në vitin 2022. Kjo ulje me 25% është shkaktuar nga rritja e numrit të gjyqtarëve efektiv me 49%.


	Numri efektiv i gjyqtarëve 2022	Numri efektiv i gjyqtarëve 2023	# ne %	WR 2022	WR 2023	# në %
Gjykata Administrative e Apelit	5.58	8.3	49%	3952.7	2968.2	- 25%

Treguesit e efikasitetit:


Rendimenti mesatar për gjyqtar (Treguesi ER): Rendimenti i gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit në vitin 2023 është rritur me 14 %. Gjatë vitit 2023, rreth 8.3 gjyqtarët efektiv të Gjykatës së Apelit Administrativ, kanë arritur të rrisin vlerat e çështjeve të gjykuara me 56 % krahasuar më një vit më parë. Gjatë vitit raportues një gjyqtar ka arritur të përfundojë mesatarisht 23.4 çështje më tepër se në vitin paraardhës.

	Çështje të gjykuara 2022	Çështje të gjykuara 2023	# në %	Gjyqtarë 2022	Gjyqtarë 2023	# në %	ER 2022	ER 2023	# në % i ER
Gj.A dm. Apelit	890	1390	56 %	5.58	8.3	49%	167	190.4	14 %

Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR) : Gjatë vitit 2023, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur ritme më të larta të normës së likuidimit. Treguesi CR për këtë gjykatë është 43%. Edhe pse është rritur norma e likuidimit, gjatë vitit 2023, gjykata ka shtuar në stokun e çështjeve, duke arritur në një shifër prej 23,056 çështjesh në pritje për gjykim.




Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT): Sikurse vërehet grafikisht, gjatë vitit 2023 është ulur koha e nevojshme për evadimin e çështjes në ditë. Në krahasim me një vit më parë, një çështje përfundon për një afat kohor mesatar prej 5326.20 ditësh, që do të thotë 38.6% më pak se në vitin paraardhës.




Backlog-u në fund të vitit 2023: Në fund të periudhës raportuese Gjykata Administrative e Apelit, sikurse u analizua më lartë, edhe pse norma e likuidimit është shtuar, ajo ka shtuar stokun e saj me 9% duke arritur vlerën e 23,056 çështje në pritje për t'u shqyrtuar. Mosha e çështjeve në pritje të gjykimit paraqitet grafikisht si vijon:

Në përfundim të periudhës raportuese, vërehet se 3,267 çështje presin të shqyrtohen prej një viti, 7144 çështje presin të shqyrtohen prej 3-5 vjetësh dhe përbëjnë 31% të stokut total të gjykatës. 23.4% e *backlog*-ut, ose 5409 çështje presin të gjykohen prej më shumë se 5 vjet për rrjedhojë kanë kaluar afatet e arsyeshme të gjykimit, parashikuar nga neni 399/2, të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa vërehet se 45.6% e çështjeve në pritje të gjykimit kanë vjetërsi nën 3 vjet.



kaluar afatet e arsyeshme të gjykimit, parashikuar nga neni 399/2, të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa vërehet se 45.6% e çështjeve në pritje të gjykimit kanë vjetërsi nën 3 vjet.



Megjithëse, situata e çështjeve në pritje të gjykimit paraqitet problematike, vlen të analizohet edhe kohëzgjatja e çështjeve, të cilat janë likuiduar nga kjo gjykatë. Kështu gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 1580 çështjesh nga të cilat, 1234 çështje që përbëjnë 78% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 104 çështje ose 7% të çështjeve

nga 1-2 vjet si dhe 171 çështje ose 11% të çështjeve në më pak se 6 muaj. Rezulton se gjykata ka shqyrtuar në total 78% të çështjeve përtej afatit 2-vjeçar. Kjo tregon se gjykata, sikurse edhe në dy vitet paraardhëse, i ka dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve të vjetra, duke synuar uljen e numrit të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit.

Gjetjet kryesore!

- Gjykata Administrative e Apelit, vitin 2023 e ka filluar me 21,166 çështje në pritje për t'u gjykuar (*backlog*-u), 13% më shumë se në vitin 2022.
- Janë regjistruar 3470 çështje të reja ose 171 çështje më pak se një vit më parë.
- Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit janë përballur me një ngarkesë mesatare prej 2968.2 çështjesh për gjyqtar.
- Treguesit e efijencës kanë shënuar një përmirësim të lehtë, megjithëse është evituar rritja e *backlog*-ut dhe zgjatja e afateve të gjykimit.
 - Norma mesatare e efijencës për gjyqtar (ER) është 190.4 çështje (14% më shumë, krahasuar me vitin 2022).
 - Norma e likuidimit të çështjeve (CR) është rritur në 43% nga 24% që ishte në vitin 2022.
 - Për zgjidhjen e një çështjeje tendenca është, që në kushtet aktuale, duhen mesatarisht 5326.20 ditë (14.6 vjet). Ky afat është ulur me 38.6% krahasuar me një vit më parë.
- Në fund të vitit 2023, mbeten ende në pritje të gjykimit 23,056 çështje (8.9% më shumë se në fillim të vitit).

7.5 Gjykatat Administrative të shkallës së parë

Në kuadër të riorganizimit të gjykatave administrative të shkallës së parë, më datë 30.06.2023 ndërprejnë veprimtarinë gjykatat administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë, Shkodër, Gjirokastër, Vlorë, dhe më datë 01.07.2023 filluan funksionimin gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Lushnje. Pra, tashmë sistemi gjyqësor ka dy gjykata administrative të shkallës së parë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me seli në Tiranë dhe Lushnje.

Po ashtu, gjatë vitit 2023, Këshilli ka emëruar dhe caktuar në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, 2⁷⁷ magjistratë që përfunduan Shkollën e Magjistraturës.

Burimet njerëzore në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

Në vitin 2023, gjykatat administrative të shkallës së parë, në zbatim të hartës gjyqësore u riorganizuan në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, organika e gjyqtarëve efektivisht në detyrë është plotësuar në masën 66%, ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, funksionon me 65% të organikës.

Në lidhje me administratën gjyqësore, vetëm Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë operon me një staf afërsisht të plotë, prej 95% në krahasim me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, organika administrative e të cilës është plotësuar në masën 71%.

Gjykatat administrative të shkallës së parë, operojnë me një organikë efektive të gjyqtarëve prej 65%, të administratës gjyqësore prej 88%, si dhe staf mbështetës për gjyqtar efektiv, me një koeficient 3.95 staf mbështetës për 1 gjyqtar.

Në vijim paraqitet në formë tabelare gjendja e burimeve njerëzore, gjyqtar dhe staf mbështetës për gjykatat administrative të shkallës së parë.



Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Nr. i gjyqtarëve sipas organikës	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektivi vs Organika	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organikë %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
Lushnje	9	5.9	66%	34	24.2	71%	3.7	4.1
Tiranë	27	17.6	65%	72	68.7	95%	2.6	3.9
Total	36	23.5	65%	106	92.9	88%	2.9	3.95

⁷⁷ Me vendimet nr. 607, datë 19.10.2023 dhe nr. 610, datë 19.10.2023 të KLGJ-së.

Backlog - në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë


Në një vështrim të përgjithshëm stoku i gjykatave administrative të shkallës së parë në vend është ulur nga 6273 çështje në total që filloi viti 2022 vajti në 7352 çështje në fillim të vitit 2023.

Të kategorizuara sipas llojit të çështjeve, stoku total i gjykatave paraqitet si më poshtë në vlera përqindjesh.




Vërehet se ngarkesën më të madhe të stokut me 87% ose 6,425 çështje e zënë çështjet administrative të përgjithshme. Vijnë 724 çështje administrative pa palë kundërshtare të cilat përbëjnë 10% të *backlog*-ut. Ndërsa çështje që i përkasin marrëdhënieve të punës mbeten për t'u shqyrtuar vetëm 203 çështje ose 3% e stokut total të gjykatave.

Çështje të regjistruara të reja: Në 2 gjykatat administrative të shkallës së parë, janë regjistruar në total 15,435 çështje të reja. Krahasim me vitin 2022 është ulur numri i çështjeve të regjistruara me vetëm 4%.



Çështjet e reja të paraqitura në gjykata nga viti në vit nuk kanë ndjekur të njëjtin trend. Nga viti 2021 në vitin 2022 janë rritur me 2 % ndërsa në vitin e raportimit janë ulur me 4 % nga viti 2022.

Sa i përket natyrës së çështjeve të paraqitura në gjykatë, rezulton se nga 15,435 çështje të reja, 58%, ose 8 887 janë çështje administrative pa palë kundërshtare. Çështje të përgjithshme administrative janë 58% ose 6358 dhe vetëm 190 çështje që trajtojnë mosmarrëveshjet në marrëdhëniet e punës, të cilat zënë 1% të regjistrimeve. Krahasuar me vitin 2022 raportet mes kategorive mbeten të ngjashme, duke zënë përqindje më të madhe çështjet administrative pa palë kundërshtare.



Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): Krahasuar me vitin 2022, rezulton se ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar në gjykatat administrative të shkallës së parë ka pësuar një ulje prej 83.3 çështjesh mesatarisht për gjyqtar ose afërsisht me 9%. Nga tabela e mëposhtme mbi treguesin WR, vërehet se brenda juridiksionit administrativ për vitin 2023, ngarkesa për gjyqtar nuk ndjek të njëjtit trend. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje ngarkesa e punës për gjyqtar është 676.3 çështje, ndërsa në atë të Tiranës ngarkesa e punës për gjyqtar është 1,068 çështje.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	WR 2020	WR 2021	WR 2022	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	WR 2023
Vlorë	788	982	1018.9		
Gjirokastrë	309	389	1176	Lushnje	676.3
Korçë	420	844	1199.6		
Shkodër	562	567	468.5		
Tiranë	448	553	763	Tiranë	1068
Durrës	1034	1375	1105.8		
Mesatare	593.5	785.07	955.3	Mesatare	872

Sikurse evidentohet ngarkesa mesatare për gjyqtar në gjykatat e juridiksionit administrativ tregon një disbalancë të theksuar të ngarkesës për gjyqtar të të njëjtit juridiksion dhe shkallë gjykimi. Gjyqtarët më pak të ngarkuar me vetëm 676.3 çështje janë gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.


Treguesit e efikasitetit:

Rendimenti mesatar për gjyqtar (Treguesi ER): Mesatarisht një gjyqtar i gjykatës administrative ka gjykuar 522.6 çështje gjatë vitit 2023. Krahasuar me vitin paraardhës rezulton një ulje e normës mesatare e efikasitetit me 21 % ose 136.4 çështje më pak për gjyqtar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka treguar rendimentin më të lartë me 669.5 çështje të gjykuara nga çdo gjyqtar. Ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje një rendiment më të ulët prej 375.6 çështje të gjykuara nga çdo gjyqtar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	ER 2020	ER 2021	ER 2022	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	ER 2023
Vlorë	578	508	583		
Gjirokastrë	272	326	1043	Lushnje	375.6
Korçë	398	819	1150		
Shkodër	277	347	302		
Tiranë	349	446	550	Tiranë	669.5
Durrës	382	552	324		
Mesatare ER	376	500	659	Mesatare	522.6

Në mënyrë grafike situata e rendimentit paraqitet në grafikun e mësipërme, në të cilin tregohet qartazi variacioni i treguesit ER midis gjykatave të së njëjtit juridiksion në 4 vite të ndryshme.



Për vitin 2023, vihet re një ndryshim i rendimentit për dy gjykata administrative të shkallës së parë. Një prej tyre konsiderohet të jetë ngarkesa mesatare e punës së gjyqtarëve. Nga analiza statistikore ndër vite të treguesit WR (ngarkesa mesatare për gjyqtar) dhe treguesit ER (norma e efijencës për gjyqtar) vërehet se në gjykatat administrative të shkallës së parë, gjyqtarët rrisin apo ulin rendimentin e tyre në raport të drejtë me ngarkesën.

Në sajë të riorganizimit të gjykatave të juridiksionit administrativ në dy gjykata të vetme Këshilli vendosi të krijoj një shpërndarje bazuar në të dhëna statistikore dhe ngarkesë të balancuar të gjyqtarëve në çdo gjykatë. Ky riorganizim ka për qëllim rritjen e normës së efijencës edhe për gjyqtarët me normë të ulët, normë kjo e shkaktuar nga ngarkesa e ulët në këto gjykata.

Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): Situata për vitin 2023, si dhe krahasimi me normën e viteve pasardhës paraqitet në tabelë si më poshtë.


Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	CR 2021	CR 2022	CR 2023
Durrës	86%	75%	
Gjirokastrë	96%	99%	
Korçë	100%	99%	
Shkodër	123%	124%	

Tiranë	99%	87%	91.25%
Vlorë	70%	100%	
Lushnje			87.87%

Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ vërehet se norma e likuidimit të çështjeve është nën 100%. Nga të dhënat tabelare vihet re se, të dyja gjykatat nuk kanë arritur të përballojnë fluksin e çështjeve të reja të regjistruara, duke thelluar gjendjen e stokut të trashëguar. Megjithatë për shkak të kohës së shkurtër të funksionimit të këtyre dy gjykatave, ky konstatim duhet mbahet në vëmendje, për t'u vlerësuar objektivisht gjatë viteve në vijim.

Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT): Bazuar në të dhënat statistikore të raportuara nga gjykatat, rezulton se në 2 gjykatat e juridiksionit administrativ, koha e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore rezulton relativisht e lartë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	DT 2021	DT 2022	DT 2023
Durrës	543.9	882	
Gjirokastrë	70.8	46.4	
Korçë	10.8	15.7	
Shkodër	231.8	201.7	
Tiranë	87.4	146.5	217.3
Vlorë	341.5	273.1	
Lushnje			292.2
Afati i arsyeshëm ligjor	365	365	365




Në të majtë paraqitet në formë grafike treguesi DT i vitit 2023 në gjykatat administrative të shkallës së parë sipas vlerës. Vërehet se kohëzgjatja e përfundimit të një çështje administrative në shkallë të parë varion ndjeshëm midis gjykatave. Duhet theksuar se gjykimi administrativ gjithsesi realizohet brenda një afati të arsyeshëm ligjor pra më pak se


365 ditë ose brenda vitit, ndonëse kohës mesatare për zgjidhjen e një çështjeje është rritur.

Backlog-u në fund të periudhës: Numri i çështjeve të pashqyrtuara në gjykatat administrative të shkallës së parë në vitin 2023 është 8,788.


Në shkallët e para të juridiksionit administrativ mbeten në pritje të gjykimit, në formën e stokut për vitin 2024, një total prej 8,788 çështjesh, nga të cilat 20% ose 1,774 çështje janë çështje të regjistruara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe 80% ose 7,014 çështje në Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Krahasuar me një vit më parë stoku është rritur me 1,434 çështje, ose e thënë ndryshe rritur me 19%.



Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit: Në formë grafike paraqitet si vijon përbërja e *backlog*-ut në gjykatat administrative të shkallës së parë, kategorizuar sipas kohës së pritjes, thënë ndryshe sipas vjetërsisë së çështjes.



Konstatohet se 41% e *backlog*-ut për vitin 2023 përbëhet nga çështje të regjistruara gjatë vitit 2023, nga të cilat 3,616 çështje janë paraqitur në gjykatë 6-mujorin e dytë të vitit. Po ashtu rezultojnë 2007 çështje, që përbëjnë 23% të stokut, të cilat janë në pritje prej më pak se 1 vit.



Raportohen gjithashtu 886 çështje (10% e stokut) me një kohë pritje 2-3 vjeçare, 6% e stokut ose 523 çështje kanë një vjetërsi 3-5 vjeçare. Pjesë e stokut janë edhe 380 çështje administrative me palë kundërshtare, të cilat presin gjykimin prej më shumë se 5 vjet nga të cilat 51 çështje janë të regjistruara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe 329 çështje janë të regjistruara në Gjykatën Administrative të Shkallës së

Parë Tiranë.

Gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 13,999 çështjesh nga të cilat, 602 çështje që përbëjnë 4% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 848 çështje ose 6% të çështjeve nga 1-2 vjet, 1814 çështje ose 13% të çështjeve në 6-12 muaj si dhe 10,735 çështje ose 77% në më pak se 6 muaj.

Gjetjet kryesore !

- Viti 2023 ka filluar me 7352 çështje (*backlog*), në pritje për t'u gjykuar nga gjykatat administrative të shkallës së parë, vlerë afërsisht 17 % më e lartë krahasuar me vitin paraardhës. *Backlog*-u gjendet kryesisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 80% e totalit (5,884 çështje) dhe 20% (1,468 çështje) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.
- Gjatë vitit raportues janë regjistruar 15,435 çështje të reja nga të cilat 12,913 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 2,522 Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.
- Gjykimi është kryer nga 65% e gjyqtarëve të parashikuar.
- Gjykatat administrative të shkallës së parë kanë shënuar:
 - Ulje e ngarkesës mesatare të gjyqtarëve në 872 çështje për gjyqtar, krahasuar me 955 çështje/gjyqtar në vitin 2022.
 - Ulje e rendimentit të gjyqtarëve mesatarisht në 522.6 çështje nga 659 çështje të gjykuara për gjyqtar në 2022.
 - Normë likuidimi të çështjeve nën 100% në 2 gjykata (Tiranë dhe Lushnje).
- Gjykimi kryhet brenda afateve të arsyeshme ligjore me një tregues DT mesatar prej 292.2 ditësh në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe 217.3 ditësh në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7.6 Gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm

Gjykatat e rretheve gjyqësore, gjithashtu, u prekën nga procesi i implementimit të hartës së re gjyqësore. Si rrjedhojë, në kuadër të riorganizimit të gjykatave të rretheve gjyqësore më datë 30.04.2023, ndërprejnë veprimtarinë e tyre gjykatat e rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnje, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë. Në vijim, më datë 01.05.2023 filluan funksionimin gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë.

Pra, aktualisht kemi 13 gjykata të shkallëve të para me juridiksion të përgjithshëm. Gjatë vitit 2023, Këshilli ka emëruar dhe caktuar në mënyrë të përhershme, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore 41 magjistratë, të cilët përfunduan me sukses programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.


Burimet njerëzore në gjykatat e shkallëve të para të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Organika e gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm për vitin raportues, rezulton e plotësuar në masën 56% sa i takon trupës gjyqësore, dhe 89% sa i takon administratës gjyqësore. Në lidhje me këtë të fundit, vërehet një rritje e numrit tërësor të administratës si edhe raportit staf mbështetës për gjyqtar. Situata paraqitet pozitive për administratën e gjykatës, e cila lehtëson aspektin administrativ të menaxhimit të çështjeve duke ndikuar në rendimentin e gjyqtarit në shqyrtimin e dosjes. Gjatë vitit 2023, kanë ushtruar efektivisht detyrën 588.6 nëpunës gjyqësor, mesatarisht 4,47 punonjës për çdo gjyqtar, ndërsa gjatë vitit 2022 një gjyqtar asistojë nga 4.4 nëpunës.

Shifrat e detajuara të burimeve njerëzore për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm për vitin **2023**, paraqiten në tabelë më poshtë:

Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm	Nr. i gjyqtarëve sipas dekretrit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt
Berat	8	5.8	73%	26	21.3	82%	3.3	3.7
Dibër	7	6.3	90%	26	20.3	78%	3.7	3.2
Durrës	23	12.5	54%	54	47.5	88%	2.3	3.8
Elbasan	18	6.4	36%	36	33.3	93%	2	5.2
Fier	21	10.8	51%	50	42.6	85%	2.4	3.9
Gjirokastrë	7	3.9	56%	32	29.5	92%	4.6	7.6
Korçë	15	8	53%	48	45.3	94%	3.2	5.7
Kukës	7	4.9	70%	25	18.2	73%	3.6	3.7
Lezhë	11	5.6	51%	38	33.8	89%	3.5	6
Sarandë	7	4.6	66%	18	17	94%	2.6	3.7
Shkodër	15	9.1	61%	60	48.9	82%	4	5.4
Tiranë	80	43.5	54%	192	178.9	93%	2.4	4.1
Vlorë	16	10.5	66%	56	52	93%	3.5	5
Totali	235	131.9	56%	661	588.6	89%	2.8	4.47



Në formë grafike plotësimi i organikës në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, paraqitet si vijon:



Menaxhimi i çështjeve në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm

Backlog-u: Për grupin e gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2022 është 40,070 çështje; nga të cilat 29,448 janë çështje civile dhe 10,622 çështje penale. Krahasuar me *backlog*-un e vitit 2021, vërehet se gjatë 2022 është krijuar një diferencë stoku 3,480 çështje, ose 10% më shumë, ngarkesë kjo e cila do të ndikojë në vitin e raportuar.


Në vijim paraqitet *backlog*-u i shpërndarë sipas gjykatave përkatëse. Numrin më të madh të çështjeve të mbartura janë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me një stok prej 19275 çështjesh, e cila përbën 48% të stokut total për këtë grup gjykatash. Raporti i shpërndarjes së stokut ndjek trendin e përcaktuar që prej vitit 2019, ku 4 gjykata, gjithmonë të njëjta, Tiranë (48%), Durrës (10%), Elbasan (8.4%) dhe Vlorë (5.9%), mbajnë 72.3% të stokut total.



Tre gjykatat kanë në ngarkim nga 14% të *backlog*-ut total, këto gjykata janë në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm Fier, Korçë, dhe Shkodër. Tre gjykatat, kanë në ngarkim nga 8.7% të *backlog*-ut total, këto gjykata janë në Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Sarandë dhe Lezhë. Ndërsa tre gjykata të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Gjirokastrë dhe Dibër me stokun mesatar kanë në ngarkim nga 5 % të *backlog*-ut total.


Çështje të reja të regjistruara: Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 84382 çështje të reja, nga të cilat 49% ose 41748 çështje civile dhe 42634 çështje penale ose 51% e totalit. Krahasuar me vitin 2022, janë regjistruar 12214 çështje më pak (- 13%).

Të shpërndara sipas gjykatës në të cilën janë regjistruar, çështjet e reja për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:



Grafikisht vërehet se çështjet gjatë vitit raportues, janë shënuar kryesisht në Tiranë ku rezultojnë 31883 çështje të reja (38% e totalit), në vend të dytë vjen Durrësi me 8608 çështje (10% e totalit) ndjekur nga Fieri me 7328 çështje të reja të regjistruara (8.7% e totalit).

Ngarkesa e gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm: Për vitin 2023 ngarkesa totale në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është ulur me 6.5%, e shkaktuar kjo nga ulja e çështjeve të reja të regjistruara, edhe pse *backlog*-u ka shënuar rritje.



Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR): Ngarkesa totale e gjykatës ndikon drejtpërdrejt në ngarkesën mesatare për gjyqtar, pasi shpërndahet në mënyrë të barabartë mes gjyqtarëve efektivisht në detyrë, në secilën gjykatë.

Në vitin 2023 ngarkesa mesatare e gjyqtarëve ka pasur një tendencë kryesisht në rritje. Mesatarja e treguesit WR për vitin 2023 është 841.7 çështje për gjyqtar, 65.7 çështje më

shumë krahasuar me mesataren e vitit 2022. Nga të dhënat, të paraqitura në formë tabelare më poshtë, vërehet se shpërndarja e ngarkesës nuk plotëson kriteret për një ndarje të ekuilibruar të ngarkesës mes gjykatave dhe gjyqtarëve.

Gjykata	Treguesi WR 2022	Treguesi WR 2023
Berat	864	711.9
Dibër	451	427.8
Durrës	1412	1011.7
Elbasan	1592	1349.1
Fier	905	851.5
Gjirokastrë	736	887.4
Kavajë	762	
Korçë	885	857.1
Krujë	640	
Kukës	487	469.2
Kurbin	473	
Lezhë	1066	910
Lushnjë	753	
Mat	390	
Përmet	330	
Pogradec	911	
Pukë	185	
Sarandë	745	782.2
Shkodër	932	829
Tiranë	1361	1176
Tropojë	223	
Vlorë	968	679.9
Mesatar	776	841.7


Vërehet një disbalancë e theksuar mes ngarkesës së gjyqtarëve, kjo vjen në pah me vendosjen përball të ngarkesës së gjykatave më të ngarkuara të grupit si Tirana, Durrësi, Elbasani me gjykatat me ngarkesë më të vogël si Kukësi apo Dibra. Dhe konkretisht në gjykata si Elbasani paraqitet një ngarkesë prej 1349.1 çështje për gjyqtar, të krahasuar me gjykata si Dibra me ngarkesë 427.8 çështje për gjyqtar. Kjo disbalancë vjen nga numri i paplotësuar i gjyqtarëve efektivisht në detyrë. Shembulli për 2 gjykatat, rezulton se, një gjyqtar i gjykatës Elbasan ka pasur në ngarkim mesatarisht 921.3 çështje më shumë sesa një gjyqtar i gjykatës Dibrës, por Dibra ka funksionuar me 95 % të gjyqtarëve efektiv në detyrë ndërsa Elbasani me 30 % të gjyqtarëve efektiv në detyrë.

Treguesit e eficencës


Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER): Rendimenti mesatar për gjyqtar në vitin 2023, për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, është 547,16 çështje, 16 çështje më pak përballë mesatares së vitit 2022 që ishte 563 çështje për gjyqtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor	ER 2022	Gjykata e Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm	ER 2023
Pukë	149.7		
Tropojë	189.6		
Përmet	231.1		
Dibër	310.3	Dibër	346.3
Kukës	326.1	Kukës	350.8
Mat	332.7		
Kurbin	395.8		
Krujë	481.4		
Sarandë	494.4	Sarandë	502.4
Gjirokastrë	523.1	Gjirokastrë	577.4
Kavajë	554.5		
Berat	597.0	Berat	493.8
Lushnjë	625.0		
Pogradec	636.0		
Vlorë	670.4	Vlorë	456.8
Korçë	673.9	Korçë	586.4
Shkodër	708.0	Shkodër	644.2
Fier	732.1	Fier	612.4
Lezhë	854.3	Lezhë	502.4
Tiranë	872.9	Tiranë	718.3
Durrës	967.1	Durrës	643.4
Elbasan	1051.2	Elbasan	672.0
Mesatare	563.0	Mesatare	547.0

Pavarësisht uljes së mesatares së treguesit ER, rendimenti i gjyqtarëve të të njëjtit nivel varion ndjeshëm midis gjykatave. Gjykata si Tirana dhe Elbasani kanë arritur rendiment të lartë krahasuar me gjyqtarët e gjykata të tjera, ku një gjyqtar ka gjykuar 672.0 çështje në Elbasan, 718.3 në Tiranë. Treguesi ER më vlerë më të ulët e tregon gjykata e Dibrës me 346.3 çështje për gjyqtar. Të dhënat në mënyrë grafike janë të pasqyruara si më poshtë:



Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR): Për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, për shkak të natyrës dhe ritmeve të ndryshme të gjykimit, kjo normë përlloritet në mënyrë të veçantë për çdo gjykatë, sipas ndarjes së çështjeve civile dhe penale.





Likuidimi i çështjeve civile për vitin 2023, si më sipër pasqyruar në grafik, paraqitet në vlera të ndryshme në gjykata. Në vështrim të përgjithshëm treguesi CR civil mesatar është ulur në 90%, krahasuar me 95% në vitin 2022. Nga analiza e të dhënave statistikore, vërehet se në dy gjykata ajo e Tiranës dhe Sarandës, treguesi CR është në pragun e 100%; gjykata e Beratit rezulton të ketë kaluar pragun 100%, me vlerën 112%. Situata paraqitet e ndryshme për gjykatat e tjera, të cilat shënojnë vlera të treguesit CR nën pragun 100%. Këto gjykata nuk kanë arritur të ruajnë ritmin e gjykimit dhe për rrjedhojë kanë shtuar stokun e çështjeve civile r vitin e ardhshëm.

Sa i përket likuidimit të çështjeve penale ose ndryshe treguesit CR penal për vitin 2023, ndryshe nga trendi i deritanishëm, rezulton më i lartë krahasuar me treguesit CR për çështjet

civile. Konkretisht, për vitin 2023 treguesi CR penal mesatar është 97%, me një rritje 2% më shumë se sa në vitin 2022 ku mesatarja e treguesit CR penal ishte 95%. Brenda grupit, norma e likuidimit varion në mënyrë të dukshme mes vlerës minimum prej 88% dhe vlerës maksimum prej 106%.

Si konkluzion, 8⁷⁸ nga 13 gjykata nuk kanë arritur të ruajnë ritmet e gjykimit dhe për rrjedhojë kanë krijuar stok të çështjeve penale. Vetëm 5 gjykata raportojnë një normë likuidimi mbi 100%, por nuk kanë arritur të ndikojnë mbi stokun e tyre me një normë likuidimi 100% ose vetëm 1% më të lartë se pragu. Gjykatat me normë likuidimi më të lartë për çështjet penale janë gjykata e Shkodrës me 105% dhe e Kukësit me 106%, kjo sa edhe më sipër pasqyruar në grafik.

Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT): Për vitin 2023, i paraqitur grafikisht treguesi DT për çështjet civile dhe penale, paraqitet si vijon:



Nga analiza e të dy grafikëve konstatohet se në të gjitha gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, çështjet civile dhe penale përfundojnë brenda afatit të arsyeshëm ligjor. Në krahasim mes dy grafikëve dallohet se, koha e nevojshme për



⁷⁸ Berat, Gjirokastrë, Lezhë, Sarandë, Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës.

përfundimin e çështjeve civile është më e gjatë se për çështjet penale. Një çështje civile gjykohet në shkallë të parë mesatarisht për 272 ditë, ndërsa një çështje penale për 114 ditë.

Përball të dhënave statistikore të vitit paraardhës, vërehet se koha e nevojshme për evadimin e çështjes është zgjatur për të dyja kategoritë. Në vitin 2022, mesatarja e treguesit DT civil ishte 168 ditë, me 104 ditë më pak sesa mesatarja e vitit të raportuar. Përkeqësim vërehet gjithashtu në mesataren e treguesit DT për çështjet penale, i cili në vitin 2022 ishte në vlerën 98 ditë, 16 ditë më pak sesa mesatare prej 114 ditësh e raportuar për vitin 2023.


Backlog-u në fund të periudhës: Sikurse mund të parashikohej, prej përkeqësimit të parametrave të efikasitetit, uljes së rendimentit mesatar për gjyqtar dhe nivelit nën pragun 100% të normës së likuidimit të çështjeve; kemi rritje të nivelit të stokut gjatë vitit 2023 me 8% më shumë, krahasuar kjo me *backlog* në fillim të periudhës. Kjo rritje do të ndikojë negativisht në rendimentin e vitit 2024, pasi krijon një ngarkesë fillestare të shtuar, e cila duhet të përballohet dhe evadohet gjatë këtij viti së bashku me regjistrimet e reja, të cilat nuk mund të parashikohen paraprakisht. *Backlog*-u i vitit 2023 përbëhet kryesisht nga çështje civile, duke vijuar me tendencën rritëse ndër vite të kësaj kategorie çështjesh.

Ndryshimi i *backlog* në 4 (katër) vite si më poshtë pasqyruar në grafik:



Gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 38,913 çështjesh civile nga të cilat, 448 çështje që përbëjnë 1% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 1,460 çështje ose 4% të çështjeve nga 1-2 vjet, 4,376 çështje ose 11% të çështjeve nga 6-12 muaj si dhe 24,603 ose 63% çështje në më pak se 6 muaj.

Ndërsa për çështjet penale paraqitet si si vijon: Kështu gjatë vitit 2023 janë gjykuar një total prej 4,817 çështjesh penale nga të cilat, 124 çështje të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 478 çështje ose 1% të çështjeve nga 1-2 vjet, 2292 çështje ose 6% të çështjeve nga 6-12 muaj si dhe 38103 çështje ose 92% në më pak se 6 muaj.



Gjetjet kryesore!

- Për grupin e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2022 (*backlog-u*) është 40,070 çështje (10 % më shumë krahasuar me vitin paraardhës), nga të cilat 48% (19,275 çështje) në gjykatën e Tiranës.
- Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, kanë funksionuar me 56% të gjyqtarëve të parashikuar.
- Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 84,382 çështje të reja (13% më pak sesa në vitin 2022). Vendin e parë me 31,883 çështje (38% e totalit) e zë Tirana, ndërsa vendin e dytë me vetëm 10% të totalit e zë Durrësi dhe më pas Fieri me 7,328 (8.7% e totalit).
- Treguesit e efijencës kanë rënë lehtësisht duke shënuar:
 - Rritje të rendimentit mesatar të gjyqtarëve në këtë grup. Mesatarja e këtij treguesi është 841.7 çështje të gjykuara për gjyqtar.
 - Norma e likuidimit të çështjeve paraqitet e ndryshme për të dyja kategoritë e çështjeve. Ajo është mesatarisht 90% për çështjet civile dhe 97% për çështjet penale, por ngelet nën pragun 100%.
 - Rritje të treguesit DT (koha e nevojshme për përfundimin e një çështjeje në ditë) dhe zgjatje të afateve të nevojshme për shqyrtimin e çështjes. Një çështje civile gjykohet në shkallë të parë mesatarisht për 272 ditë, ndërsa një çështje penale për 114 ditë.
 - Gjykimi i çështjeve penale dhe civile në shkallë të parë realizohet brenda afateve të arsyeshme ligjore, në të gjitha gjykatat e vendit.
 - Ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR) dhe norma e efijencës për gjyqtar (treguesi ER) tregojnë disbalancë të theksuar mes gjyqtarëve të së njëjtit nivel, shkaktuar nga numri i gjyqtarëve efektiv në detyrë i cili nuk është në % të njëjtë nga njëra gjykatë tek tjetra.
- Si pasojë e treguesve të efijencës, stoku është rritur me 8% në fund të vitit 2023, ose ndryshe me 3,315 çështje më shumë. Në 31 dhjetor 2023 mbeten në pritje të gjykimit 44,181 çështje, nga të cilat 45 % (19,911 çështje) i përkasin Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

VIII. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Gjatë rrugëtimit të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar me efektivitet të plotë bashkëpunimet me shumë aktorë të cilët jo vetëm kanë besuar në misionin e tij por kanë shumëfishuar dhe amplifikuar përpjekjet e përbashkëta në përmbushjen e tij. Qasja e Këshillit ka qenë sa institucionale aq dhe proaktive, duke konsoliduar tashmë urat e bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë, ndër të cilat përmendim:

8.1 Bashkëpunimi me institucionet shtetërore

Bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë – i orientuar në kuadër të procesit të raportimit sikurse është edhe ky raport vjetor, përmirësimit të legjislacionit në fushën e drejtësisë nëpërmjet propozimeve të ndryshme ligjore të iniciuara nga ana e Këshillit si dhe zbatimit të detyrimeve që derivojnë nga procesi i Integritimit Evropian.

Bashkëpunimi me Presidentin e Republikës – i cili konsiston kryesisht për funksionalizimin e plotë, me 19 anëtarë të Gjykatës së Lartë përmes dekretimit të gjyqtarëve të propozuar nga Këshilli.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë (MD) – intensifikuar me takimet e përbashkëta të zhvilluara jo vetëm për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, por edhe për çështje të tjera të sistemit të drejtësisë në funksion të diskutimit të sfidave të përbashkëta dhe gjetjes së mekanizmave të duhur për zgjidhjen e tyre. Me vlerë për t'u theksuar në këtë drejtim është intensifikimi i bashkëpunimit të ndërsjellë në kuadër të monitorimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë, dhe sidomos në kuadër të procesit të hapjes së negociatave me Bashkimin Evropian, e cila do të shtjellohet në vijim. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në kërkesat e Ministrisë së Drejtësisë si dhe në përputhje me funksionin ligjor të dhënies së opinionëve mbi legjislacionin që mund të ndikojnë në punën e gjyqësorit dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e tij, ka dhënë **23 opinione** mbi projektvendime apo projektligje, ndër të cilat përmendim:

- Projektvendimin “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”.
- Projektligjin “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, (Pjesa e Përgjithshme).
- Projekt-udhëzimin “Për përcaktimin e rregullave për regjistrimin e vendimeve gjyqësore penale dhe rehabilitimin ligjor nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore.
- Projektvendimin “Për propozimin e projektligjit “Për dhënie amnistie”.

- Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 564, datë 31.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe për shkak të tij.
- Projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 8.7.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori”.

Bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) – si një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Këshillit në funksion të garantimit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve ndaj publikut dhe rritjes së besimit të tij në sistemin gjyqësor.

Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) – Këshilli ka vijuar bashkëpunimin me KLP-në jo vetëm në përmbushje të nenit 170 të Ligjit për Qeverisjen por edhe në kuadër të takimeve me fokus çështjet e përbashkëta, një ndër të cilat është unifikimi i rregullave mbi procedimet disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore.

Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme – intensifikuar sidomos në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, e cila passolli edhe riorganizimin e zyrave të prokurorisë me qëllim jo vetëm miradministrimin e këtij procesi por mbi të gjitha për të garantuar aksesin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Bashkëpunimi me Institucionet e Vetting-ut – i shprehur dhe konsoliduar tashmë përmes funksionimit pranë Këshillit, prej 5 vitesh, të Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional (në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve) i cili është burimi kryesor për vlerësimin e një prej tre komponentëve të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës (SHM) – në kuadër të përcaktimit të kuotave për kandidatët për formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të profilit magjistrat, këshilltarë dhe ndihmës ligjor. Në këtë kontekst vlerësohet se bashkëpunimi me Shkollën ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen profesionale të gjyqtarëve e cila kontribuon drejt një cilësie dhe efëçence më të lartë të sistemit gjyqësor.

Bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) – si një bashkëpunëtor i hershëm i Këshillit në përmbushjen e një prej kompetencave ligjore që ka të bëjë me verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për ngritjen në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, për kandidatët për magjistratë të diplomuar nga SHM, për kandidatët për në formimin fillestar për magjistratë në SHM, për kancelarët në detyrë, si dhe për kandidatët për në formimin fillestar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Në sajë të këtij bashkëpunimi Këshilli ka bërë të mundur përmbylljen me sukses të procedurave të verifikimit që i kanë hapur dritën jeshile

fillimit të studimeve për kandidatët magistratë, procesit të emërimeve dhe caktimeve në detyrë si dhe ngritjes në detyrë.

Përveç institucioneve të lartpërmendura, Këshilli në kuadër të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, gjatë vitit 2020 është intensifikuar edhe bashkëpunimi me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit në kuadër të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

8.2 Bashkëpunimi me grupet e interesit

Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile dhe Median – të cilët janë bashkudhëtarët e pandarë të Këshillit në këtë rrugëtim 5-vjeçar dhe për të cilët Këshilli ka ndjekur një qasje të hapur dhe proaktive duke zhvilluar një seri takimesh konsultative me fokus zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, çështjet e komunikimit dhe marrëdhënies me median, procesin e integritetit dhe detyrimet që burojnë prej tij, etj. Në këtë kuadër përmendim aktivitetet e zhvilluara në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shqipëri, me Qendrën për Çështjet e Informimit Publik (INFOÇIP) në kuadër të implementimit të projektit MATRA “Open Court Through Press Judges”, Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Qëndresën Qytetare në kuadër të Akademisë “Citizen in Charge” mbështetur nga Ambasada Holandeze në Tiranë, etj.

Bashkëpunimi me Gjykatat – Ky është një bashkëpunim organik dhe i ndërsjellë në funksion të identifikimit të problematikave dhe nevojave të sistemit por edhe të gjetjes së mekanizmave për adresimin e tyre. Kjo sidomos në kushtet e riorganizimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe impaktit që ajo ka në aspektin e menaxhimit të burimeve njerëzore, financiar dhe infrastrukturor, dhe mbi të gjitha në raport me marrëdhëniet me publikun. Komunikimi dhe ndërveprimi me gjykatat ka qenë konstant për të garantuar suksesin e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore si dhe miradministrimin e pasojave të saj me qëllim mosçenimin e aksesit në drejtësi.

8.3 Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar

Në arenën ndërkombëtare, KLGJ-ja, ka konsoliduar bashkëpunimin me organizata të ndryshme në kuadër të ndjekjes së vazhdueshme të aktiviteteve periodike të organizuara prej tyre si dhe njohjes me praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me pavarësinë, cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë. Në këtë kuadër vlen të përmenden bashkëpunimi me: Asamblenë e Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ),

Komisionin Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Shoqatën Ndërkombëtare për Administrimin Gjyqësor (IACA), etj.

Mozaiku i bashkëpunësuesve të Këshillit është i larmishëm me partnerë ndërkombëtar, të cilët përmes mbështetjes teknike, financiare e shpeshherë edhe modeleve e standardeve që përcjellin, na kanë motivuar drejt përmirësimeve në sistemit gjyqësor. Që në fillimet e tij, Këshilli është mbështetur dhe vijon të mbështetet nga asistencë e partnerëve ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës përmes disa projekteve specifike⁷⁹, Bashkimi Evropian përmes projektit “EU4Justice”, si dhe Ambasadës Amerikane përmes projekteve të financuara fillimisht nga USAID dhe aktualisht nga INL (Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit)⁸⁰. Kjo asistencë ka udhëhequr Këshillin në të gjitha proceset transformuese që ka ndërmarrë në funksion të rritjes së efikasitetit në sistemin gjyqësor dhe së fundmi po ndihmon në identifikimin e masave konkrete ligjore dhe administrative për parandalimin dhe reduktimin e stokut të çështjeve të prapambetura në gjykatat në nevojë. Bashkëpunim ky i kristalizuar përmes pjesëmarrjes dhe ofrimit të ekspertizës profesionale në grupin e punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”.

Në funksion të forcimit të këtij bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe asistencës së tyre në mbështetje të Reformës në Drejtësi, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami ka zhvilluar takime pune me trupin diplomatik apo edhe me misione ekspertësh ndërkombëtarë, mes të cilëve do të veçonim: takimin me ambasadorin e SHBA-së, SH.S.ZNJ. Yuri Kim; takimin me Presidentin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), njëkohësisht edhe Drejtues i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës z. Christophe Straudo; takimin me Ambasadorin e Holandës në Tiranë, SH.T. Reinout Vos, takimin me një trup prej 50 gjyqtarësh nga Austria, takimin me delegacionin e reporterëve nga Këshilli i Evropës, misionin e ekspertëve të Komisionit Evropian, etj.

Krahas pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Këshillit në takimet rajonale të zhvilluara në Sarajevë, Shkup, Vienë etj., gjatë vitit 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pritur disa delegacione nga struktura të ngjashme homologe, ndër të cilat: delegacionin nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, delegacionin nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, delegacionin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Republikës së Bullgarisë, si dhe delegacionin nga Mbretëria e Arabisë Saudite, i cili kryesohej nga Ministri i Drejtësisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, njëkohësisht edhe kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendeve Arabe.

⁷⁹ Si projektit “Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ III”, “Mbrojtja e të drejtës së pronës dhe lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në Shqipëri – D-REX III” si dhe Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

⁸⁰ Projekti “Për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit të Gjykatës së Lartë në Shqipëri” i zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMI).

8.4 Bashkëpunimi në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE

Një vit pas hapjes së negociatave me Shqipërinë vendi kaloi në një fazë të rëndësishme të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. Në fund të vitit 2023, Komisioni Evropian publikoi raportin “screening” nga Komisioni Evropian në të cilën vlerësoi se Shqipëria ka bërë progres të vlerësueshëm në përshtatjen e strukturave ligjore dhe institucionale me standardet e Bashkimit Evropian, duke përmirësuar pavarësinë dhe llogaridhënien gjyqësore. Në këtë proces të rëndësishëm Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dhënë kontributin e tij jo vetëm në marrjen e angazhimit për përmbushjen e rekomandimeve të kapitullit 23, por edhe në raportimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të masave të kërkuara nga Kuvendi i Shqipërisë, në kuadër të Integritimit në BE. Gjithashtu, Këshilli është angazhuar edhe në takimet e anëtarëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” si dhe në takimet e zhvilluara nga Grupi i Punës për hartimin e Udhërrëfyesit për “Shtetin e së Drejtës”, duke kontribuar në hartimin e këtij të fundit i cili u finalizua në dhjetor të vitit 2023.

Ndër të tjera, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, zhvillon takime periodike pune me misionet e ekspertëve nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, Nënkomiteti Drejtësia Liria dhe Siguria si dhe struktura të tjera ndërkombëtare. Në qendër të këtyre takimeve është situata në sistemin gjyqësor post-Reformës në Drejtësi, vlerësimi i performancës në sistemin gjyqësor, procesi i rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, vlerësimi etiko-profesional i gjyqtarëve si dhe mekanizmat ligjore dhe administrative të ndërmarra nga Këshilli për të adresuar problematikat e hasura ndër vite që lidhen me emërimet dhe promovimet në gjyqësor si dhe stoku i çështjeve që janë në pritje për t’u gjykuar.

IX. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Që në krye të herës misioni i punës së Këshillit të Lartë Gjyqësor ka qenë ndërtimi, udhëheqja dhe qeverisja e një sistemi gjyqësor me performancë të lartë, që meriton besimin e publikut. Në përmbushje të këtij misioni, gjatë punës së këtij viti, KLGJ-ja ka shprehur angazhimin maksimal jo vetëm për të komunikuar në mënyrë profesionale, të hapur dhe cilësore me publikun dhe median, por edhe nëpërmjet miratimit të akteve tepër të rëndësishme duke siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun dhe median.

Në vazhdim të përpjekjeve të Këshillit për të garantuar transparencë dhe komunikim sa më cilësor me publikun dhe median, është hartuar dhe miratuar “**Udhëzuesi standard i marrëdhënies së gjykatave me publikun dhe median**” i cili pati edhe asistencën teknike të partnerëve ndërkombëtarë. Udhëzuesi i është nënshtruar procesit të konsultimit publik me gjyqtarët e medias, gazetarët, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me organizatat e shoqërisë civile, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë. Ky udhëzues ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe

procedurave të informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase. Miratimi i këtyre rregullave krahas standardizimit të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.

Vlen të përmendim se më herët, në nëntor të vitit 2022 në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, Këshilli ka miratuar **“Planin e Komunikimit për Gjykatat”** me afat 2-vjeçar. Ky plan komunikimi shërbeu si një pikënisje për të strukturuar mënyrën se si gjykatat i përqasen publikut dhe aktorëve të tjerë të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi.

Në kuadër të zbatimit të tre fazave të Hartës së Re Gjyqësore përgjatë vitit 2023, “Plani i Komunikimit për Gjykatat” ka qenë një mundësi më shumë për gjykatat duke i shërbyer atyre jo vetëm për të komunikuar në mënyrë të strukturuar por edhe për të mundësuar edukimin e duhur ligjor të publikut nëpërmjet publikimit të materialeve informuese si postera dhe broshura në faqen zyrtare të KLGJ-së, gjykatave përkatëse, në rrjetet sociale dhe në ambientet e gjykatave.

Gjithashtu, në funksion të sigurimit të aksesit në drejtësi të qytetarëve, Këshilli ka mundësuar hapjen e **“Zyrave të shërbimeve”**, si struktura të cilat u ngritën dhe funksionojnë pranë godinave të ish-gjykatave me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative dhe komunikimin e informacionit të nevojshëm për publikun dhe median. Kjo zgjidhje është konsideruar një ndihmë në funksion të ruajtjes së të drejtës për akses të barabartë në gjykatë për të gjithë qytetarët, për dhënien e shërbimeve të nevojshme si dhe për edukimin e publikut.

Gjithashtu, si rezultat i ristrukturimit dhe administrimit të sistemit gjyqësor dhe nevojës së shtuar për të komunikuar me publikun, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dyfishuar **numrin e gjyqtarëve të medias**. Aktualisht, për vitin 2023 janë caktuar 17 gjyqtarë të medias që mbulojnë gjykatat e shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe posaçëm, nga 8 të tillë që ishin në 2022. Ky dyfishim i numrit të gjyqtarëve të medias dëshmon për angazhimin konkret të KLGJ-së për rritjen e aksesit dhe transparencës të publikut mbi sistemin gjyqësor.

Në vijim të këtij angazhimi, Këshilli ka organizuar 7 aktivitete të dedikuara me fokus komunikimin dhe marrëdhëniet me median, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, OSCE-n dhe projektin “Eu4Justice”. Një formë tjetër përmes së cilës Këshilli ka komunikuar me publikun janë edhe njoftimet/deklaratat për shtyp. Gjatë 2023, KLGJ-ja ka publikuar rreth 100 njoftime për shtyp, ndër të cilat 64 sqarojnë publikun për vendimmarrje

të rëndësishme të KLGJ-së si dhe 36 njoftime informojnë publikun mbi aktivitete dhe veprimtari të tjera të Këshillit. Gjithashtu, në përgjigje të sulmeve mediatike ndaj figurës së gjyqtarit, KLGJ-ja ka publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe në “Facebook”, 3 deklarata për shtyp në mbështetje të dinjitetit, integritetit, figurës së gjyqtarit.

Një tjetër mundësi për garantimin e transparencës së plotë dhe informimin e publikut dhe medias, është edhe programi i transparencës, i publikuar në faqen zyrtare të internetit, ku KLGJ-ja ka përditësuar vazhdimisht informacionin në këtë program, duke rritur transparencën rreth veprimtarisë së tij.

Ndër të tjera, vlen të theksohet se gjatë vitit 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka trajtuar në total 39 kërkesa të ardhura për informacion mbi ligjin “Për të drejtën e informimit” nga të cilat 36 kërkesa janë trajtuar me përgjigje të plotë, 2 kërkesa me përgjigje të pjesshme dhe 1 kërkesë e cila pasi është shqyrtuar, Këshilli ka konstatuar se nuk e zotëron informacionin e kërkuar duke ia dërguar atë autoritetit kompetent.

X. KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME

Në kuadrin e kryerjes së bilancit të fundvitit 2023 dhe në njohje të plotë të rolit dhe funksioneve të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor, do të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim dhe përgjatë vitit 2024 duke marrë angazhimet si më poshtë vijon:

1. Vijimi i plotësimit të kuadrit ligjor/nënligjor të nevojshëm për të gjitha proceset dhe çështjet me fokus planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, ato që lidhen me veprimtarinë dhe mirë-funksionimin e gjykatave, vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë, të propozuara apo që do të propozohen nga grupi i punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”.
2. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes zbatimit të procedurave transparente dhe meritokratike të rekrutimit dhe finalizimit të paketës së akteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale të administratës civile gjyqësore.
3. Hartimin, miratimin dhe zbatimin në praktikë i strategjisë dhe masave ligjore e administrative në funksion të rritjes së efikasitetit dhe performancës së sistemit gjyqësor, me fokus përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore për publikun.
4. Përsheptimin e ritmit të vlerësimeve etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e përcaktuar nga KLGJ-ja si dhe emërimin dhe promovimin e tyre si në bazë të nevojave të sistemit dhe në respektim të plotë të të drejtave të kandidatëve në këto procese.

5. Thellimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës si për përcaktimin e kuotave për magjistratët e rinj dhe për trajnimin fillestar të tyre dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve në detyrë, me qëllim plotësimin e vendeve vakante në sistem dhe uljen e çështjeve të prapambetura.
6. Fuqizimin e përpjekjeve për të vijuar rritjen e transparencës mbi sistemin gjyqësor, përmes, ndër të tjerave, edhe zhvillimeve teknologjike dhe digjitalizimit të shërbimeve gjyqësore.
7. Vazhdimin e përpjekjeve për të siguruar fondet e nevojshme për ndërtimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve përmes intensifikimit dhe forcimit të bashkëpunimeve me aktorët shtetërorë dhe partnerët ndërkombëtarë.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me:

- Miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara dhe dërguara në Kuvend nga grupi i punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” dhe propozimeve për funksionalitetin e sistemit gjyqësor, të depozituara që prej qershorit të vitit 2022.
- Mbështetjen financiare për rritjen e nivelit të investimeve në sistem në zbatim të Hartës së Re Gjyqësore kryesisht për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore të gjykatave, ku emergjente është nevoja për ndërtimin e godinave të reja, për akomodimin e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit Tiranë dhe Gjykatave së Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Kukës, Berat dhe Shkodër.
- Mbështetjen financiare për të mundësuar ndërtimin e sistemeve bashkëkohore të teknologjisë së informacionit, me fokus kryesor në ndërtimin e një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore.